




# RAPORTI VJETOR 2023



**AKEP**

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE  
ELEKTRONIKE DHE POSTARE


Kontribuan në hartimin e këtij Raporti:

Armer Juka, Eriola Mosko, Bledar Kazia, Vasil Mitezi, Gazmir Mani,  
Etleva Alushi, Jetmir Braha, Altin Rrapaj, Jonida Gjika

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare



**RAPORT I VEPRIMTARISË  
SË  
AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE  
ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
PËR VITIN 2023**







## FJALA E KRYETARIT

Raporti i veprimtarisë së AKEP-it për vitin 2023 merr një dimension të veçantë në kuadër të 25-vjetorit të themelimit të entit rregullator kombëtar në fushën e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare. Autoritet i pavarur i krijuar me ligj dhe institucion publik me detyra të mirëpërcaktuara, AKEP-i përmbush tashmë prej një çerek shekulli misionin si garant i paanshëm i qëndrueshmërisë dhe ecurisë së tregjeve nën mbikëqyrjen e tij, bazuar në parimet themelore të objektivitetit, proporcionalitetit, transparencës, eficiencës dhe konkurrencës së lirë e të ndershme, sikundër edhe rolin e promovuesit të të drejtave të përdoruesve përmes trajtimit në kohë reale të ankesave dhe nxitjes së përmirësimit të vazhdueshëm të shërbimeve që ofrohen sot në vend.



Tomi Frashëri, Kryetar i AKEP

Raporti që i paraqitet Kuvendit të Shqipërisë dhe publikut të gjerë pasqyron në fakte dhe shifra një angazhim të shtuar të institucionit në fushat e tij të kompetencës, por edhe intensifikimin e bashkëpunimeve dhe koordinimeve në nivele të ndryshme kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare, jetike për zhvillimin e qëndrueshëm në sektorët e komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve postare. Do të ishte e pamundur të përmbliidhej në disa rreshta tërësia e punëve të kryera gjatë vitit të kaluar në këtë drejtim, informacioni dhe llogaridhënia rigoroze të cilat shtjellohen në mënyrë profesionale në faqet vijuese. Janë për t'u theksuar dy arritje që shkojnë përtej kuadrit të ngushtë të punëve të mira në përditshmërinë e një institucioni e që si të tilla janë domethënëse për ecjen përpara të vendit. Në këto arritje, gjegjësisht në procesin e suksesshëm të përafrimit normativ me kuadrin europian të sektorëve nën përgjegjësi të tij dhe në hartimin dhe përpunimin e ligjit të ri për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë, AKEP-i ka dhënë një kontribut të qenësishëm, e me raste, vendimtar. Të dy proceset, njëkohësisht udhërrëfyesh në përshtatjen e shpejtë të vendit në suazën e harmonizimit me standardet e Bashkimit Europian, do të impaktojnë ndjeshëm e për një kohë të gjatë fizionominë e tregjeve, shërbimeve, sipërmarrësve, instrumenteve nxitëse të zhvillimit të shoqërisë digjitale dhe koncepteve të ndërhyrjeve përkatëse rregullatore.

E thënë thjeshtë, shoqërinë digjitale që po implementohet në çdo aspekt dhe në

---

çdo nivel në vendin tonë, e pret tashmë një evolucion i përshpejtuar, ku shndërrimet marramendëse teknologjike dhe parimi i sipërmarrjes së lirë sfidojnë çdo ditë rendin juridik dhe konceptet klasike të ekonomisë, duke e detyruar këtë shoqëri ende në shpërgënj t'i përshtatet nevojave, pritshmërive dhe kërkesave të kohës. Për sa i përket AKEP-it, sfida e tij parësore është të gjejë ekuilibrin e artë mes nevojës për përshtatje dhe reforma të vazhdueshme në këto rende e koncepte dhe misionit parësor publik të ruajtjes së integritetit të shtetit ligjor, nga pikëpamja e zbatimit rigoroz të legjislacionit kombëtar e të pacenueshmërisë së shtetit të së drejtës, si shprehi e garancive të të drejtave dhe lirive themelore të individëve, si pajtimtarë, përdorues e konsumatorë, në tërësinë e tyre.

Pikërisht në dritën e këtij parimi udhëheqës duhet përshkuar dhe shqyrtuar veprimtaria e AKEP-it gjatë vitit 2023, ashtu siç pasqyrohet dhe shtjellohet në faqet në vijim, falë përkushtimit të stafit të institucionit, të cilin e falënderoj me mirënjohje.

## PËRMBAJTJA

<b>FJALA E KRYETARIT</b> .....	<b>5</b>
<b>RETROSPEKTIVË, PËRPARËSI DHE PRIORITETE</b> .....	<b>10</b>
<b>1. Përvjetori i 25-të i AKEP-it: bilanc dhe retrospektivë</b> .....	<b>11</b>
<b>2. Vizita e punës në AKEP e Komisionit Parlamentar të Vepërtarive Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit</b> .....	<b>27</b>
<b>3. Zbatimi i rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2023</b> .....	<b>33</b>
<b>DREJTIMET KRYESORE TË PROGRAMIT TË PUNËS PËR VITIN 2024</b> .....	<b>37</b>
<b>I - PANORAMË E ZHVILLIMEVE NË TREGJET E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE</b> .....	<b>38</b>
<b>1. Vështrim i përgjithshëm mbi aspekte rregullatore në sektor</b> .....	<b>38</b>
<b>1.1 Kantieri i përafrimit me legjislacionin europian dhe impakti i pritshëm në legjislacionin vendas</b> .....	<b>38</b>
<b>1.2 Treguesit statistikorë të tregjeve të komunikimeve elektronike</b> .....	<b>40</b>
<b>1.3 Statusi i Shërbimit Universal</b> .....	<b>50</b>
<b>2. Ecuria e mbikëqyrjes rregullatore në sektorin e telefonisë dhe rrjeteve të lëvizshme</b> .....	<b>57</b>
<b>2.1 Përgatitja dhe nxjerrja në Këshillim Publik e dokumentit “Analizë e tregjeve me shumicë të Terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme</b> .....	<b>57</b>
<b>2.2 Monitorimi i efekteve të bashkimit me përthithje të operatorëve One Telecommunications sh.a., dhe Albtelecom sh.a</b> .....	<b>58</b>
<b>2.2.1 Përfundimi i proceseve teknike “switch-off” dhe “cut-over</b> .....	<b>58</b>
<b>2.2.2 Kujdesi për mbrojtjen e të drejtave të pajtimtarëve</b> .....	<b>60</b>
<b>2.2.3 Rezultatet e inspektimeve dhe masat korrigjuese të problematikave të vendosura nga AKEP</b> .....	<b>62</b>
<b>3. Ecuria e mbikëqyrjes rregullatore në sektorin e rrjeteve fikse</b> .....	<b>65</b>
<b>3.1 Përgatitja dhe nxjerrja në Këshillim Publik e dokumentit “Analizë e tregjeve me shumicë të Infrastrukturave të rrjeteve fikse dhe aksesit në broadband</b> .....	<b>65</b>
<b>3.2 Problematikat e shtrirjes së rrjetit në pikat e aksesit dhe në përdorimin e përbashkët të Infrastrukturës</b> .....	<b>66</b>
<b>3.3 Përditësimi teknologjik i hartëzimit të territorit përmes sistemit ATLAS në bashkëpunim me Unionin Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve (ITU)</b> .....	<b>68</b>
<b>II – SFIDAT E QENDRUESHMËRISË SË SIGURISË KIBERNETIKE</b> .....	<b>71</b>
<b>1. Përforsimi i sigurisë kibernetike në infrastrukturat e institucionit</b> .....	<b>71</b>
<b>1.1 Implementimi i platformës për menaxhimin e sigurisë kibernetike</b> .....	<b>71</b>
<b>1.2 Ngritja e Qendrës së monitorimit për infrastrukturat kritike dhe trafikun (SIEM)</b> .....	<b>73</b>
<b>1.3 Përmirësimi i infrastrukturës fizike të sistemit të administrimit të domain (DNS)</b> .....	<b>73</b>
<b>2. Menaxhimi i sulmeve kibernetike mbi rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike</b> .....	<b>74</b>
<b>2.1 Bashkëpunimi teknik me AKCESK-un gjatë vitit 2023</b> .....	<b>74</b>
<b>2.2 Mitigimi i sulmeve kibernetike mbi rrjetet e operatorëve të komunikimeve elektronike</b> .....	<b>75</b>
<b>2.3 Rekomandime për përforsimin e qëndrueshmërisë së infrastrukturave kritike</b> .....	<b>76</b>
<b>III – PANORAMË E ZHVILLIMEVE NË TREGUN POSTAR</b> .....	<b>77</b>
<b>1. Vështrim i përgjithshëm mbi aspekte rregullatore në sektor</b> .....	<b>77</b>
<b>1.1 Rishikimi i kuadrit ligjor</b> .....	<b>77</b>
<b>1.2 Treguesit statistikorë të tregut postar</b> .....	<b>78</b>
<b>1.3 Statusi i shërbimit universal</b> .....	<b>80</b>
<b>2. Ecuria e mbikëqyrjes rregullatore në sektorin postar</b> .....	<b>83</b>
<b>2.1 Realizimi i planit të inspektimeve për vitin 2023</b> .....	<b>84</b>
<b>2.2 Fokusi mbi luftën ndaj informalitetit</b> .....	<b>86</b>
<b>2.3 Pritshmëritë e sektorit për një treg të qëndrueshëm</b> .....	<b>87</b>

<b>IV – MONITORIMI I PËRDORIMIT TË SPEKTRIT TË FREKUENCAVE</b> .....	<b>89</b>
1. <i>Rishikimi i Planit të Përdorimit të Frekuencave në përputhje me acquis communautaire dhe harmonizime të tjera me standarde ndërkombëtare</i> .....	<b>89</b>
2. <i>Rritja e kapaciteteve për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave</i> .....	<b>90</b>
3. <i>Veprimtaria monitoruese gjatë vitit 2023</i> .....	<b>94</b>
<b>V- BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL I AKEP-it</b> .....	<b>106</b>
<b>1. Bashkëpunimi institucional në nivel kombëtar</b> .....	<b>106</b>
1.1 <i>Bashkëpunimi me AMA-n për parandalimin e piraterisë dhe shtrembërimeve të konkurrencës në shërbimet e komunikimeve elektronike</i> .....	<b>106</b>
1.2 <i>Bashkëpunimi me Autoritetin e Konkurrencës</i> .....	<b>107</b>
1.3 <i>Bashkëpunimi me sipërmarrësit dhe grupet e interesit në kuadër të zbatimit të Rregullores për të drejtat e përdoruesve</i> .....	<b>108</b>
<b>2. Bashkëpunimi institucional në nivel rajonal</b> .....	<b>114</b>
2.1 <i>Nënshkrimi i marrëveshjeve ndërkufitare midis vendeve të rajonit për koordinim në sistemet MFCN në bandat 800Mhz, 900Mhz, 1800Mhz, 2100Mhz dhe 2600Mhz</i> .....	<b>114</b>
2.2 <i>Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me autoritetet homologe të Kosovës dhe të Malit të Zi</i> .....	<b>118</b>
<b>3. Bashkëpunimi institucional në nivel ndërkombëtar</b> .....	<b>121</b>
3.1 <i>Rishikimi i marrëveshjeve të punës mes BEREC dhe autoriteteve rregullatore të Ballkanit Perëndimor</i> .....	<b>121</b>
3.2 <i>Planifikimi i bashkëpunimit teknik me Unionin Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve (ITU)</i> .....	<b>122</b>
3.3 <i>Bashkëpunimi me autoritetet rregullatore amerikane FCC dhe NTIA</i> .....	<b>123</b>
<b>4. Përfshirja e AKEP-it në punën dhe veprimtaritë e forumeve rregullatore shumëpalëshe</b> .....	<b>127</b>
4.1 <i>Roli i AKEP-it në mbledhjen e të dhënave për roaming-un rajonal në BEREC</i> .....	<b>127</b>
4.2 <i>Pjesëmarrja në Asamblenë e përgjithshme të Radiokomunikimit (ITU)</i> .....	<b>128</b>
4.3 <i>Pjesëmarrje në veprimtari të tjera</i> .....	<b>129</b>
<b>5. Takim me strukturat e Komisionit Evropian në kuadër të procesit të ‘screening’</b> .....	<b>137</b>
<b>VI- PERFORMANCA E BRENDSHME DHE MIRADMINISTRIMI FINANCIAR</b> .....	<b>141</b>
<b>1. Mbledhja e të ardhurave vjetore</b> .....	<b>141</b>
1.1 <i>Performanca në mbledhjen e të ardhurave nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike dhe operatorët e shërbimeve postare</i> .....	<b>141</b>
1.2 <i>Problematikat e të ardhurave të prapambetura dhe procedurat gjyqësore përkatëse</i> .....	<b>143</b>
<b>2. Zbatimi i buxhetit në rrethana të reja sektoriale dhe ndërsektoriale</b> .....	<b>145</b>
2.1 <i>Rënia e të ardhurave për shkak të zhvillimeve teknologjike në sektorin e Telekomunikacioneve</i> .....	<b>145</b>
2.2 <i>Rishikimet buxhetore gjatë vitit si pasojë e rritjes dhe shtesave në pagë të shërbimit civil</i> .....	<b>146</b>
2.3 <i>Realizimi i fondit të shpenzimeve për vitin 2023</i> .....	<b>148</b>
<b>3. Nevoja për një reflektim afatgjatë në shtimin e të ardhurave dhe balancën buxhetore</b> .....	<b>152</b>
3.1 <i>Tarifa e mbikëqyrjes së tregut</i> .....	<b>154</b>
3.2 <i>Tarifat për përdorimin e frekuencave</i> .....	<b>154</b>
3.3 <i>Tarifat për shërbime të tjera</i> .....	<b>156</b>

<b>VII – SHTOJCA</b> .....	<b>157</b>
<b>1. Struktura dhe Organigrama</b> .....	<b>157</b>
<b>2. Veprimtaria inspektuese në komunikimet elektronike</b> .....	<b>158</b>
2.1 <i>Plani i inspektimit për vitin 2023</i> .....	<b>158</b>
2.2 <i>Problematikat e hasura</i> .....	<b>159</b>
2.3 <i>Inspektimi në funksion të rrjeteve të sigurta</i> .....	<b>161</b>
<b>3. Tregues statistikorë mbi autorizimet e përgjithshme, autorizimet individuale, dhe domain-in .al</b> .....	<b>163</b>
3.1 <i>Tregues statistikorë të sektorit të autorizimeve</i> .....	<b>163</b>
3.2 <i>Tregues statistikorë për dhënie të drejtash përdorimi të frekuencave</i> .....	<b>166</b>
3.3 <i>Të dhëna mbi përdorimin e domain-it .al</i> .....	<b>167</b>
<b>4. Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP për vitin 2023</b> .....	<b>170</b>
<b>5. Acquis të transpozuar në Planin e Përdorimit të Frekuencave gjatë vitit 2023</b> .....	<b>172</b>
<b>6. Raport lidhur me zbatimin e Rezolutës dhe rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë për AKEP për vitin 2023</b> .....	<b>173</b>

**RETROSPEKTIVË,  
PËRPARËSI DHE  
PRIORITETE**

## 1. Përvjetori i 25-të i AKEP-it: bilanc dhe retrospektivë

Autoriteti Rregullator Shqiptar i Komunikimeve Elektronike dhe Postare kremtoi vitin e kaluar një çerek shekulli ekzistencë. Ky përvjetor na bëri të kthejmë kokën pas për të riparë ngjarje dhe zhvillime të rëndësishme që kanë përcaktuar trajtat e peizazhit aktual të sektorëve të telekomunikacioneve dhe të postave.

Janë përzgjedhur njëzet e pesë ngjarje, jo vetëm të natyrës ligjore apo rregullatore, por edhe zhvillime tregtare apo teknologjike, që korrespondojnë simbolikisht me 25 vitet e funksionimit të AKEP-it dhe pararendësit të tij, Entit Rregullator të Telekomunikacioneve (ERT). Burimi kryesor për përzgjedhjen e këtyre ngjarjeve kyçe janë Raportet Vjetore të hartuara nga institucioni dhe të dorëzuara në Kuvend. Për të plotësuar informacionet, janë konsultuar gjithashtu Rezolutat e Parlamentit për vlerësimin e punës së rregullatorit, regjistri tregtar, dhe shtypi i specializuar.

### 1998 Krijohet ERT

Nën ndikimin e legjislacionit të Bashkimit Europian u shpërfaqën në vendin tonë, në gjysmën e dytë të viteve '90, rregullatorët sektorialë të energjisë, ujit, radio-televizionit dhe telekomunikacioneve. Enti Rregullator i Telekomunikacioneve (ERT) u krijua me ligjin nr. 8288, datë 18.2.1998. Për vitin financiar të tij të parë të plotë, ERT gëzonte një buxhet prej 26 milionë lekë, nga të cilat 20.7 milionë zinin shpenzimet operative dhe 5.3 milionë investimet. Organika e Entit parashikonte një personel prej 17 vetash. Selia e tij përbëhej nga dy zyra në ish-Departamentin Shtetëror të Postave dhe Telekomunikacioneve pranë Ministrisë përkatëse. Në vitin 2023, AKEP dispononte një buxhet prej 381,500,000 lekë, nga të cilat 75,904.000 për investime, dhe kishte një organikë prej 84 vetash. Institucioni ka një godinë në pronësi të fokusuar në misionet teknike, në infrastrukturat kritike dhe për funksionet e Qendrës Kombëtare të Monitorimit të Frekuencave. AKEP ka gjithashtu në përdorim, në bazë të një kontrate qiramarrje, një godinë ku ndodhen zyrat e Këshillit Drejtues, Kryetarit dhe stafit administrativ.

## 1999

### Jepen licencat e para

Ndryshe nga regjimi aktual i autorizimit të përgjithshëm, sipas të cilit fillimi i ushtrimit të veprimtarisë ekonomike në fushën e komunikimeve elektronike është subjekt vetëm i një njoftimi paraprak, në fund të viteve '90 operimi në këtë sektor i nënshtrohej licencimit nga ERT. Në 1999, ERT akordoi dy licencat e para për kompanitë publike Albtelekom sh.a., dhe AMC sh.a. **Albtelekom**, operatori historik i telefonisë në vend, u themelua si shoqëri tregtare me aksioner të vetëm Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, më 16 shkurt 1999. U privatizua nga një kompani turke në vitin 2008 dhe iu ndryshua emri nga ALBTELEKOM në ALBTELECOM si shenjë ndërkombëtarizimi. Në mars të vitit 2022, CETEL TELEKOM ILETISIM SANAYI VE TICARET ANONIM SIRKETI i shiti aksionet e saj grupit 4iG. Në fund të vitit 2022, ndërmarrja e dikurshme Telekom Shqiptar u largua nga skena e komunikimeve elektronike, pas përthithjes nga ONE Albania. Jepen licensat e para për ISP, për subjektet AOL, Abissnet dhe Adanet.

## 2000

### Privatizimi i AMC

Shoqëria e parë aktive në tregun celular ishte Albanian Mobile Communications (AMC). U themelua më 27 nëntor 1995 me aksioner të vetëm Ministrinë e Financave dhe filloi veprimtarinë në vitin 1996. Në vitin 2000, shoqëria AMC u privatizua. Shteti i shiti shoqërisë të së drejtës greke Cosmoholding Albania S.A. 85% të aksioneve. 12.6% e aksioneve mbetën në pronësi të aksionerit shtet, ndërsa pjesa tjetër prej 2.38% e aksioneve zotëroheshin prej punonjësve të shoqërisë në kohën e privatizimit. Operatori më i vjetër celular kaloi në duart e gjermanëve të Deutsche Telekom AG dhe u riemërtua TELEKOM ALBANIA sh.a., më 22.7.2015. Shoqëria u mbiquajt ONE TELECOMMUNICATIONS pas blerjes prej një grupi financiar shqiptaro-bullgar Albania Telecom Invest AD në 2019. Pas më pak se tre vitesh, shoqëria ndryshoi përsëri pronësi duke kaluar në zotërim të grupit 4iG. Në fund të vitit 2022, shoqëria përthithi edhe ALBTELECOM sh.a., dhe u pagëzua me emrin ONE ALBANIA.



## 2001

### Hyrja në treg e VODAFONE

Viti 2001 u shënua nga hyrja në treg e VODAFONE ALBANIA, sipërmarrësit më të suksesshëm në tregun e komunikimeve elektronike për mbi dy dekada, pjesë e grupit të mirënjohur ndërkombëtar Vodafone, i pranishëm në 17 vende në Europë dhe më gjerë.

Në vitet pasardhëse, të tjerë sipërmarrës hynë në tregun celular. Në 2003, u bë aktiv në këtë treg Eagle Mobile, me aksioner të vetëm Albtelecom sh.a., duke krijuar kështu të parin grup në rrjetin e komunikimeve elektronike me prezencë të njëkohshme në sektorin fiks dhe atë celular. Në 2013, Eagle Mobile u përthith nga shoqëria mëmë dhe, në këtë mënyrë, Albtelecom sh.a., filloi të ofrojë shërbime me këtë emër tregtar në të dy tregjet, fiks dhe celular. Hyrja e katërt në tregun celular ishte shoqëria Plus në vitin 2010, por që pati një jetëgjatësi të shkurtër duke dalë nga tregu në fund të vitit 2017.

## 2008

### Ligji në fuqi për AKEP

Në vitin 2008 u miratua ligji aktualisht në fuqi për komunikimet elektronik nr. 9918, datë 19.5.2008. Është paketa e tretë ligjore në fushën e telekomunikacioneve pas ligjit nr. 8038, datë 23.11.1995, “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr. 8618, datë 14.6.2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë”. Ky i fundit shfuqizonte ligjin nr. 5841, datë 20.2.1979, “Për shërbimet postare dhe të telekomunikacioneve”. Nën iniciativën e Ministrisë së linjës, me mbështetjen e një konsulenti të huaj dhe kontributin e qenësishëm të AKEP, qeveria shqiptare është në fazën përfundimtare të hartimit të projektligjit të ri mbi komunikimet elektronike, i cili synon transpozimin në legjislacionin vendas të Kodit Europian të Komunikimeve Elektronike.

## 2009

### Shërbimi postar nën mbikëqyrjen e AKEP

Germa “P”, që në akronimin e AKEP qëndron për termin “postare”, ishte pjesë e emërimit të institucionit qysh në vitin e tij të rithemelimit në 2008 (shih më sipër ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008). Megjithatë, përcaktimi i AKEP si organi rregullator i cili mbikëqyr kuadrin rregullator postar të përcaktuar nga ligji nr. 8530, datë 23.9.1999, “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, u realizua vetëm në vitin 2009, përmes ligjit nr. 10 132, datë 11.5.2009. Ky ishte hapi i parë drejt liberalizimit të tregut postar në frymën e direktivave të Bashkimit Europian, duke materializuar ndarjen midis të drejtave të shtetit, si pronar i Posta Shqiptare sh.a., dhe kompetencave të rregullimit, që u transferuan nga Drejtoria e Përgjithshme e Postave dhe Telekomunikacioneve nën varësinë e Ministrit, drejt një autoriteti rregullator të pavarur nga qeveria.

## 2009

### Operimi i ccTLD nën kontrollin efektiv të AKEP

Krahas funksioneve rregullatore në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare, AKEP, përmes nenit 8 germa (k) të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, është caktuar si operator i regjistrimit të ccTLD. Domaini .al dhe nën-domainet e tij (.gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al) janë domainet e nivelit të lartë (TLD) në sistemin e emrit të domaineve (DNS) që i janë caktuar Republikës së Shqipërisë nga ICCAN dhe që administrohen nga AKEP. AKEP, në cilësinë e tij si operator regjistri, është përgjegjës për të mirëmbajtur regjistrin e bazës së të dhënave dhe për të siguruar operimin pa probleme të TLD-së. Pas vitesh nxitjeje nga ana e Kuvendit, në vitin 2009 operimi i ccTLD u mor nën kontrollin efektiv të AKEP-it. Më përpara, ccTLD ishte menaxhuar nga një qendër universitare në Republikën e Italisë.

## 2010

**Miratohet  
rregullorja për  
treguesit e cilësisë  
së shërbimit**

Në vitin 2010, Këshilli Drejtues i AKEP miratoi Rregulloren nr. 16, datë 16.4.2010, "Për treguesit e cilësisë së shërbimit". Kjo rregullore përbën një gur kilometrik tejet domethënës për përmirësimin e përvojës së pajtimtarit gjatë përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike. Rregullorja ka dy shtylla kryesore: Së pari, ajo përcakton një bashkësi minimale treguesish për të cilët sipërmarrësit kanë detyrimin të kryejnë matje, që janë subjekt monitorimi nga AKEP. Së dyti, rregullorja i detyron sipërmarrësit të publikojnë raportet e cilësisë së shërbimit duke ndriçuar në këtë mënyrë përzgjedhjen nga pajtimtari të rrjetit më cilësor ose më të përshtatshëm për nevojat e tij, duke nxitur në këtë mënyrë konkurrencën mes sipërmarrësve.

## 2011

**Implementohet  
teknologjia 3G**

Në përfundim të tenderit publik me procedurë të hapur, sipërmarrësi Vodafone Albania u shpall fitues për ofrimin e shërbimeve të lëvizshme tokësore me brez të gjerë sipas standardit IMT-2000/UMTS. Iu hap kështu rruga ofrimit të shërbimeve të standardit 3G, që janë sistemet celulare tërësisht digjitale, të ndërtuara rreth viteve 2000, të bazuara në teknologjitë TDMA/FDMA, të cilat përveç shërbimeve telefonike celulare dhe SMS-ve, mundësojnë gjithashtu shërbimin internet mobile me shpejtësi të kënaqshme.

## 2011

**Mundësohet  
Portabiliteti**

Portabiliteti i numrit cilësohet një lehtësues kyç për mundësinë përzgjedhëse të konsumatorit dhe një instrument i patjetërsueshëm i jetësimit të konkurrencës midis ofruesve të komunikimeve elektronike. Pas nënshkrimit në dhjetor 2010 të kontratës për "ngritjen e një Baze të Dhënash Reference për Ofrimin e Portabilitetit të Numrit", në maj të vitit 2011 u mundësua bartja e numrave në vendin tonë. AKEP ka mbikëqyrur ngushtësisht zbatimin e detyrimeve të rregullores së portabilitetit nga ana e sipërmarrësve dhe nuk është kursyer në vendosjen e gjobave kundrejt sipërmarrësve, si për shembull në vitin 2021, apo në formulimin e paralajmërimeve për dënime të përshkallëzuara në rast dështimi sistematik në përmbushjen e përcaktimeve ligjore.

---

## 2013

### Liberalizohet përdorimi i *domainit .al*

Momenti i dytë kyç për masivizimin e përdorimit të domainit.al dhenën-domaineve të tijkagjenë liberalizimi i funksionit të regjistrarit. Gjatë vitit 2013 u realizua kalimi nga sistemi “Operator Regjistri-Regjistrar” i vetëm në një sistem të liberalizuar sa i përket funksioneve të regjistrarit. Ky proces u konkretizua me licencimin e 5 subjekteve të parë si regjistruar. Regjistrarët janë entitete juridike, përgjithësisht shoqëri tregtare, që i shesin publikut emrat e domain-eve. Ata kanë akses në regjistrin e bazës së të dhënave që operohet nga AKEP. Regjistrarët janë nën mbikëqyrjen e AKEP-it për përmbushjen e detyrimeve rregullatore. AKEP ka ruajtur një natyrë hibride, duke luajtur njëkohësisht rolin e operatorit të ccTLD-së dhe të një regjistri, që i shërben institucioneve shtetërore, por edhe publikut të gjerë. Numri total i domain-eve të regjistruar për vitin 2013 ishte 12,888 domain-e. Në fund të vitit 2023 ky tregues kapi shifrën **28278 domain-e** të regjistruara.

## 2015

### Jetësohet Sistemi ATLAS

Në vitin 2012, AKEP miratoi modalitetet e regjistrimit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike, i cili përbëhet nga baza hartografike e territorit të Republikës së Shqipërisë dhe të dhënat nga operatorët e rrjeteve të komunikimeve elektronike. Vetëm në vitin 2015 u realizua menaxhimi dhe integrimi në sistemin ATLAS, si pjesë e sistemit Web-Gis, i informacioneve hapësinore dhe jo hapësinore të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike të sistemeve të transmetimit të radiofrekuencave dhe sistemeve për infrastrukturën e komunikimeve elektronike kabllorë dhe kanalizimeve.

## 2015

### **Ngrihet Sistemi Kombëtar i Monitorimit të spektrit të frekuencave**

Mbi bazën e një Projekti të hartuar nga ITU në 2011, AKEP-i u angazhua në ngritjen e një Sistemi Kombëtar të Monitorimit të spektrit të frekuencave. Në vitin 2015 u përmbyll faza e parë e Projektit me përfundimin e ndërtimit të Stacionit Fiks të Monitorimit, në Pinet. Në bashkëveprim me Stacionin Fiks të Monitorimit në Krujë, ai Stacion bëri të mundur monitorimin 24 orë të brezit të frekuencave 20-3000 MHz, në një zonë 70 km rreth Tiranës dhe Durrësit, duke përfshirë dhe aeroportin ndërkombëtar në Rinas. Këto stacione kontrollohen në distancë nga Qendra Kryesore e Kontrollit (MCC), pjesë e Qendrës Kombëtare të Monitorimit të Frekuencave, në Tiranë.

## 2015

### **Plotësimi i kuadrit rregullator mbi shërbimet postare**

Vendosja e tregut postar nën mbikëqyrjen e AKEP-it në vitin 2009 përbën sigurisht një ndryshim epokal në trajtimin e këtij shërbimi thelbësor për jetën e qytetarëve dhe bizneseve. Por, modernizimi i vërtetë i legjislacionit, duke transpozuar plotësisht tre direktivat përkatëse të BE-së, u realizua në vitin 2015 përmes ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”. Të gjitha rregulloret aktualisht në fuqi, gjithsej tetë, që rregullojnë sektorin postar, u miratuan nga AKEP brenda një harku kohor pothuajse një-vjeçar 2015-2016:

1. Rregullore nr.46, datë 27.10.2016, «Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë së Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike»
2. Rregullore nr.45, datë 27.10.2016, «Për Metodikën e Inspektimit të Veprimtarisë së Ofruesve të Shërbimeve Postare»
3. Rregullore nr.42, datë 3.3.2016, «Për Llogaritjen e Kostove Neto të Shërbimit Universal Postar»
4. Rregullore nr. 41, datë 3.3.2016, «Për Ndarjen e Llogarive dhe Llogaritjen e Kostove për Ofrimin e Shërbimit Universal Postar»

5. Rregullore nr.40, datë 17.12.2015, «Për të Dhënat Statistike dhe Financiare Periodike mbi Shërbimet e Ofruara nga Operatorët dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare»
6. Rregullore nr.39, datë 17.12.2015, «Për Procedurat e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve ndërmjet Përdoruesit dhe Ofruesit të Shërbimit Postar dhe Mosmarrëveshjeve Ndërmjet Ofruesve të Shërbimit Postar»
7. Rregullore nr.38, datë 19.11.2015, «Për Autorizimin e Përgjithshëm për Ofrimin e Shërbimeve Postare»
8. Rregullore nr.36, datë 29.10.2015, «Për Ofrimin e Shërbimit Universal Postar».

## **2016**

### **Implementimi i numrit të emergjencës**

Në përputhje me kuadrin ligjor komunitar, sipërmarrësit duhet të sigurojnë që të gjithë përdoruesit fundorë të kenë akses në shërbimet e emergjencës nëpërmjet komunikimeve të emergjencës pa pagesë dhe pa pasur nevojë të përdorin asnjë mjet pagese, duke përdorur Numrin Unik European të Emergjencave '112' dhe çdo numër kombëtar të emergjencës të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi. Në vitin 2016 u bë i mundur implementimi i Numrit European të Emergjencave 112 në zonën e Tiranës, proces i cili në vitet në vijim u shtri në të gjithë vendin.

## **2016**

### **Stimulimi i rrjeteve me shpejtësi të lartë**

Ligji nr. 120/2016, "Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit", i miratuar më 24.11.2016, shënon përfshirjen e parë të artikuluar të shtetit në këtë sektor, zhvillimi i të cilit, deri në këtë kohë, i ishte lënë kryesisht iniciativës private. Ky ligj është përafuar plotësisht me Direktivën 2014/61/BE të Parlamentit European dhe Këshillit, datë 15 maj 2014,

“Mbi masat për reduktimin e kostove të ndërtimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë”, dhe ka për synim të lehtësojë dhe stimulojë përhapjen e rrjeteve të komunikimit elektronik me shpejtësi të lartë duke ulur kostot e shtrirjes së tyre falë masave në katër fusha:

- (i) lehtësimi i aksesit në infrastrukturën fizike ekzistuese (duke përfshirë atë të utiliteteve të ndryshme dhe infrastrukturën fizike në ndërtesa);
- (ii) koordinimi i punimeve civile;
- (iii) thjeshtësimi i procedurave administrative për dhënien e lejeve;
- (iv) specifikimet për ndërtimin e infrastrukturës fizike për ndërtesat e reja dhe rinovimet e mëdha.

Zhvillimi i rrjeteve të shpejtësisë së lartë duke filluar nga viti 2016 ka qenë impresionues. Në *broadband*-in fiks, në vitin 2022, pjesa e lidhjeve *broadband* të shpejta dhe ultra të shpejta (d.m.th., shpejtësia e shkarkimit 30 Mbps ose më e lartë) përfaqësonte 51% të akseseve totale të ofruara në treg, krahasuar me vetëm 1% në vitin 2016. Për sa i përket teknologjisë, tendenca kryesore e vëzhguar është rritja e pjesës së lidhjeve me bazë fibrash, e cila u rrit nga vetëm 11% në vitin 2016, për t’u bërë në vitin 2022 teknologjia kryesore e aksesit me mbi 61% të tregut.

Në *broadband* mobile, aktualisht, pothuajse 4 nga 5 pajtimtarë mobile përdorin internetin në pajisjet e tyre celulare. Në krahasim me vitin 2016, përdorimi i datave është pothuajse 7-fishuar.

# 2016

## Analiza e tregut *broadband* fiks

Me vendimin nr. 2701, datë 22.12.2016, AKEP miratoi analizën e tregjeve me shumicë të aksesit *broadband* në internet dhe linjave me qira. Ishte hera e parë që analiza e tregjeve kryhej sipas rekomandimeve të reja të Komisionit European të vitit 2014.

Tregjet përkatës të analizuar në këtë dokument ishin: 1. Tregu me shumicë i aksesit në nivel lokal në vendndodhje fikse (VVLA); 2. Tregu me shumicë i aksesit në nivel qendror për produkte të tregut të përgjithshëm (VVCA); 3. Tregu me shumicë i aksesit me cilësi të lartë në vendndodhje fikse (VVHQA); 4. Tregu me shumicë i aksesit në elementet pasivë të infrastrukturës së rrjeteve në nivel kombëtar.

Për tre tregjet e parë, që janë pjesë e rregullores nr. 9, datë 17.7.2009 “Për analizën e tregut”, Albtelecom u shpall operator me fuqi të ndjeshme në treg dhe iu vendosën masat rregullatore të mëposhtme:

3.1 Detyrimin e mosdiskriminimit, sipas nenit 39, të ligjit nr.9918;

3.2 Detyrimin e transparencës, sipas nenit 40, të ligjit nr. 9918;

3.3 Detyrimin për akses dhe përdorimin e përbashkët të faciliteteve të rrjetit, sipas nenit 42, të ligjit nr. 9918;

3.4 Detyrimin për kontroll të tarifave, sipas nenit 45, të ligjit nr. 9918.

Tregu me shumicë i aksesit në elementet pasivë të infrastrukturës së rrjeteve në nivel kombëtar u vlerësua se nuk përmbush kriteret për të qenë subjekt rregullimi *ex ante*.

Duhet theksuar se zhvillimi i rrjeteve të *broadband* fikse, që kanë qenë tejte i vrullshëm deri në ditët e sotme, është mbështetur në mënyrë tejte të kufizuar mbi masat rregullatore. Aktualisht në vendin tonë katër nga pesë familje kanë akses në *broadband* fiks. Tregu i *broadband* fiks i është nënshtruar një analize të re gjatë vitit 2023, konkluzionet e të cilit pritet të miratohen brenda gjysmës së parë të vitit 2024.



## 2018

### Terminimi i thirrjeve në rrjetet celulare

Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve hyrëse është një nga tregjet subjekt rregullimi *ex ante* sipas rregullores nr. 9, datë 17.7.2009, “Për analizën e tregut”. Me vendimin nr. 70, datë 1.10.2018, AKEP miratoi tarifën maksimale aktualisht në fuqi për terminimin e thirrjeve kombëtare në rrjetet celulare prej 1.11 lekë për minutë. Kjo masë rregullatore tarifore i zbatohet në mënyrë simetrike të gjithë sipërmarrësve të komunikimeve elektronike. Tregu i terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare i është nënshtruar një analize tregu gjatë vitit 2023. Pas përfundimit të këshillimit publik, AKEP pritet të miratojë një ulje të mëtejshme të tarifave maksimale të terminimit. Ndryshe nga e shkuara, analiza e kostos së terminimit të thirrjeve është kryer mbi bazën e një modelit të kostove të shërbimeve me shumicë të rrjeteve celularë, të miratuar nga AKEP përmes vendimit nr. 10, datë 22.7.2021, dhe jo duke u mbështetur ekskluzivisht mbi publikimet e tarifave mesatare të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare të vendeve të tjera të hapësirë europiane.

## 2019

### Jepet e drejta e parë e përdorimit në brezin 800 Mhz, pjesë e DD1

Zhvillimi i internetit me brez të gjerë mobile mori një impuls të ri me dhënien e të drejtës së përdorimit të bllokut të parë në brezin 800 MHz, pjesë e të ashtuquajturit Dividenti Digjital 1. Investimet në teknologjinë e re 4G ndihmuan në përballimin me sukses të rritjes në mënyrë drastike të konsumit të datave gjatë krizës së pandemisë, kur një pjesë e qenësishme e të punuarit, të arsimuarit dhe të argëtuarit kaloi *online*. Teknologjia 4G, që shfrytëzon frekuencat e këtij brezi, ka për veçori faktin që sistemet celulare digjitale janë të bazuara tërësisht mbi IP (Internet Protocol), dhe ofrojnë shërbim internet mobile me shpejtësi të lartë. Rrjetet 4G mundësojnë edhe shërbimet telefonike VoLTE mbi IP, të një cilësie shumë të lartë.

## 2020

### Miratimi nga Qeveria i dy dokumenteve kyçe për zhvillimin e rrjeteve të sigurta dhe të shpejtësisë së lartë

Katërvite pas ligjit për stimulimin e rrjeteve me shpejtësi të lartë, Qeveria shqiptare miratoi dy dokumente kyçe për zhvillimin e rrjeteve të sigurta dhe të shpejtësisë së lartë në verën e vitit 2020. Plani Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm *Broadband*, i miratuar me VKM nr. 434, datë 3.6.2020, thekson se zhvillimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), është ndër prioritetet e Qeverisë shqiptare. Për të shfrytëzuar fuqitë transformuese të TIK-ut, është thelbësore që të ketë një infrastrukturë *Broadband* të shpejtësisë së lartë në të gjithë vendin. Për të ngritur themelet për një shoqëri Gigabit përcaktohen, ndër të tjerë, këto objektiva strategjike të zhvillimit të *Broadband*: Zhvillimi i qëndrueshëm i infrastrukturës *Broadband* dhe reduktimi i ndarjes digjitale dhe ofrimi i shërbimeve *Broadband* gjithëpërfshirëse.

Me vendimin nr. 636, datë 29.7.2020, Këshilli i Ministrave vendosi miratimin e programit shumëvjeçar për politikën spektrale dhe të planit të veprimit. Ky akt përafrohet pjesërisht me vendimin nr. 243/2012/EU të Parlamentit Europian dhe Këshillit, të datës 14 mars 2012, “Mbi krijimin e programit shumëvjeçar të politikës së spektrit radio”. Ndër objektivat strategjike të përcaktuar në programin e politikës spektrale bëjnë pjesë përdorimi eficient, kapërcimi i hendekut digjital, zhvillimi i shërbimeve *broadband*, dhe sigurimi i konkurrencës efektive.

## 2021

### RLAH Ballkani Perëndimor (dhe glidepath për EU)

Qeveritë e vendeve të Ballkanit Perëndimor (BP) nënshkruan në Sofje, më 17 maj 2018, një marrëveshje për eliminimin e tarifave të shërbimeve *roaming* në rajon si dhe shprehën mbështetjen për uljen e kostove të këtyre tarifave midis vendeve të BP dhe BE. Duke filluar nga data 1.7.2021, falë një pune intensive të rregullatorëve të vendeve të BP, u hoqën tarifat *roaming* për qytetarët dhe të gjithë pajtimtarët e Shqipërisë dhe vendeve të tjera të rajonit gjatë udhëtimeve të tyre në BP, mbi bazën e parimit *Roam Like At Home* (RLAH), që

konsiston në zbatimin e tarifimit përkatës të aplikuar në vendin e origjinës për shërbimet celulare, të tilla si:

- Thirrje dalëse, thirrje hyrëse (0 lekë);
- SMS dalëse, SMS hyrëse (0 lekë);
- Data/Internet (sipas politikës së përdorimit të drejtë - FUP).

Falë këmbënguljes së vazhdueshme të AKEP-it dhe koordinimit të suksesshëm të RCC me instancat vendimmarrëse europiane, Komisioni European kërkoi nga BEREC një përfshirje më aktive në procesin e reduktimit të tarifave të *roaming*-ut midis BE dhe vendeve të BP. Reduktimi i tarifave të shërbimeve *roaming* midis vendeve të BP dhe BE, parashikohet jo mbi bazën e marrëveshjeve ndërmjet vendeve, por nëpërmjet zbatimit vullnetar nga ana e operatorëve celularë të secilit vend.

## 2021

### Fokusi i ri në mbrojtjen e pajtimtarit

Krahas nxitjes së konkurrencës dhe zhvillimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike, mbrojtja e të drejtave të konsumatorit dhe të pajtimtarit është nga misionet kryesore të AKEP. Ky objektiva qenë, në mënyrë përherë e më domethënëse, në fokusin e AKEP duke filluar nga miratimi i një kornize të plotësuar, të modernizuar, dhe të përditësuar me zhvillimet europiane, përmes Rregullores nr.49, datë 11.3.2021, “Për mbrojtjen e konsumatorëve dhe pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”. Përballë një fluksi ankesash nga pajtimtarët për zvarritje dhe refuzime të paarsyeshme në procesin e bartjes së numrit nga një operator te një tjetër, AKEP në vitin 2021 konstatoi shkelje nga ana e tre sipërmarrësve dhe i dënoi ata me gjobë. Pas dy vitesh, AKEP paralajmëroi për dënim të rëndë një nga sipërmarrësit në rast dështimi sistematik në përmbushjen e përcaktimeve ligjore të zbatueshme gjatë procesit të bartjes së numrave. Në vitin 2023 ishte mosrespektimi i procedurave mbi ndërprerjen e shërbimit/kontratës, në rast mospagese nga pajtimtari, që investoi AKEP-in në një inspektim dhe në një proces gjykimi administrativ që përfundoi me ndëshkimin me gjobë prej ALL 10 milionë të sipërmarrësit shkelës.

## 2022

### AKEP në epokën e kërcënimeve kibernetike

Përmes VKM-së nr. 553, datë 15.7.2020, qeveria përcaktoi AKEP-in për herë të parë si operator i infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, si më poshtë:

- i. Sistemi i Menaxhimit Cctld.AL,
- ii. Sistemi i Bazës së të Dhënave të Centralizuar të Probabilitetit të Numrit (Crdb),
- iii. Sistemi i menaxhimit të Aplikimeve dhe Raportimeve Online (RevZone) dhe
- iv. Sistemi i menaxhimit/ monitorimit të Frekuencave) dhe
- v. Regjistri Elektronik i Rrjeteve Publike të Komunikimeve Elektronike (Atlas)

Në zbatim të këtyre zhvillimeve ligjore dhe duke iu përmbajtur parimit themelor sipas të cilit asnjë investim në fushën e sistemeve elektronike/digitale nuk mund të jetë i qëndrueshëm për sa kohë nuk përftohet njëkohësisht komponenti përkatës i sigurisë, AKEP-i buxhetoi në fund të vitit 2021 dhe realizoi në vitin pasardhës një seri konsulencash, investimesh dhe mirëmbajtjesh që e imunizuan AKEP-in kundrejt çdo disfunksioni madhor në periudhën e kërcënimeve kibernetike agresive dhe konstante qysh prej sulmeve të 15 korrikut 2022.

AKEP, gjithashtu, ka luajtur një rol kyç, ndonëse shpeshherë duke përdorur instrumente të *soft power*, në promovimin dhe garantimin e sigurisë së rrjeteve të komunikimeve elektronike, sa përmes asistencës ndaj sipërmarrësve, aq edhe përmes përkrahjes së iniciative shtetërore për adoptimin e rrjeteve të pastra.

## 2023

Drejt një  
tjetër niveli  
performance të  
Rregullatorit

Shumëfishimi i sfidave përherë e më komplekse ka parë të nevojshme në mënyrë të pashmangshme modernizimin e institucionit dhe rritjen e performancës së tij. Në radhë të parë, u pa i domosdoshëm informatizimi i plotë i të gjithë aktivitetit të institucionit brenda një sistemi të qendëruar ku e gjithë ecuria e punës mbulohej nga ky sistem. Nëpërmjet këtij projekti u arrit të digjitalizohet dhe automatizohet i gjithë aktiviteti operacional i institucionit duke i ndërthurur dhe integruar të gjitha proceset brenda një sistemi të vetëm, ku të dhënat janë të sinkronizuara në kohë reale dhe funksionet tërësisht të integruara. Platforma e implementuar përbëhet nga komponenti ERP- *Enterprise Resource Planning software* dhe komponenti iBPMS (Platformë Inteligjente për Menaxhimin e Proceseve të Biznesit). Prej implementimit të këtij sistemi u përftua:

- Reduktim i kohës së shpenzuar për realizimin e proceseve të punës;
- Rritje e saktësisë së punonjësve, duke shmangur gabimet e mundshme;
- Rritje e sigurisë së informacionit, duke eliminuar mundësinë për humbje të dhënash.

Së dyti, rritja e shpenzimeve kapitale dhe operacionale për të përmbushur përgjegjësitë ligjore, kryesisht në fushën e sigurisë kibernetike, ka vënë në krye të agjendës institucionale mirëpërdorimin e fondeve të disponueshme. Për shkak, nga njëra anë, të një dispozitivi ligjor, që mandaton transferimin në buxhetin e shtetit të shumave të pashpenzuara gjatë vitit financiar, dhe, nga ana tjetër, të një planifikimi jocilësor dhe implementimi inefficent të procedurave të prokurimit publik, AKEP, në mënyrë të përvitshme, kishte dështuar të vërë në punë shuma që përfaqësojnë deri në 20% të buxhetit vjetor. Në vitin 2023, pas përmirësimesh të ndjeshme nga viti në vit, AKEP-i realizoi plotësisht buxhetin e miratuar nga Qeveria dhe mbi bazën e të cilit jep llogari përpara Kuvendit.

---

## 2023

### **Rikonfigurimi historik i peizazhit të përdorimit të frekuencave me objektiv sigurimin e eficiencës dhe të konkurrencës**

Reduktimi nga tre në dy i sipërmarrësve të komunikimeve elektronike të rrjeteve të lëvizshme mbi bazën e autorizimit të akorduar nga Autoriteti i Konkurrencës, krahas vështirësive të pashmangshme që passjell në sigurimin e konkurrencës në treg, paraqiti për AKEP-in dhe dy sipërmarrësit një rast tepër të rrallë dhe ndoshta unik për të optimizuar në nivele maksimale eficiencën e përdorimit të spektrit të frekuencave. Duke u mbështetur në rekomandimin e Autoritetit të Konkurrencës që nxiste riekulibrimin e zotërimeve spektrale nga dy sipërmarrësit e mbetur, dhe duke përfituar nga kompetenca e vet ekskluzive në administrimin e spektrit të frekuencave, përfshirë transferimet e të drejtave të përdorimit të tyre, AKEP-i nxiti dhe ndërmjetësoi një proces kompleks dhe delikat, jo vetëm për ribalancimin e spektrit në përdorim nga secili aktor i tregut, por edhe për rishpërndarjen e zotërimeve spektrale, në mënyrë që ato të jenë vijuese për secilin operator dhe pa breza-roje të panevojshëm. Falë këtij operacioni, konfigurimi aktual i spektrit të frekuencave të dedikuar komunikimeve elektronike është eficient në përdorim, nxit në mënyrë të drejtë konkurrencën për shërbime cilësore nga sipërmarrësit aktiv në treg, dhe garanton, në rast interesi, blloqe spektrale adekuate për një sipërmarrës të tretë rrjetesh të komunikimeve elektronike të lëvizshme.



## 2. Vizita e punës në AKEP e Komisionit Parlamentar të Veprimtarive Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit

Njëzet e pesë vjetori i krijimit të Rregullatorit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare u shënjuar nga një vizitë pune në AKEP nga ana e Komisionit Parlamentar të Veprimtarive Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit, më datë 4 tetor 2023.



*Anëtarët e Komisionit Parlamentar të Veprimtarive Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit përgjatë diskutimeve me AKEP, lidhur me zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi i RSH, tetor 2023  
(Burimi: AKEP)*

Delegacioni parlamentar përbëhej prej z. Arben Pëllumbi, Kryetar i Komisionit, z. Helidon Bushati, Nënkyetar i Komisionit, z. Laert Duraj, Sekretar i Komisionit dhe prej anëtarëve znj. Luljeta Bozo, znj. Tatjana Piro, z. Baftjar Zeqaj, z. Ilir Ndraxhi, z. Ismet Beqiraj, z. Nusret Avdullaj, z. Gëzim Ademaj, z. Lefter Gështenja, z. Ramadan Likaj, z. Qani Xhafaj, z. Lodovik Hasani, z. Xhelal Mziu dhe z. Agron Duka. Delegacioni parlamentar ishte i shoqëruar prej znj. Elona Toto, Sekretare e Komisionit, si dhe Këshilltarëve znj. Manjola Merlika, dhe z. Marlind Myftiu.

Delegacioni u mirëprit nga z. Tomi Frashëri, Kryetar i Këshillit Drejtues të AKEP-it, dhe më pas zhvilloi një takim me delegacionin e AKEP-it në selinë administrative të institucionit, në sallën që shërben për mbledhjet e Këshillit Drejtues. Krahas z. Tomi Frashëri, Kryetarit të Këshillit Drejtues, delegacioni i AKEP-it përbëhej nga anëtarët e Këshillit, z. Armer Juka, z. Bleron Dokle, dhe z. Lorenc Bako, nga Drejtorja e

Kabinetit të Kryetarit, znj. Eriola Mosko, dhe nga Drejtori i Drejtorisë së Monitorim-Inspektimit, z. Vasil Mitezi.



*Anëtarët e Komisionit Parlamentar të Veprimtarive Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit përgjatë diskutimeve me AKEP, lidhur me zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi i RSH, tetor 2023*

*(Burimi: AKEP)*

Z. Pëllumbi, Kryetari i Komisionit Parlamentar, parashtrori arsyet dhe kontekstin e vizitës së punës në AKEP. Në këndvështrimin e Komisionit, vizitat e punës përbëjnë një instrument shtesë për mbikëqyrjen e veprimtarisë dhe të performancës së institucioneve të pavarura nën juridiksionin e këtij Komisioni. Nga njëra anë, ato plotësojnë llogaridhënien formale të AKEP-it, që jetësohet përmes dorëzimit të Raportit Vjetor dhe paraqitjen më pas në një seancë dëgjimore nga ana e titullarit të institucionit para këtij Komisioni. Nga ana tjetër, këto vizita pune i shërbejnë deputetëve për t'u familjarizuar me fushën rregullatore dhe për të kuptuar në praktikë sesi misionet ligjore përkthehen në veprimtari administrative të përditshme.

Z. Pëllumbi nënvizoi rëndësinë e raportimit vjetor të institucioneve të pavarura, duke vlerësuar në këtë drejtim punën e AKEP-it. Raporti Vjetor duhet të paraqesë një panoramë të plotë dhe besnike të realizimeve, sfidave apo mosarritjeve të institucionit. Një vëmendje e veçantë, sipas z. Pëllumbi, i duhet kushtuar rezolutave të Parlamentit. Rezolutat kanë për synim të integrojnë në agjendën institucionale të autoritetit një komponent politik, që, pa zëvendësuar programin institucional të punës, e plotësojnë atë me prioritete që burojnë nga një shprehje demokratike.



Së fundi, z. Pëllumbi vuri në dukje se, krahas misionit mbikëqyrës dhe kontrollues, Komisioni Parlamentar i kryesuar prej Tij e konsideron detyrë themelore që të jetë i hapur për të dëgjuar dhe për t'u njohur me sfidat e Autoritetit dhe për ta mbështetur atë në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht kur suksesi i tyre është i kushtëzuar dhe i ndërvarur nga bashkëpunimi me pushtete të tjera shtetërore.

Z. Frashëri falënderoi Kryetarin e Komisionit për fjalën e mbajtur, e cila artikulonte në mënyrë elokumente termat e marrëdhënies Kuvend – Autoritet i Pavarur sa i përket, nga njëra anë, llogaridhënies përpara organit përfaqësues të vullnetit demokratik, si edhe, nga ana tjetër, gatishmërisë për t'ju gjendur pranë autoriteteve të pavarura, që kanë një natyrë dhe një vend të veçantë në arkitekturën kushtetuese dhe administrative të shtetit.

Kryetari i Këshillit Drejtues të AKEP shprehu gatishmërinë e tij për t'u paraqitur në Komisionin Parlamentar, jo vetëm për raportimin vjetor, por sa herë që çështje të fushës rregullatore paraqesin një rëndësi të veçantë për Komisionin. AKEP vlerëson se përgjigjet me shkrim ndaj pyetjeve të Komisionit përbëjnë, gjithashtu, një instrument efektiv që mund të ketë një përdorim më të zgjeruar.

Njëzet e pesë vjetori i AKEP-it i shërbeu z. Frashëri për t'u ndalur shkurtimisht mbi të ardhmen e rregullatorit dhe sfidat që e presin në të ardhmen. Për mirëpërgatitjen dhe suksesin e autoriteteve të pavarura si puna e AKEP-it, në vlerësimin e z. Frashëri, ka një rol të rëndësishëm për të luajtur Kuvendi, veçanërisht përmes Komisionit Parlamentar përkatës, së paku në tre nivele:

*Së pari*, organi parlamentar mund të ndërmarrë nisma për vlerësimin e efektivitetit të *setup*-it institucional të njërit apo disa prej autoriteteve të pavarura rregullatore dhe, në funksion të gjetjeve, të paraqesë rekomandime për ndryshime ligjore apo modernizime të tjera të dobishme.

*Së dyti*, Komisioni, në bashkërendim me struktura të tjera parlamentare, mund të shërbejë si një ndërfaqe për lehtësimin e komunikimit midis autoriteteve të pavarura dhe pushteteve të tjera në shtetin shqiptar. Në këtë lëndë, një iniciativë për t'u përgëzuar është mbështetja që Komisioni i dha AKEP-it për t'iu drejtuar Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, i cili ka në përbërjen e tij Nënkomisionin për Qeverisjen Vendore. Përmes kësaj iniciative, AKEP-i synon të bashkërendojë një sërë hapash drejt ndërgjegjësimit të disa aktorëve sektorialë, kryesisht të pushtetit vendor, për domosdoshmërinë e marrjes së një ansambli të koordinuar masash që kanë të bëjnë, në nivel bashkish dhe njësisht administrative, me zhvillimin infrastrukturor të rrjeteve të telekomunikacionit.

Së fundi, z. Frashëri vuri në dukje se rregullatorët sektorialë zënë një vend të posaçëm, jo vetëm në organizimin shtetëror shqiptar, por ndoshta edhe më


shumë në dispozitivin legjislativ të Bashkimit Europian. Rregullatorëve të pavarur, veçanërisht si AKEP-i, që janë në pararojë të zhvillimeve digjitale, i ngarkohen për herë e më tepër misione kyçe për rregullimin e tregjeve dhe shërbimeve digjitale. Në suazën e integritit europian, Komisioni Parlamentar mund të shërbejë si një urë komunikimi midis rregullatorëve të pavarur dhe Komisionit Parlamentar për Çështjet Europiane për të shfrytëzuar të gjitha kapacitetet dhe për të luajtur një rol-proaktiv në funksion të agjendës së integritit.

Fjalët e kryetarëve i lanë vendin një diskutimi shumë të frytshëm dhe të hapur, në të cilin u përfshinë të gjithë pjesëmarrësit, dhe ku u trajtuan çështje me interes publik si mbulimi me shërbim celular, çmimet e internetit fiks dhe mobile, mbrojtja dhe garantimi i të drejtave të konsumatorit, etj.



*Vizite pune në ambjete të AKEP e Komisionit Parlamentar të Veprimtarive Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit, tetor 2023  
(Burimi: AKEP)*

Një nga momentet e rëndësishme të vizitës së punës ishte prezantimi i Delegacionit Parlamentar me Qendrën Kombëtare të Monitorimit të Frekuencave, ku ai u njoh me punën e stafit teknik, me funksionimin konkret të monitorimit të frekuencave në Republikën e Shqipërisë si dhe me tërësinë e pajisjeve elektronike, veprave inxhenerike dhe flotën e automjeteve të veçanta nëpërmjet të cilave, autoriteti rregullator përmbush misionet e tij të posaçme për sa i takon spektrit të frekuencave dhe mbarëvajtjes së rrjeteve publike të telekomunikacioneve. Delegacioni u njoh gjithashtu në detaj me investimet madhore të kryera në AKEP vitet e fundit për sa i përket sigurisë kibernetike dhe vlerësoi standardet e larta të hapësirave që i janë dedikuar funksionimit të serverave dhe infrastrukturave kritike të menaxhuara nga AKEP-i.



*Prezantim i Sektorit të Monitorimit të Frekuencave nga z. Vasil Mitezi, Drejtor i Drejtorisë, në takim të zhvilluar me Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit (Burimi: AKEP)*

Përmes kësaj ndalese në godinën e faciliteteve teknike të AKEP-it synohej t'i bëhej e njohur zonjave dhe zotërinjve deputetë sesi AKEP garanton, në përditshmëri, sigurinë dhe mosinterferencat gjatë përdorimit të një burimi natyror të çmuar dhe të fundmë siç është radiospektri. Kjo pjesë e vizitës së punës i shërbeu gjithashtu AKEP-it për të tërhequr vëmendjen mbi një veçori sistematike të tijën, që e dallon nga rregullatorët e tjerë sektorialë, dhe që konsiston, në thelb, në rolin e tij si administrues dhe operues i infrastrukturave kritike.

Vizita e Komisionit u përmbyll me një drekë pune të shtruar nga Kryetari i Këshillit Drejtues të AKEP-it në nder të Delegacionit Parlamentar. Në një atmosferë të përzemërt, bashkëbisedimet u fokusuan në temat e konektivitetit dhe të digjitalizimit, si edhe të impaktit që ato pritet të sjellin në ekonominë, në mirëqenien, dhe në përparimin e vendit dhe të qytetarëve shqiptarë.





*Pamje nga diskutimet me anëtarët e Komisionit të Veprimtarisë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit  
(Burimi: AKEP)*

### 3. Zbatimi i rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2023

Në zbatim të rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Rezolutën e datës 20.7.2023, “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2022”, AKEP është udhëhequr nga angazhimi maksimal për përmbushjen e tyre, duke punuar me përkushtim dhe profesionalizëm. Të 13 rekomandimet e dhëna për vitin 2023 në Rezolutën e Kuvendit janë realizuar plotësisht. Përmbushja e rekomandimeve është konkretizuar në këto masa dhe veprime.

1. Për AKEP, pikat e Rezolutës, të renditura të parat, kanë qenë një nga prioritetet më të rëndësishme jo vetëm për vitin 2023, por në një hark kohor afatmesëm.

Për të adresuar sfidën që paraqet kufizimi i operatorëve celularë nga 3 në 2, situatave të krijuara nga bashkimi i dy operatorëve One Telecommunication sh.a., dhe Albtelecom sh.a., në operatorin e vetëm One Albania sh.a., dhe krijimit të një tregu duopol, AKEP ka ndërmarrë dhe ka vendosur në planin e vet të punës një sërë masash dhe veprimtarish.

Në radhë të parë, AKEP ka shtuar vëmendjen mbi evoluimin e tre prej parametrave kryesorë që institucioni ynë mban në mbikëqyrje: çmimet e pakicës, treguesit e cilësisë së shërbimit dhe nivelin e investimeve. AKEP është i gatshëm të ndërhyjë përmes instrumenteve ligjorë dhe rregullatorë, që janë në dispozicion të tij, dhe t’i referojë Autoritetit të Konkurrencës rastet që mund të ngrenë dyshime për marrëveshje të ndaluara apo abuzim me pozitën dominuese. Në këtë kuadër, në vijim të bashkëpunimit midis dy institucioneve, AKEP-i përgjatë gjithë vitit ka përcjellë pranë Autoritetit të Konkurrencës informacion të detajuar mbi planet tarifore të shërbimeve mobile, si dhe ndryshimet e tyre me arsyetimet mbështetëse, të depozituara pranë AKEP-it nga sipërmarrësit e shërbimeve të komunikimeve elektronike.

2. Institucioni ka pasur vëmendje të shtuar përgjatë vitit 2023, për sa i përket garantimit të integritetit dhe pacenueshmërisë së rrjeteve të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike.

Krahas raportimeve dhe masave që lidhen me sigurinë kibernetike, të cilat janë detyrime ligjore ose rregullatore për sipërmarrësit e komunikimeve elektronike, AKEP-i ka kërkuar vazhdimisht edhe informacione, raportime apo masa shtesë nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike, për të bërë të mundur garantimin e integritetit dhe pacenueshmërinë e rrjeteve. Gjithashtu ka kërkuar nga sipërmarrësit që të rrisin nivelet e sigurisë në infrastrukturën e tyre në nivelin maksimal, ku në shumë raste është dashur edhe ndërhyrje në

---

investime të reja nga sipërmarrësit.

Në bashkëpunim të ngushtë me sipërmarrësit e komunikimeve elektronike, në shumicën e rasteve ka qenë vendimtar në zgjidhjen e incidenteve të sigurisë kibernetike si për institucione publike, ashtu edhe për biznese të cilat janë klasifikuar si infrastruktura kritike kombëtare.

Për sa i përket masave të marra nga ana e AKEP-it në lidhje me infrastrukturën dhe sistemet e institucionit, janë kryer 3 investime gjatë vitit 2023, të cilat kanë rritur ndjeshëm nivelin e sigurisë për infrastrukturën dhe sistemet që AKEP-i ka ndërtuar, mirëmban dhe administron.

3. Ka marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së në lidhje me sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e të dhënave, duke krijuar një grup pune të përhershëm për mbikëqyrjen e situatës së sigurisë kibernetike për sipërmarrësit e komunikimeve elektronike që direkt ose indirekt janë të lidhur me infrastruktura kritike kombëtare.
4. AKEP-i ka qenë pjesë aktive e Grupit Ndërinstitucional të Punës (GNP) për lirim të Digital Divident 2 (DD2) për brezin 700 MHz, duke paraqitur zgjidhje për procesin, si edhe duke prezantuar pozicionimin e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike, lidhur me brezin 700 MHz dhe informacionet e nevojshme lidhur me pritshmëritë e tregut celular për rrjetet 5G.
5. Lidhur me tregun postar në fokus të veprimtarisë së AKEP-it ka qenë dhe është edhe lufta kundër informalitetit. Në këtë kuadër, strukturat inspektuese të AKEP-it realizuan gjatë vitit 2023 inspektimin e subjekteve, të cilat reklamoheshin në rrjetet sociale aktivitet në fushën e shërbimeve postare, duke bashkëpunuar me organet ligjzbatuese për evidentimin dhe vënien përpara përgjegjësisë ligjore të shkelësve, me qëllim përmirësimin e klimës së biznesit dhe ndërgjegjësimin e subjekteve në përmbushjen e rregullave dhe standardeve ligjore të vendosura.
6. Në zbatim të Memorandumit të Bashkëpunimit me AMA-n dhe krijimit të TASK-FORCE të përbashkët AMA dhe AKEP, gjatë vitit 2023 janë realizuar inspektime tek sipërmarrësit e komunikimeve elektronike, aktiviteti i të cilëve është objekt inspektimi i këtyre dy institucioneve. Pasi u inspektuan 12 (dymbëdhjetë) sipërmarrës të komunikimeve elektronike, në 3 (tre) prej tyre u konstatua se nuk plotësonin detyrimin mbi respektimin e rasteve të kufizimeve në lidhje me përmbajtjen e paligjshme ose të dëmshme apo detyrime të tjera rregullatorë. Me përfundimin e procedurës inspektuese, ndaj sipërmarrësve që u konstatuan problematika mbi detyrimet rregullatore u vendosën edhe masa administrative sipas përcaktimeve të nenit 137, të

ligjit të nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe dënime plotësuese në formë rekomandimi.

7. AKEP-i ka punuar ngushtësisht me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë mbi hartimin e draftit të projektligjit të komunikimeve elektronike, i cili transponon plotësisht kodin. Dhe, pas një pune gati dy vjeçare, pasi janë marrë komente nga institucionet, palët e interesit dhe Komisioni Europian, është hartuar një dokument final i cili është miratuar pranë Këshillit të Ministrave dhe i është përcjell Kuvendit të RSH për miratim.
8. Duke u mbështetur në rekomandimin e Autoritetit të Konkurrencës dhe në vendimin e tij për lejimin e përqendrimit mes ONE dhe Albtelecom, AKEP-i nxiti dhe mbështeti një operacion delikat që ka transformuar peizazhin e zotërimeve spektrale në dobi të konkurrencës, eficiencës së përdorimit të spektrit, dhe stimulimit të investimeve në funksion të rritjes së cilësisë së rrjeteve dhe mbulimit të tyre. Transaksioni midis dy operatorëve ka passjellë edhe një ripozicionim të zotërimeve spektrale, duke lejuar vijimësinë e blloqeve spektrale të zotëruara nga i njëjti operator, duke garantuar një eficiencë maksimale të përdorimit spektral që stimulon investimet në rrjetet përkatëse të operatorëve duke u përkthyer në cilësi dhe në mbulim më të lartë. Sipas analizës së AKEP-it, blloqet e lira në breza të ndryshëm të spektrit të frekuencave janë adekuate dhe të mjaftueshme për të lejuar aksesin e një operatori të ri (MNO) që mund të jetë i interesuar të ofrojë në vendin tonë rrjete të telefonisë celulare.
9. Në kuadër të detyrimeve të Rregullores 49/2021, AKEP ka bashkëpunuar me operatorët dhe institucionet përkatëse si Agjencia Kombëtare e Emergjencave Civile (AKMC) në kuadër të unifikimit të numrit të emergjencës 112 për të gjithë Shqipërinë, për të bërë të mundur që marrja e SMS-ve dhe informacionit të vendndodhjes të mundësohet edhe nga platformat e trajtimit të thirrjeve/komunikimeve të emergjencës.
10. Në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit, AKEP ka vijuar të kërkojë nga «Posta Shqiptare» sh.a., përmbushjen e detyrimit për shpërndarjen e objekteve postare në adresën e marrësit, si një problematikë e cila vijon të mbetet. AKEP vijon të monitorojë në vijimësi procesin e përmbushjes së rekomandimeve të lëna, duke kryer edhe procesin e inspektimit në fundin e vitit dhe duke lënë rekomandimet përkatëse.
11. Në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, AKEP ka përfunduar punën me konsulentin e përzgjedhur nga MIE në lidhje me projektin “Zhvillimi i ATLAS të *Broadband* të Shqipërisë”, projekt në kuadër të investimeve të EU përmes programit të investimeve në Ballkanin Perëndimor.

---

Raporti përfundimtar është dorëzuar nga konsulenti pranë MIE dhe AKEP, në formë zyrtare, në fillim të muajit shkurt 2023. Në takimin e datës 28.9.2023 (zhvilluar në Budva, Mali i Zi, përgjatë Forumit Rajonal Rregullator), AKEP kërkoi nga ITU mbështetje për të çuar përpara ndërtimin e Atlasit të ri. Mbështetja u kërkua konkretisht për hartimin e termave të referencës, por edhe mundësi për financimin e këtij projekti nga ITU si dhe dhënien e ndihmës për marrjen e eksperiencave më të mira për ndërtimin e Atlasit *broadband*.

12. Në përmbushje të plotësimit të detyrimeve të ngarkuara nga Rezoluta lidhur me problematikën e sistemit të kabllave ekzistuese në shtyllat e energjisë elektrike, edhe gjatë vitit 2023 AKEP-i ka vijuar të ndjekë me tepër vëmendje situatën e rrjeteve dhe infrastrukturës së sipërmarrësve në zonat e identifikuara si problematike, si dhe të ndërhyjë në disa zona për eliminimin e infrastrukturës ajrore sipas planit vjetor të inspektimit, me qëllim plotësimin e kushteve teknike të përcaktuara në Rregulloren nr.22, datë 24.6.2011, “Mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërrurbane të komunikimeve elektronike”.

AKEP i është drejtuar shkresërisht Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, i cili ka në përbërjen e tij Nënkomisionin për Qeverisjen Vendore, për t’i propozuar fillimin, në suazën e Nënkomisionit për Qeverisjen Vendore, të një procesi angazhues auditimi dhe ndërgjegjësimi të pushtetit vendor, në lidhje me problematikat e zhvillimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike në terren dhe të bashkëpunimit serioz institucional me AKEP-in.

Në këtë aspekt, AKEP-i vijon të ndjekë me përparësi këtë problematikë duke e koordinuar punën me të gjithë aktorët e tjerë të këtij procesi, dhe duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet tyre mbi rregullimin e përdorimit e infrastrukturës pasive.

13. Një rëndësi të veçantë përgjatë këtij viti AKEP i ka kushtuar Monitorimeve të QoS (kualiteti i cilësisë së shërbimit) të akteve të reja rrugore, duke kërkuar nga dy operatorët, marrjen e masave për zgjidhjen e problematikave të ofrimit të shërbimeve të telefonisë së lëvizshme, ndërtimin e stacioneve të reja, shtimin e antenave të reja të dedikuara në stacionet ekzistuese si dhe optimizimin e stacioneve ekzistuese.



# DREJTIMET KRYESORE TË PROGRAMIT TË PUNËS PËR VITIN 2024

1. Nisja, mbikëqyrja dhe përfundimi me sukses i proceseve administrative për dhënien në përdorim të frekuencave në brezat pionierë 3400-3800 MhZ të gjeneratës së re, me synim jetësimin e shërbimeve 5G, vënien në shfrytëzim të plotë dhe eficient të radiospektrit dhe nxitjen e konkurrencës përmes inovacionit dhe garantimit të cilësisë;
2. Angazhimi në një reflektim gjithëpërfshirës për hartimin e një dokumenti pune për reformimin e strukturës organizative, financimin dhe funksionimin e brendshëm të institucionit, me synim pajisjen e AKEP-it me aftësi dhe mjete performante për përmbushjen e detyrave rregullore dhe përballimin e sfidave në administrimin dhe operimin e infrastrukturave kritike;
3. Përditësimi dhe përafrimi me praktikat më të mira i kuadrit rregullator të administrimit të domainit.al dhe nëndomaineve përkatëse, si edhe garantimi i qëndrueshmërisë teknologjike dhe financiare të operimit të regjistrimit të ccTLD-së;
4. Miratimi i dokumenteve përfundimtare të analizës së tregjeve me shumicë të aksesit *broadband* fiks dhe të analizës së tregut të telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme, si edhe mbikëqyrja e vënies në zbatim nga sipërmarrësit të vendimeve përkatëse dhe masave rregullore eventuale;
5. Miratimi i planit të punës për zbatimin e legjislacionit të ri të komunikimeve elektronike me fokus inventarizimin e detyrave të reja ose të rishikuara në kuadrin rregullator, identifikimin e akteve rregullore dhe dokumenteve administrative për t'u përshtatur, kalendarizimin e vendimmarrjeve dhe fillimin e proceseve ligjzbatuese;
6. Përmirësimi i proceseve të përfuturit të të dhënave në kohë reale mbi cilësinë e shërbimit në shkallë kombëtare, me synim mbikëqyrjen dhe garantimin e vazhdueshëm të të drejtave të pajtimtarit si përdorues i shërbimeve të komunikimeve elektronike në tregun e telefonisë së lëvizshme të karakterizuar nga operimi i dy sipërmarrësve të mëdhenj.

# I. PANORAMË E ZHVILLIMEVE NË TREGJET E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

## 1. Vështrim i përgjithshëm mbi aspekte rregullatore në sektor

### 1.1. Kantieri i përafrimit me legjislacionin europian dhe impakti i pritshëm në legjislacionin vendas

AKEP përgjatë vitit 2023 ka marrë pjesë në grupet ndërinstitucionale të punës të krijuara për kapituj të *acquis*, ku janë kryer analiza specifike mbi situatën e politikave, legjislacionit, financimit, si dhe procedurave administrative.

Kapitulli 10 “*Shoqëria e Informacionit dhe Media*”, është ndër kapitujt kryesor në të cilin AKEP-i kontribuon, kapitull i cili ka si qëllim të sigurojë liberalizimin e shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimit elektronik, të eliminojë pengesat për funksionimin efektiv të tregut të vetëm, të promovojë konkurrencën, të ruajë interesat e konsumatorit në këtë sektor dhe të krijojë shërbime moderne të disponueshme në mënyrë universale.

Ndër pikat kryesore të kontributit të AKEP-it në këtë kapitull sa i përket shoqërisë së informacionit, është implementimi i Memorandumit të Mirëkuptimit mes Vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Këshillit Rajonal të Kooperimit, mbi Udhërrëfyesin 5G, si dhe në aspektet e shërbimeve të komunikimeve elektronike, ku AKEP ka dhënë kontribut/përditësime në zbatimin e numrit unik të emergjencave (112), të drejtave të përdoruesve, shërbimin universal, si dhe implementimin e Rregullores së re të Domaineve të Bashkimit Europian (BE) 517/2019.

Implementimi në legjislacionin vendas, sikurse është theksuar edhe në raportimin e përfaqësuesve të AKEP-it në shkurt të vitit 2023 pranë Komisionit Europian për Kapitullin 10, konsiston ndër të tjera në rritjen e pavarësisë funksionale të AKEP-it, çfarë dhe pritet të përmbushet me miratimin gjatë vitit 2024 nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë të Ligjit të ri, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Ky akt do të adresojë më mirë problematikat e tregut, përmbushjes së objektivave strategjike për një shoqëri gigabit, duke marrë në konsideratë ndryshimet e vazhdueshme të teknologjive, si dhe duke plotësuar rekomandimin e Progres Raportit të vitit 2021 të BE-së për Shqipërinë në Kapitullin 10 “*Shoqëria e Informacionit dhe Media*”, për transpozimin e direktivës 2018/1972/EU.

Në vijim të detyrave të realizuara në kuadër të kontributit për raportimin për Kapitullin 3, sa i përket shërbimeve postare, ku vetë *acquis* synon hapjen e këtij sektori ndaj konkurrencës në mënyrë graduale dhe të kontrolluar, brenda një kuadri rregullator që siguron një shërbim universal, sipas Raportit të vitit 2023 të Komisionit Europian, Shqipëria është në përmbushje të plotë të transpozimit të direktivës së BE-së për Shërbimin Postar, duke siguruar ndër të tjera një konkurrueshmëri të plotë në këtë sektor.

Në raportet e fundit të BE-së për Shqipërinë është rekomanduar të vijohet procesi për miratimin e ndryshimeve të nevojshme në Ligjin për Komunikimet Elektronike, në përputhje me Kodin e ri Europian të Komunikimeve Elektronike dhe të miratohet plani i veprimit për agjendën digjitale.

Transpozimi i Direktivës (EU) 2018/1972 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit “Për krijimin e Kodit Europian të Komunikimeve Elektronike”, përbën pikënisjen e procesit të ndryshimeve të kuadrit ligjor të AKEP.

Projektakti ka si qëllim të rishikojë dhe përmirësojë kuadrin e përgjithshëm rregullator për komunikimet elektronike, të përcaktuar me ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim nxitjen e investimeve për rrjetet e komunikimeve elektronike me kapacitete shumë të larta (VHCN), si ato me fibër optike, ashtu edhe ato wireless (5G). Projektligji rishikon rregullimet në fuqi, në lidhje me spektrin e frekuencave, regjimin e shërbimit universal, rregullat për mbrojtjen e konsumatorit, numeracionin dhe komunikimet e emergjencave, rregullat për aksesin dhe rregullimin e tregut në tërësi, bazuar në një rregullim më simetrik.

Ky projektligj synon të transpozojë Direktivën (EU) 2018/1972 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit “Për krijimin e Kodit Europian të Komunikimeve Elektronike”, që ka zëvendësuar paketën e direktivave të komunikimeve elektronike të vitit 2002 dhe 2009 dhe kodifikon në një dokument të vetëm të gjithë elementët e ndryshëm të ligjit, që përbëjnë Kornizën Rregullatore të BE-së për komunikimet elektronike, si dhe riorganizon kuadrin rregullator të komunikimeve elektronike, në një mënyrë që arrin atë që duket të jetë një ekuilibër i ndryshëm politik, midis rëndësisë së ruajtjes së konkurrencës, nga njëra anë, dhe nevojës për investime të mëdha, të cilat konsiderohen të nevojshme për të çuar përpara Strategjinë e Tregut të Vetëm Digjital.

Rishikimi i kornizës rregullatore të komunikimeve elektronike fokusohet në masat të cilat kanë për qëllim të parashikojnë iniciativa për investimin në rrjetet *broadband* të shpejtësisë së lartë, duke sjellë një qasje më të qëndrueshme të tregut të brendshëm në politikat dhe menaxhimin e spektrit radio, evitimin e fragmentarizimit të kuadrit rregullator, sigurimin e mbrojtjes efektive të konsumatorit dhe të parashikojë një

---

kornizë rregullatore institucionale më efektive. Mjedisi teknologjik dhe procesi i ndryshimeve të tregut përbëjnë shtysat kryesore për forcimin e kuadrit institucional.

Hyrja në fuqi e ligjit të ri pritet të ketë impakt domethënës në legjislacionin vendas në pikëpamje të hartimit dhe hyrjes në fuqi të akteve nënligjore të dala në zbatim të ligjit në fjalë, të tilla si Vendime të Këshillit të Ministrave dhe Akte Rregullatore të nxjerra nëpërmjet vendimeve përkatëse të Këshillit Drejtues të AKEP.

Në lidhje me AKEP, mund të nënvizohet pavarësia e organit rregullator, roli i Këshillit Drejtues, vendimmarrja dhe drejtimi, financimi, buxheti i cili vjen si një risi dhe do të miratohet nga organi drejtues, parimet e aplikimit të tarifave administrative, pagesat që bëhen në AKEP, pagesat për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike, pagesa për alokimin dhe përdorimin e numrave, serive të numrave dhe frekuencave, tarifat për të drejtat e përdorimit të spektrit të radios, tarifat për të drejtën e përdorimit të burimeve numerike, bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve kompetente dhe çdo gjë tjetër që ka lidhje me krijimin dhe mënyrën e funksionimit të AKEP-it si rregullator, bashkëpunimit të tij me institucionet e tjera dhe të Këshillit Drejtues të tij.

Gjatë vitit 2023 AKEP-i ka ndjekur me përparësi raportimet dhe pjesëmarrjet në takimet e Komisionit European, duke dhënë kontribut përgjatë procesit të shqyrtimit analitik të legjislacionit, duke siguruar pjesëmarrjet fizike dhe virtuale në nivel drejtues sipas kapitujve të mëposhtëm.

- Kapitullin 1, «Lëvizja e lirë e mallrave»
- Kapitullin 3, «E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime»
- Kapitullin 8, «Politikat e Konkurrencës»
- Kapitullin 10, «Shoqëria e Informacionit dhe Media»
- Kapitullin 23, «Gjyqësori dhe e Drejta Themelore»
- Kapitullin 28, «Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndetit»

AKEP është kontribues kryesor në Kapitullin 10, e gjithashtu edhe në Kapitullin 3.

## **1.2. Treguesit statistikorë të tregjeve të komunikimeve elektronike**

### **Tregu i shërbimeve celulare Struktura e pajtimtarëve**

Për sa i përket treguesve kryesorë të tregut celular, viti 2023 ka shënuar ndryshime të rëndësishme në strukturën e këtij tregu, siç ishte bashkimi me anë të përthithjes i operatorit Albtelecom sh.a., nga operatori One Telecommunications sh.a., gjë që ka çuar në rikonfigurimin e këtij tregu.

Aktualisht, duke filluar nga data 1.1.2023 në treg janë vetëm dy operatorë celularë:

Vodafone Albania sh.a. dhe One Albania sh.a.

Nga pikëpamja e përdorimit të rrjeteve celulare, të dhënat e evidentuara nga AKEP-i tregojnë se numri total i kartave SIM arriti në rreth 3.8 milionë gjatë vitit 2023:

- rreth 1.4 karta SIM për banor, shifër më e lartë se mesatarja e rajonit të Europës dhe ajo globale, përkatësisht 1.23 dhe 1.11 karta SIM për banor<sup>1</sup>.

Ndërkohë numri i pajtimtarëve aktivë<sup>2</sup> të shërbimeve mobile përgjatë vitit të kaluar, arriti rreth 2.6 milionë, duke shënuar rënie krahasuar me vitin e mëparshëm.

Përgjatë vitit 2023 ka vijuar tendenca e ndryshimit të strukturës së pajtimtarëve, ku vihet re :

- ulje e numrit të pajtimtarëve me parapagim (62% nga 68% që ishte në vitin 2022);
- rritje simetrike e blerjes së shërbimeve mobile përmes kontratave me paspagim, praktikë e cila aplikohet gjerësisht në vendet e rajonit dhe të BE-së.

### **Mbizotërimi i përdorimit të data-ve në shërbimet celulare**

Volumi i të dhënave të transmetuara nëpërmjet internetit në rrjetet mobile, arriti në rreth 193 milionë GB. Kjo përbën një rritje rreth 4.95% krahasuar me vitin 2022.

Numri i pajtimtarëve aktivë që kanë përdorur shërbimin internet celular në fund të vitit 2023 kapi shifrën prej rreth 2 milionë pajtimtarë, çka përbën një rënie me rreth 2.69% krahasuar me vitin pararendës.

Edhe pse viti 2023 shënoi finalizimin e procesit të bashkimit me përthithje të dy operatorëve celularë (Albtelecom sh.a., dhe One Telecommunication sh.a.) dhe si rezultat ekzistencën në treg të vetëm dy operatorëve celularë, numri i përdoruesve me akses *broadband* mobile është pothuajse në të njëjtin nivel me vitin 2022.

### **Viti 2023 shënoi ulje të treguesve kryesorë të:**

- përdoruesve aktivë të shërbimeve celulare;
- përdoruesve aktivë që përdorin shërbimin e aksesit në internet *broadband*;
- volumit të thirrjeve telefonike dalëse të përdoruesve celularë;
- volumit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare;
- volumit të thirrjeve hyrëse kombëtare;
- numrit të SMS-ve.

1 <https://www.itu.int/en/ITU-D/Statistics/Documents/facts/FactsFigures2023.pdf>

2 Pajtimtar i cili ka përdorur shërbimet celulare të paktën një herë brenda tre muajve të fundit.

## Vlen të theksohet gjithashtu se gjatë vitit 2023:


- volumi mesatar mujor i thirrjeve për përdorues ka shënuar rënie me rreth 14% duke arritur në 268 minuta thirrje hyrëse dhe dalëse,
- volumi i konsumit mesatar mujor të internetit është rritur me përafërsisht 5% duke arritur në rreth 7.64 GB në muaj

Për sa i përket thirrjeve brenda rrjetit dhe drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare rezulton që, gjatë vitit 2023, rreth 38% e thirrjeve të realizuara kanë qenë drejt operatorëve të tjerë celularë 'off-net' dhe rreth 61% brenda rrjetit 'on-net', duke shënuar një ndryshim me respektivisht 4 dhe 5 pikë përqindje nga viti i kaluar për të dy treguesit.

## Ecuria e treguesve të *roaming* në Ballkanin Perëndimor

Bazuar në të dhënat mbi ecurinë e implementimit të 'Roam Like At Home' në vendet e Ballkanit Perëndimor, rezulton se edhe përgjatë vitit 2023 ky proces ka qenë mjaft i suksesshëm, gjë e cila paraqitet edhe në ecurinë e numrit të përdoruesve dhe volumet e komunikimeve elektronike (voice, data dhe sms).

### Numri i pajtimtarëve që kanë përdorur shërbimet *roaming* në BP




*Burimi:* Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit. Përpunimi AKEP.

Siç vërehet në grafikun e mësipërm numri i pajtimtarëve që kanë përdorur shërbimet *roaming* gjatë qëndrimit të tyre në një nga vendet e Ballkanit Perëndimor ka shënuar rritje të vazhdueshme duke arritur në **mbi 800 mijë pajtimtarë në vitin 2023, me një rritje rreth 36%** nga viti pararendës.



## Të dhënat e përdorimit të internetit në roaming në BP (në GB)



**Burimi:** Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit. Përpunimi AKEP

Rritja e numrit të pajtimtarëve që përdorin shërbimet *roaming* gjatë qëndrimit të tyre në vendet e BP njëkohësisht u shoqërua me rritje të njësisive të internetit të konsumuara nga këta pajtimtarë, dhe konkretisht konsumi i internetit u rrit me rreth 43% më shumë se viti 2022.

## Mbulimi nga rrjetet celulare

Dy operatorët që ofrojnë shërbime celulare, për vitin 2023 kanë raportuar mbulim të popullsisë me rrjet 3G në nivele rreth 99%.

Për sa i përket mbulimit të territorit dhe popullsisë me rrjet LTE (4G), bazuar në raportimet e kryera për vitin 2023, rezulton se:

- Sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a., ka mbulimin më të gjerë me këtë teknologji, duke arritur nivelin 97% të mbulimit të territorit me rrjet 4G, dhe 100% të mbulimit të popullsisë.
- Sipërmarrësi One Albania sh.a., ka mbulim të territorit me rrjet 4G me 96% dhe mbulim të popullsisë 99%.

## Dinamika e pjesëve të tregut të shërbimeve celulare

Edhe gjatë vitit 2023, sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a., vazhdon të jetë operatori me pjesën më të madhe të tregut për të gjithë treguesit kryesorë të shërbimeve të komunikimeve elektronike mobile.

Konkretisht pjesët e tregut për vitin 2023 për sipërmarrësin Vodafone Albania sh.a., varrojnë me:

- rreth 47% të pjesës së tregut për përdoruesit e SIM card;
- rreth 51% të pjesës së tregut për përdoruesit e SIM card aktivë;
- rreth 55% të tregut për thirrjet dalëse;
- rreth 54% të tregut për volumin e të dhënave (internetit);
- rreth 56% të tregut për përdoruesit aktivë të internetit (*broadband*);
- rreth 56% të tregut përkatësisht të të ardhurave totale dhe ato nga shërbimet me pakicë.


Pjesët e tregut për disa nga treguesit kryesorë për sipërmarrësin One Albania sh.a., janë si më poshtë:

- rreth 53% të pjesëve të tregut për përdoruesit e SIM card;
- rreth 49% të pjesës së tregut për përdoruesit e SIM card aktivë;
- rreth 45% të tregut për thirrjet dalëse;
- rreth 46% të tregut për volumin e të dhënave (internetit);
- rreth 44% të tregut për përdoruesit aktivë të internetit (*broadband*);
- rreth 44% të tregut përkatësisht të të ardhurave totale dhe ato nga shërbimet me pakicë.

### Tregu fiks

Për herë të parë përgjatë vitit 2023 numri i pajtimtarëve me akses *broadband* nga rrjetet fikse arriti në mbi 631 mijë, e thënë ndryshe rreth 8% më shumë se vitit i kaluar.

Norma e penetrimit të aksesit *broadband* nga rrjetet fikse për familje<sup>3</sup>, në fund të vitit 2023 arriti në 87%, duke shënuar rritje me rreth 6% krahasuar me periudhën pararendëse.




*Burimi:* Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit. Përpunimi AKEP

3 Numri i familjeve sipas Censurit 2011.

Gjatë vitit 2023, trafiku i internetit *broadband* nga rrjete fikse arriti në rreth 1.25 miliardë GB ose rreth 24% më shumë se viti 2022, çka tregon se pajtimtarët e këtij shërbimi e kanë shfrytëzuar këtë rrjet për të aksesuar shërbimet e tyre financiare, informative, sociale, shëndetësore, etj.

Struktura e pajtimtarëve me akses në shërbime interneti fiks po evoluon në mënyrë të pandërprerë drejt shërbimeve *broadband* me shpejtësi shkarkimi mbi 30 Mbps. Rreth 69% e pajtimtarëve kanë pasur në vitin 2023 akses në lidhje fikse të kësaj shpejtësie.




*Burimi:* Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit. Përpunimi AKEP

Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun sa më sipër, vihet re se në fund të vitit 2023 numri i pajtimtarëve që kanë akses me shpejtësi më shumë se 30 Mbps përbën rreth 69% të totalit të numrit të pajtimtarëve me akses *broadband* nga rrjetet fikse, duke shënuar rritje të konsiderueshme me periudhën pararendëse, ku pajtimtarët me shpejtësi më shumë se 30 Mbps përbënin rreth 51% të totalit.

Ndërkaq, numri i pajtimtarëve të shërbimeve *broadband* nga rrjetet fikse me akses mbi 100 Mbps është 179,537 (rreth 28% e pajtimtarëve), duke shënuar rritje mjaft të konsiderueshme krahasuar me vitin pararendës (rreth 12% të totalit të pajtimtarëve për 2023).

## Mbulimi me *broadband* fiks


Mbulimin përherë e më lartë me *broadband* të shpejtë dhe shumë të shpejtë e udhëheq shtrirja gjithnjë e më domethënëse e teknologjisë FTTH/FTTB, që ka shënuar rritje me rreth 17% krahasuar me vitin 2022.



*Burimi:* Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit. Përpunimi AKEP

## Paketat e integruara (Bundles)

Numri i pajtimtarëve të rrjeteve fikse që kanë akses në shërbime të integruara dyfishe ose trefishe (kombinim Telefoni/Internet/TV), në fund të vitit 2023 arriti në rreth 300 mijë, rreth 6% më pak se në vitin 2022.



*Burimi:* Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit. Përpunimi AKEP

## Pjesët e tregut fiks

Në fund të vitit 2023 numri i sipërmarrësve që kanë njoftuar ofrimin e shërbimeve nga rrjetet fikse në Shqipëri është 252.

Pjesa më e madhe e operatorëve alternativë janë të vegjël dhe me prani shumë të kufizuar rrjeti në zona urbane apo rurale afër qendrave urbane.


Tregu i ofrimit të shërbimeve *broadband* nga rrjetet fikse karakterizohet nga një numër i lartë pjesëmarrësish, të cilët ofrojnë larmishmëri të lartë paketash dhe ofertash për pajtimtarët e këtyre shërbimeve.

Për vitin 2023 operatorët me pjesët më të madhe të tregut *broadband fiks*, për sa i përket numrit të pajtimtarëve, janë renditur si më poshtë:

- One Albania zotëron rreth 22% pjesë tregu;
- Vodafone Albania zotëron 20% pjesë tregu;
- A.S.C zotëron 10% pjesë tregu;
- Abissnet me rreth 7% pjesë tregu;
- Digicom rreth 5% të pjesës totale të tregut;
- Nisatel me rreth 4% pjesë tregu;
- OA (operator të tjerë), me 32% të tregu.

## Të ardhurat dhe investimet e rrjeteve të komunikimeve elektronike

Bazuar në të dhënat e raportuara nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike për vitin 2023 rezulton se nga ofrimi i këtyre shërbimeve përgjatë këtij viti sipërmarrësit kanë gjeneruar rreth 37 miliardë lekë, çka përbën një ulje me rreth tre pikë përqindje krahasuar me periudhën pararendëse. Rënie e cila është ndikuar nga rënia e të ardhurave të ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike nëpërmjet rrjeteve fikse.




Burimi: Të ardhura të raportuara nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike. Përpunimi AKEP.

Sic vërehet në të dhënat e paraqitura në grafikun sa më sipër, peshën më të madhe të të ardhurave e zenë të ardhurat e gjeneruara nga ofruesit e komunikimeve elektronike mobile.

### Shërbimet mobile

Edhe përgjatë vitit 2023 ofruesit e shërbimeve të rrjeteve mobile kanë realizuar të ardhura totale vjetore pothuajse të njëjta me ato të vitit 2022.



Burimi: Të ardhura të raportuara nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike. Përpunimi AKEP.


Edhe pse gjatë vitit 2023 sipërmarrësi One Albania filloi ofrimin e shërbimeve si i vetëm pas bashkimit të One Telecommunications me Altelecom, sërish sipërmarrësi me të ardhurat më të larta të gjeneruar në tregun e ofrimit të shërbimeve mobile mbetet Vodafone Albania, me rreth 56% të totalit të këtij tregu.

Përgjatë vitit 2023 sipërmarrësit mobile kanë investuar rreth 1.8 miliardë lekë, investime të cilat kanë pasur fokus kryesor përmirësimin e ofrimit të shërbimeve broadband nga këto rrjete.

### Shërbimet Fikse


Në ndryshim nga periudhat pararendëse ku të ardhurat e ofruesve të shërbimeve fikse kanë shënuar rritje të vazhdueshme, përgjatë vitit 2023 të ardhurat totale të gjeneruara nga ofruesit e shërbimeve të rrjeteve fikse shënuan rënie me rreth 10%, rënie e cila është ndikuar nga klasifikimi i të ardhurave të dy sipërmarrësve, të ardhurat e të cilëve janë kundërshtuar në proces gjyqësor për tu mos u karakterizuar si të ardhura të gjeneruara nga ofrimi i komunikimeve elektronike në Shqipëri (për vitin 2022 të ardhurat e raportuara nga këta sipërmarrës ishin rreth 1.3 miliardë leke).





Nga të dhënat e paraqitur sa më sipër vërehet se rënia në të ardhurat e ofruesve të shërbimeve fikse është ndikuar nga rënia e pjesës së tregut të totalit të operatorëve të tjerë të klasifikuar në grafikun e sipërcituar.

Të ardhurat e gjeneruara nga sipërmarrësit e medhënj dhe të mesëm përbëjnë rreth 81% të totalit të të ardhurave të gjeneruara për vitin 2023.



Burimi: Të dhëna të operatorëve: Përpunimi AKEP

---

Përgjatë vitit 2023, sipërmarrësit e rrjeteve fikse kanë kryer rreth 2.6 miliardë lekë investime në rrjetet e tyre duke shënuar rritje me rreth 3% krahasuar me vitin 2022. Sipas raportimeve, edhe në këtë vit investimet janë kanalizuar kryesisht në funksion të përmirësimit të aksesit të shërbimeve broadband, ku ndër investimet kryesore është fokusimi drejt zhvendosjes së rrjeteve të transmetimit nga teknologjia DSL drejt teknologjisë me fibër.

### ***1.3 Statusi i Shërbimit Universal***

#### **Statusi i Shërbimit Universal për komunikimet elektronike**

Sipas përcaktimeve të ligjit 9918/2008 objektivi kryesor i sigurimit të shërbimit universal në sektorin e komunikimeve elektronike është që përdoruesit në të gjithë territorin e RSH, pavarësisht vendndodhjes gjeografike, të kenë mundësinë e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve bazë të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike (për kryerjen dhe marrjen e thirrjeve telefonike dhe akses funksional, me shpejtësi të kënaqshme, në internet), dhe me çmim të përballueshëm. Realizimi i këtij objektivi duhet të arrihet duke marrë parasysh teknologjitë mbizotëruese të përdorura nga shumica e pajtimtarëve dhe mundësitë e realizimit teknologjik, sipas kushteve kombëtare.

Bazuar në të dhënat për mbulimin territorial dhe të popullsisë si dhe përdorimin e rrjeteve fikse dhe celulare në Shqipëri, rrjetet celulare kanë shërbyer si teknologjia mbizotëruese e përdorur në sigurimin e shërbimit universal për akses në shërbimet bazë të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike, pavarësisht vendndodhjes gjeografike dhe me çmime të përballueshme.

Mbulimi me rrjet celular GSM/3G që mundëson akses në rrjet publik të komunikimeve elektronike, përfshirë akses dhe përdorim interneti funksional, në fund të vitit 2023 rezultoi në pothuajse 99% të popullsisë dhe 96% të territorit. Në vitet e fundit ka pasur rritje të ndjeshme dhe të mbulimit me rrjetet 4G që mundëson akses broadband në internet nga rrjetet celulare, dhe sipas raportimeve të operatorëve në fund të vitit 2023 mbulimi me rrjet 4G arriti 100 % të popullsisë dhe 97% të territorit.

Nivelet shumë të larta të mbulimit të popullsisë dhe territorit të RSH nga rrjetet celulare, mundësojnë akses në rrjet publik i komunikimeve elektronike për të gjithë banorët, pavarësisht vendndodhjes gjeografike. Përveç mundësisë së aksesit në rrjetet celulare pavarësisht vendndodhjes gjeografike, edhe përdorimi i shërbimeve të ofruara nga rrjetet celulare është në nivel të lartë.

Në fund të vitit 2023, numri i përdoruesve aktivë të telefonisë celulare ishte 2,614,764, ndërsa numri i përdoruesve aktivë të aksesit broadband celular ishte 2,082,525, që përbëjnë respektivisht 95% dhe 75% të popullsisë së Shqipërisë.

Zhvillimet teknologjike, konkurrenca në treg dhe ndryshimet në kërkesën konsumatore (orientimi drejt përdorimit të aksesit broadband në internet) kanë bërë që në vitet e fundit të ketë një rritje të konsiderueshme të mbulimit dhe përdorimit/ numrit të pajtimtarëve të aksesit broadband nga rrjetet fikse në Shqipëri.

Sipas të dhënave statistikore të raportuara në AKEP nga sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve elektronike, numri i pajtimtarëve me akses broadband nga rrjete fikse në fund të vitit 2023 arriti në 631 mijë, që përbën një rritje prej 8% në krahasim me vitin 2022.

Ndryshimet në kërkesën për shërbimet telefonisë dhe aksesit broadband në rrjetet fikse kanë rezultuar në trende të kundërta në përdorimin e këtyre shërbimeve në vitet e fundit: rënie e qëndrueshme përdorimit të telefonisë fikse dhe rritje vjetore dyshifrore e numrit të pajtimtarëve të aksesit broadband fikse. Ndërsa në fund të vitit 2015 numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse (253 mijë) ishte disi më i lartë se numri i pajtimtarëve me akses broadband (243 mijë), në fund të vitit 2023 numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse arriti në 173 mijë që është afërsisht 4 herë më i ulët se numri i pajtimtarëve me akses BB fikse .

Megjithëse Shqipëria historikisht ka pasur nivele shumë të ulëta të përdorimit të shërbimeve dhe mbulimit me rrjete publike fikse në krahasim me vendet e BE-së, zhvillimet në vitet e fundit kanë çuar në një rritje të konsiderueshme të përqindjes së familjeve me akses broadband nga rrjete fikse, duke arritur në 87% në fund të vitit 2023, krahasuar me 37% në vitin 2016 kur ky tregues ishte më shumë se dy herë më i ulët se niveli mesatar në BE.

Përveç rritjes së konsiderueshme të numrit të përdoruesve të aksesit broadband fikse, ecuri shumë pozitive është vënë re dhe në shpejtësinë e aksesit broadband fikse. Në vitin 2023 numri i pajtimtarëve/lidhjeve me akses broadband fikse me shpejtësi 30 Mbps ose më të lartë (broadband i shpejtë dhe shumë i shpejtë) arriti në 69% të totalit të pajtimtarëve broadband fikse, krahasuar me vetëm 1% në vitin 2016. Ndërkohë, në vitin 2023 vetëm 6% e pajtimtarëve përdornin akses broadband fikse me shpejtësi më pak se 10 Mbps, krahasuar me 83% në vitin 2016.

Ndërsa të dhënat e mësipërme i referohen informacionit të deklaruar në AKEP nga sipërmarrësit (ana e ofertës), shkalla e lartë e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të aksesit në internet konfirmohet dhe nga të dhënat në anën e kërkesës sipas vrojtimeve të INSTAT.

Sipas të dhënave të publikuara nga INSTAT, bazuar në rezultatet e Anketës së Përdorimit të Teknologjisë së Informacionit (TIK) për familjet në vitin 2023:

- 83.1 % e popullsisë (grup-mosha 16-74 vjeç) përdorin internetin, nga të cilët 96.26 % e përdorin çdo ditë;
- Përqindja e familjeve shqiptare që kanë akses në internet është 96.7 %, krahasuar

me 96.5% të një viti më parë.

- 90.4 % ose rreth 660 mijë familje kanë akses në internet me rrjet fiks broadband (rrjet fibër optike ose kabllor, ADSL, etj.),.
- Përqindja e familjeve me akses në internet nëpërmjet lidhjes “mobile broadband” (3G/4G, tablet, etj.), është 99.3 %, krahasuar me 99.2 % në vitin 2022.
- 99.8 % e individëve kanë përdorur aparat celularë / telefona inteligjent (smart) për të hyrë në internet. Ndërkohë 28.2 % e popullsisë e përdorin internetin nëpërmjet laptopit, 27.4 % nëpërmjet kompjuter / desktop dhe 19.1 % nëpërmjet tabletit.
- 98,7 % e individëve që përdorin internetin kryejnë thirrje/video thirrje përmes përdorimit të aplikacioneve OTT (p.sh. Whatsapp, Skype, Viber etj.)

Të dhënat e mësipërme në lidhje me shkallën e mbulimit të territorit dhe popullsisë dhe përdorimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, dëshmojnë se rrjetet celulare dhe fikse mundësojnë akses në rrjet publik të komunikimeve elektronike dhe akses broadband në internet për pothuajse të gjitha familjet dhe popullsinë e Shqipërisë, pra pavarësisht vendndodhjes gjeografike të përdoruesit.

Tabela e mëposhtme paraqet informacion sipas të dhënave më të fundit të publikuar nga ITU<sup>4</sup> mbi përballueshmërinë e çmimeve të TIK, duke bërë një krahasim të përballueshmërisë së shpenzimeve për shportat përkatëse të ITU-së për Shqipërinë për vitet 2022-2023 dhe krahasimin me mesataren botëror për vitin 2023.

Tabela : Shpenzimet për shportat e TIK të ITU në raport me GNI për frymë (2022/2023)

Shportat TIK të ITU	Shqipëria		Mesatarja Botërore
	2022	2023	2023
Shporta akses broadband fiks (256kbps / 5GB)	1.27	2.07	2.21
Shporta shërbim celular me përdorim të ulët (70 min + 20 SMS)	1.09	1.59	0.73
Shporta celulare konsum i ulët voice/sms/internet (70 min + 20 SMS + 500 MB)	1.45	1.59	1.35
Shporta celular vetëm internet celular (2 GB)	2.17	2.07	0.84
Shporta celulare konsum i lartë voice/sms/internet (140min + 70 SMS + 2 GB)	1.45	2.07	2.00

Shënim: Të dhënat janë në përqindje (shpenzim/GNI për frymë) sipas të dhënave të ITU.

4 <https://www.itu.int/en/ITU-D/Statistics/Dashboards/Pages/IPB.aspx>

Treguesit e nivelit të shpenzimeve në raport me të ardhurat për frymë (GNI/pc) për katër nga pesë shportat e ITU-së për aksesin dhe përdorimin shërbimeve të rrjetit fiks dhe celular për Shqipërinë rezultojnë me rritje në vitin 2023 në krahasim me vitin 2022, dhe për tre shporta në nivel më të lartë se mesatarja botërore për vitin 2023.

Gjatë vitit 2023, është vënë re se dy operatorët celularë kanë bërë ndryshime në tarifa dhe/ose sasi të njësive (minuta, SMS apo GB) të përfshira në paketat e përdorura nga ITU të dhëna në tabelën e mësipërme. Këto ndryshime kanë rezultuar ndër të tjera në zvogëlimin e njësive/sasive (minuta, SMS apo MB) të përfshira në paketat me parapagim 30 ditore me çmim 600 Lek të prezantuar në periudhën e pandemisë Covid-19 në vitin 2021 nga operatorët celularë, dhe të përdorura nga ITU në periudhën 2021-2022 për dy shportat celulare me konsum të ulët.

Megjithatë, duhet pasur parasysh se shportat TIK të ITU përmbajnë sasite minimale të njësive të komunikimit (minuta, SMS apo GB) apo dhe shpejtësinë minimale për akses broadband fiks (256 kbps), ndërsa paketat e operatorëve që ofrohen në treg dhe përdoren nga ITU për llogaritjen e shpenzimeve mund të ndryshojnë ndër vite sipas politikave të operatorëve dhe/ose ato mund të përmbajnë më shumë njësi komunikimi /shpejtësi më të lartë sesa vlerat minimale referencë të shportave përkatëse.

Nga publikimi i të dhënave të detajuara të ITU për vitin 2023 vihet re se paketat tarifore përkatëse të operatorëve të Shqipërisë të përdorura në vlerësimin e shpenzimeve të shportave të ITU përmbajnë:

- 1400 minuta+400 SMS /+1000 MB apo 2-20 herë më shumë krahasuar me vlerat minimale të dy shportave celulare me konsum të ulët të ITU thirrje +SMS + /Data (70 min + 20 SMS / +500 MB);
- 5000 minuta + 2000 SMS / +8 GB apo 4-36 herë më shumë krahasuar me vlerat minimale të dy shportave të me konsum të lartë të ITU për thirrje +SMS + /Data: 140 min + 70 SMS / +2 GB;
- Internet me shpejtësi 60 Mbps dhe kapacitet/GB pa limit krahasuar me vlerat minimale të shportës së ITU për akses broadband fiks (256 kbps / 5 GB).

Bazuar në të dhënat e publikuara nga ITU, AKEP në figurën e mëposhtme ka paraqitur ecurinë e shpenzimeve për pesë shportat TIK të ITU në raport me GNI për frymë për Shqipërinë për periudhën 2008-2023.


Në këtë grafik është përfshirë dhe objektivi i përbalueshmërisë Komisionit Broadband të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim të Qëndrueshëm të Internetit<sup>5</sup> që në vitin 2025 shpenzimet për akses broadband të mos jenë më shumë se 2% e

5 *UN Broadband Commission for Sustainable Development* në vitin 2018 ka përcaktuar disa objektiva me qëllim universalizimin e aksesit broadband, përfshirë arritjen deri në vitin 2025 të nivelit të synuar prej jo më shumë se 2% të shpenzimeve për aksesin në shërbimin bazë broadband në raport me të ardhurat kombëtare bruto për frymë (GNI per capita).



të ardhurave bruto për frymë. Nga të dhënat rezultojnë se shpenzimet për shumicën e shportave të ITU kanë qënë poshtë nivelit 2% të të ardhurave bruto në Shqipëri prej vitit 2015 dhe vetëm më disa raste mbi këtë kufi. Gjithahshtu pavarësisht rritjes në vitin 2023, shpenzimet për të pesë shportat TIK të ITU janë brenda kufirit 2% të GNI/pc, me 2 shporta 0.4 pikë përqindje poshtë kufirit dhe 3 shporta në kufirin 2%.

Ecuria e përballeshmërisë së shpenzimeve për shportat TIK të ITU: Shqipëria 2008-23



Burimi: AKEP sipas të dhënave të publikuara nga ITU

### Zhvillimet në BE dhe ato legislative për SHU

Ligji 9918/2008 fokusohet në mundësimin e aksesit dhe përdorimin e shërbimit publik telefonik, dhe aksesin funksional në internet me shpejtësi të kënaqshme për shërbimin universal.<sup>6</sup> Pra sipas përcaktimeve të ligjit 9918/2008 si dhe nga praktikat në shumicën e vendeve të BE-së<sup>7</sup> deri vitet fundit, aksesit broadband në internet nuk është konsideruar pjesë e SHU.

Kodi i komunikimeve elektronike të BE-së (në vijim EECC) ka synuar normimin e të gjithë veprimtarisë së sektorit me qëllim shtimin e një shtylle të re në kuadër të rregullimit të tij (në connectivity objective), mundësinë e promovimit të rrjeteve të shpejtësisë së lartë, duke siguruar një shtrirje dhe akses maksimal të rrjeteve dhe infrastrukturës së shpejtësisë së lartë, ku një ndër qëllimet kryesore është dhe implementimi i gjeneratës 5G, si dhe disa ndryshime të rëndësishme në lidhje me

<sup>6</sup> Këto përcaktime janë në përputhje me Direktivën 2002/22/EC, e ndryshuar me Direktivën 2009/136/EC

<sup>7</sup> Nga të dhënat e raportit të BEREC (BoR (20) 99), të publikuar më 11.06.2020, rezultojnë se në periudhën 2010-2018 vetëm 9 nga 28 shtete anëtare të BE-së kishin përfshirë aksesin broadband në fushën e shërbimit universal. Në këto shtete shpejtësia minimale e internetit për shërbim universal varioje nga 1 deri në 4 Mbit/s, me përjashtim të MB-së dhe Suedisë që kishin vendosur për 10 Mbit/s



shërbimin universal.

EECC thekson se koncepti i shërbimit universal duhet të evoluojë për të reflektuar përparimet në teknologji, zhvillimet e tregut dhe ndryshimet në kërkesën e përdoruesve. Bazuar në ndryshimet e ndodhura në vendet e BE-së sidomos për aksesin broadband (në vitin 2015 rrjetet fiks broadband mbulonin 97% të familjeve dhe 72% e familjeve të BE-së ishin pajtimtarë akses broadband fiks, ndërsa shërbimet e bazuara në rrjetet pa tela kanë mbulim dhe përdorim akoma më ta madh), EECC ka bërë pjesë të objektit të shërbimit universal dhe shërbimin e aksesit broadband në internet nga vendndodhje fikse me shpejtësi adekuate, që përbën një ndryshim të rëndësishëm nga koncepti i aksesit funksional në internetit me shpejtësi të kënaqshme, pjesë e kuadrit të mëparshëm rregullator të BE-së dhe Ligjit 9918/2008.

Në lidhje me shpejtësinë adekuate të aksesit broadband në Internet, EECC përcakton se ajo mund të caktohet nga çdo vend anëtar sipas kushteve kombëtare dhe shpejtësisë minimale që përdoret nga shumica e konsumatorëve, duke marrë në konsideratë dhe raportet e BEREC për praktikat më të mira, me synimin që të sigurohet niveli i shpejtësisë së nevojshme për pjesëmarrje sociale dhe ekonomike në shoqëri.

BEREC më datën 7 mars 2024 publikoi për raportin (BoR (24) 40) mbi praktikat më të mira për përkufizimin e shërbimit adekuat të aksesit broadband në internet. Sipas këtij raporti situata në lidhje me përfshirjen e aksesit BB në internet ka ndryshime të konsiderueshme në krahasim me raportin e mëparshëm të vitit 2020, pasi shumica e vendeve anëtare të BE/EEA tashmë kanë transpozuar tashmë kodin e komunikimeve elektronike të BE-së (EECC) dhe kanë përcaktuar parametrat për shërbimin adekuat të aksesit broadband në internet në kuadër të shërbimit universal.

Nga të dhënat e vrojtimit të BEREC rezulton se deri në mesin e vitit 2023, 19 vende e kanë përkufizuar tashmë shërbimin adekuat të internetit për SHU, 1 vend nuk e ka përcaktuar, ndërsa 9 vende nuk e kanë përcaktuar ende (por janë në proces këshillimi publik ose kanë parashikuar ta kryejnë atë, ose nuk e kanë transpozuar ende EECC në legjislacionin e tyre vendas). Rritja e madhe (nga 9 në 18) e numrit të vendeve që kanë përfshirë tashmë aksesin BB në fushën e shërbimit universal ka ndodhur në periudhën 2021-2022 që përkon me transpozimin e EECC në këto vende.

Në lidhje me përkufizimin e shërbimit adekuat të aksesit broadband në internet si pjesë e SHU rezulton se shumica e vendeve (9 vende) kanë përcaktuar si kërkesë minimale aksesin broadband me shpejtësi shkarkimi (doënlod) 10 Mbps. Vetëm disa vende (6) kanë përcaktuar apo janë në proces për të përcaktuar shpejtësi më të lartë (deri në 30 Mbps), ndërsa disa vende (3) kanë përcaktuar shpejtësi më të ulët (6-8 Mbps) si shpejtësi adekuate për internetin si pjesë e SHU.

Në lidhje me metodologjinë e përdorur për përcaktimin e kërkesave minimale për shërbimin/ shpejtësinë adekuate të aksesit në internet si pjesë e shërbimit universal,

---

raporti i BEREC (BoR (23) 178) vë në dukje se vendet kanë marrë në konsideratë një sërë kriteresh si:

- Kushtet kombëtare, që përbën faktorin kryesor të marrë në konsideratë, të tilla si shpejtësia minimale e aksesit në internet që përdoret nga të paktën 80% e konsumatorëve, tarifat/ofertat aktuale të tregut etj.;
- Seti i shërbimeve minimale që duhet mundësojë aksesin adekuat në internet
- Përvoja në vende të tjera evropiane sipas raporteve të BEREC;
- Nevojat për të ardhmen si evoluimi i shërbimeve dhe kërkesës për BB;
- Disponibiliteti dhe përballueshmëria e SHU;
- Zgjidhjet teknologjike për të ofruar akses BB si rrjete fikse, celulare dhe satelitore sipas kushteve kombëtare dhe disponueshmërisë së rrjeteve;
- Parametrat gjeografikë (nevoja/kostot sipas rajoneve gjeografike).

Në lidhje me mekanizmat e vendosjes së detyrimeve për SHU, EECC parashikon që detyrimet për ofrimin e SHU vendosen vetëm në raste të veçanta kur tregu dështon të sigurojë ofrimin e SHU në terma komerciale. Sipas raportit të BEREC (vetëm 9 vende kanë vendosur detyrime ndaj ofruesve të shërbimeve për të garantuar shërbimin adekuat të aksesit BB në internet si pjesë e shërbimit universal, ndërsa shumica e vendeve nuk kanë vendosur detyrime ose nuk synojnë vendosjen e detyrimeve.

AKEP gjatë vitit 2023 ka vijuar bashkëpunimin me MIE në lidhje me finalizimin e draft-ligjit të ri të komunikimeve elektronike që synon transpozimin e Direktivës nr. 2018/1972/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 11/12/2018 “Për krijimin e Kodit Evropian për Komunikimet Elektronike”, përfshirë përcaktimet përkatëse të EECC për shërbimin universal dhe aksesin broadband me shpejtësi adekuate në SHU.

Në vijim të zhvillimeve të viteve të fundit të aksesit BB nga rrjetet fikse, konsolidimit të tregut celular, si dhe në kuadër të masave për implementimin e ligjit të ri, AKEP parashikon që në periudhën 2024-2025 të kryejë një vlerësim të detajuar të shërbimit universal dhe aspekteve më të rëndësishme të tij si përkufizimi i parametrave të aksesit adekuat BB në SHU dhe përballueshmërinë e çmimeve, duke marrë në konsideratë dhe zhvillimet më të fundit në vendet e BE-së për këto çështje.

## 2. Ecuria e mbikëqyrjes rregullatore në sektorin e telefonisë dhe rrjeteve të lëvizshme

### 2.1. *Përgatitja dhe nxjerrja në Këshillim Publik e dokumentit “Analizë e tregjeve me shumicë të Terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme”*

Në mbështetje të përmbushjes së rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për AKEP për vitin 2023, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare gjatë vitit 2023 i ka kushtuar vëmendje të veçantë hartimit të dokumenteve të analizës së tregjeve celulare dhe atyre fikse.

Përgatitja dhe nxjerrja për Këshillim Publik e dokumentit *“Analizë e tregjeve me shumicë të Terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme”* u përgatit nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, në përputhje me nenet 34 dhe 35 të ligjit nr. 9918/2008, *“Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”*, dhe Rregulloren *“Për Analizën e Tregut”*. Me Vendimin nr.16, datë 16.11.2023, Këshilli Drejtues i AKEP miratoi dokumentin për Këshillim Publik *“Analizë e tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme (celulare)”*.

Qëllimi i analizave të tregut është analizimi dhe vlerësimi nëse në tregun përkatës ekzistojnë probleme të konkurrencës, më tej shpalljen e operatorëve me fuqi të ndjeshme në tregjet përkatëse, marrja e masave rregullatore dhe miratimit të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare në funksion të arritjes së objektivave të AKEP për të:

- promovuar eficiencën e rrjeteve celulare;
- promovuar konkurrencën e qëndrueshme në tregun me pakicë të shërbimeve celulare;
- mundësuar përfitime më të mëdha pajtimtarëve nga shërbimet e komunikimeve elektronike (celulare).

Objektivi kryesor i rishikimit të tarifave të terminimit të thirrjeve mobile është vlerësimi i konkurrueshmërisë në tregun mobile në Republikën e Shqipërisë dhe marrja e masave të përshtatshme për rregullimin *ex-ante* me synim nxitjen e konkurrencës dhe eficiencës në këtë treg. Dokumenti i Analizës së Tregut të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare është përgatitur në zbatim të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, *«Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë»*, i ndryshuar, si edhe duke marrë në konsideratë udhëzimet dhe rekomandimet e Bashkimit Europian, me synim përmirësimin dhe nxitjen e konkurrencës efektive në tregun e komunikimeve elektronike mobile në Republikën e Shqipërisë, karakteristikat e tregut vendas, si dhe trajton zhvillimet në treg dhe pritshmëritë e AKEP-it për të ardhmen e afërt dhe të mesme si dhe masat rregulluese përkatëse

---

për FNT në tregjet përkatës të analizuar.

Hartimi i këtij dokumenti është i një rëndësie të veçantë pasi merr në konsideratë rezultatet e modelit të kostove të përfituara nga shërbimi i konsulencës përgjatë periudhës 2020 – 2021, i cili paraqet informacion të detajuar për kostot e shërbimeve të rrjeteve celulare, si edhe jep rekomandimet përkatëse për vijimin e rregullimit të shërbimeve të terminimit të thirrjeve celulare në përputhje me karakteristikat e tregut shqiptar.

Dokumenti i Analizës së Tregut të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, në përputhje me përcaktimet e nenit 35, të ligjit 9918/2008, i ndryshuar, iu nënshtrua procedurave të Këshillimit Publik për një periudhë prej 60 ditësh (16.11.2023 – 16.1.2024), periudhë gjatë së cilës kanë depozituar në AKEP komentet e tyre Autoriteti i Konkurrencës dhe sipërmarrës të tjerë të interesuar.

## **2.2. Monitorimi i efekteve të bashkimit me përthithje të operatorëve One Telecommunications sh.a., dhe Altelecom sh.a.,**

### *2.2.1. Përfundimi i proceseve teknike “switch-off” dhe “cut-over”.*

Bashkimi me përthithje i dy prej operatorëve kryesorë në tregjet e telefonisë së lëvizshme dhe të fiksit përfaqësoi një zhvillim të paprecedent me pasoja afatmesme të konsiderueshme. Impaktit në çështje të konkurrencës dhe të riorganizimit spektral i shtoheshin efektet pjesërisht të paparashikueshme të shartimit teknik në suazën e kompanisë së re dhe të zhvendosjes teknologjike në një rrjet dhe në një qark sistemesh të brendshme të unifikuara. Për pasojë, përveç detyrave që lindnin kundrejt adresimit të shtrembërimeve potenciale të konkurrencës, AKEP-i e vlerësoi si çështje strategjike monitorimin e drejtpërdrejtë të mbarëvajtjes së disa proceseve teknike jetike për përfundimin me sukses të bashkimit me përthithje.

Monitorimi, bazuar në vendimet e Këshillit Drejtues nr. 14 dhe 15, të 7 nëntorit dhe 16 dhjetorit 2022, që miratuan kalimet e të drejtave të përdorimit të frekuencave të sipërmarrësi i ri me kusht, mes të tjerash, të *“miratojë transferimin e të drejtave të përdorimit të frekuencave”*<sup>8</sup>, kishte për synim:

*së pari* t’i paraprinte çdo të papriture që mund të sillte kalimi në rrjetet dhe sistemet e njësuar dhe që mund të rezultonte në cenim të shërbimeve për publikun e, për rrjedhojë, në dëmtimin e të drejtave të pajtimtarit;

*së dyti*, të garantonte një proces teknik të sinkronizuar, objektiv dhe sa më transparent në kohë reale, për të shmangur incidente të shaktuara nga mungesa

---

<sup>8</sup> <https://akep.al/wp-content/uploads/2022/11/Vendim-Nr.-07.11.2022.pdf>  
<https://akep.al/wp-content/uploads/2022/12/VKD-nr.15-date-16.12.2022.pdf>

e përvojës, neglizhencat e mundshme dhe nga mangësitë në burime njerëzore të stafeve të angazhuara;

së treti, të mbikëqyrte dhe të ndihmonte në korigjimin, për aq sa do të ishte e nevojshme, të kapaciteteve reaguese të stafeve dhe sistemeve në raport me probleme të atypëratyshme të procesit dhe të informimit përkatës ndaj publikut.

Për t'u angazhuar në këtë dinamikë, AKEP-i mori shkas edhe nga alertimet e njëpasnjëshme, gjatë periudhës tetor-dhjetor 2022, për disfunktionime serioze në implementimin e sistemeve të reja të integruara B/OSS.

Proceset e sipërpërmendura, të njohura në gjuhën teknike si “switch-off” dhe “cut-over”, kanë të bëjnë me nxjerrjen jashtë funksioni të rrjeteve dhe sistemeve të sipërmarrësit të përthithur dhe zhvendosjen e pajtimtarëve të tij në rrjetet dhe sistemet e sipërmarrësit të ri. Në pamje të parë rutinore, këto momente teknike kërkonin, në rastin konkret, një përgatitje paraprake të thelluar dhe një verifikim të kapaciteteve të sipërmarrësit për ta ndërmarrë me standard dhe brenda garancive të duhura. Për t'u siguruar që sipërmarrësi One Albania sh.a., do të merrte masat e duhura në këtë aspekt, AKEP-i zhvilloi një raund takimesh teknike më përfaqësues të tij gjatë muajve dhjetor 2022 - shkurt 2023. Nga takimet AKEP-i u bind për nevojën e një mbikëqyrjeje të shtuar gjatë procesit, ndaj vendosi më 29 mars 2023 për ta përfshirë sipërmarrësin One Albania sh.a., në një procedurë të përgjithshme inspektimi. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe rendësi ju kushtua monitorimit të sistemit B/OSS, duke përfshirë problematikat në modulet që ky sistem mund të shfaqte si në procesin e portimit ashtu edhe me NPresponses dhe rrugëzimin e thirrjeve telefonike në numrat e portuar.

Gjatë inspektimit, i cili mbuloi të gjithë periudhën e proceseve teknike, ekipi i AKEP-it monitoroi hap pas hapi mbarëvajtjen e tyre, duke kërkuar nga sipërmarrësi:

- I. *Të merrte masa teknike të nevojshme për të shkurtuar sa më shumë kohën e kufizimit apo të ndërprerjes së shërbimeve të telefonisë së lëvizshme;*
- II. *Rifillimin e ofrimeve të shërbimeve të telefonisë së lëvizshme brenda përcaktimeve të Rregullores nr.16, datë 16.4.2010, “Për Treguesit e Cilësisë së Shërbimit”;*
- III. *Të merrte masa apo veprime konkrete mbi informimin e përdoruesve të shërbimeve të rrjeteve të komunikimit publik në lidhje me punët e planifikuara për mirëmbajtje ose përditësime, (informacion mbi fushatën e informimit publik, në media apo sms adresuar pajtimtarëve mbi procesin e ‘Cut Off’ );*
- IV. *Të kishte plane të detajuara dhe një analizë mbi zonat, pajtimtarët, të cilët*

*mund të preken nga ndërprerja e shërbimit, si dhe intervalet kohore që mund të kenë ndërprerje brenda afateve të deklaruara;*

- V. *Të kushtonte një kujdes të shtuar ndaj institucioneve të rëndësisë së veçantë, (ministritë, institucione kushtetuese, agjenci, autoritete, aeroporte, porte, dogana, etj.)*

Më 1 prill 2023, proceset e kombinuara të “switch-off” dhe “cut-over” filluan të implementohen në orën 01:30. Menjëherë u konstatuan problematika të cilat nuk mundësuan dot migrimin e pjesës më të madhe të pajtimtarëve të rrjetit Albtelecom drejt rrjetit “One Albania” sh.a., dhe shkaktuan për 4 orë ndërprerje të shërbimeve telefonike. Problematikat komplekse që u shfaqën dhe që rrezikonin ndërprerje edhe më të gjata shërbimi për pajtimtarët pas mëngjesit të datës 1 prill, e detyruan sipërmarrësin të pezullonte proceset pas rekomandimit të lënë nga AKEP-i. Rregullatori i kërkoi menjëherë sipërmarrësit të vijonte, përpara çdo riaktivizimi, të analizonte shkaqet e dështimit, të nxirrte përfundimet e duhura dhe të informonte pajtimtarët individualë, bizneset dhe institucionet e rëndësisë së veçantë, mbi ecurinë e procesit. Nga ana e tij, AKEP-i nxori një Njoftim për Shtyp pasi u njoh zyrtarisht me raportin përkatës të sipërmarrësit mbi incidentin e ndodhur. Analizimi i situatës, marrja në konsideratë e rekomandimeve të AKEP-it dhe disponimi i masave të duhura, ndikoi që procesi të riaktivizohej një javë më pas. Më 8 prill 2023 sipërmarrësi One Albania sh.a., megjithë problematikat e konstatuara, përfundoi me sukses “switch-off” dhe “cut-over” të rrjeteve dhe sistemeve të vjetra. AKEP-i monitoroi nga afër dhe në kohë reale procesin e “cut-over” duke kryer gjatë gjithë kësaj kohe kontrollin dhe monitorimin e treguesve të cilësisë së shërbimit në terren, për shërbimet GSM, UMTS dhe LTE. Me shtysën dhe nën mbikëqyrjen e AKEP-it, u ngrit nga sipërmarrësi edhe një dispozitiv asistence teknike *online* dhe nëpër pikat e shitjes, për të ndihmuar pajtimtarët në veprimet minimale manuale të nevojshme për të kompletuar kalimin në rrjetin dhe në sistemet e reja.

### *2.2.2. Kujdesi për mbrojtjen e të drejtave të pajtimtarëve*

#### *a. Masa informative*

Motivi kryesor i monitorimit të imtësishëm të proceseve “switch-off” dhe “cut-over” ishte garantimi i vijueshmërisë së shërbimeve telefoni-internet për përdoruesit fundorë dhe i transparencës mbi përballimin e sfidës teknike të bashkimit. Për këtë arsye AKEP-i i ka rekomanduar në mënyrë të përsëritur sipërmarrësit të procedojë në afate sa më të shkurtra, në mënyrë sistematike dhe me formate të qarta e lehtësisht të aksesueshme me:

- a. Njoftimin e të gjithë pajtimtarëve mbi mundësinë e mungesës së shërbimeve



- mobile në intervale kohe në rangun e disa minutave;
- b. Marrjen e masave të nevojshme për minimizimin e kohëzgjatjes së ndërprerjeve në rast incidenti teknik;
  - c. Realizimin e migrimit në sistemet e reja në orët e vona të natës;
  - d. Kompensimin e pajtimtarëve të prekur në rast të ndërprerjes së tejzgjatur të shërbimeve mobile;
  - e. Raportimin në AKEP mbi ecurinë e migrimit në sistemet e reja.

Në kuadër të lehtësimit të aksesit të informacionit dhe asistencës gjatë procesit të ndërlikuar të migrimit, në AKEP u konceptuan dhe u aktivizuan dy module komunikimi *online* në shërbim të pajtimtarëve.

Moduli i parë, e-Ankesa, ka të bëjë me mundësinë që i ofrohet pajtimtarit për të dorëzuar ankesën *online*, nëpërmjet faqes WEB të AKEP, përkatësisht në linkun <https://akep.al/e-ankesa/>.

Moduli i dytë ka të bëjë përsëri me mundësinë e komunikimit të pajtimtarëve me drejtoritë përkatëse të AKEP-it. Me anë të këtij moduli ju jepet mundësia pajtimtarëve që të adresojnë problematika të ndryshme (jo vetëm ankesa), pranë drejtorive specifike. Ky shërbim ofrohet *online* në faqen WEB të AKEP, përkatësisht në linkun <https://akep.al/kontakt/>.

#### *b. Masa korigjuese*

Megjithë përfundimin me sukses të proceseve “switch-off” dhe “cut-over”, inspektimi i nisur te sipërmarrësi One Albania sh.a., në mars 2023, i cili ishte gjithëpërfshirës në objektin e tij, rezultoi në gjetje shqetësuese sidomos për sa i përket proceseve të portabilitetit të numrit, procedurave të faturimit dhe të informimit mbi mbarëvajtjen e kontratave me pajtimtarët dhe disfunkcionimeve në rrugëzimin e thirrjeve. Inspektimi doli në konkluzion se sipërmarrësi One Albania sh.a., nuk garantonte ecurinë e rregullt të procesit të portabilitetit sipas dispozitave të Rregullores nr. 43, “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit”. Në këto kushte, sipërmarrësi One Albania sh.a., u dënua me masën administrative kryesore: “Paralajmërim” shoqëruar nga detyra plotësuese në formë rekomandimi.

Me qëllim verifikimin e rekomandimeve të lëna, AKEP kreu gjatë muajit shtator 2023 një inspektim të ri pranë të njëjtit sipërmarrës, duke përfshirë edhe shqyrtimin e shkaqeve të incidenteve teknike të ndodhura më 24 - 26 gusht 2023, të cilat shkaktuan ndërprerje të herëpashershme të shërbimeve publike të telefonisë dhe internetit te përdoruesit fundorë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë inspektimit të dytë, në



---

veprimtarinë e sipërmarrësit të komunikimeve elektronike One Albania sh.a., u konstatuan kundërvajtje administrative të karakterizuara, detyrimisht të ndëshkueshme sipas dispozitave përkatëse të legjislacionit sektorial, me masë administrative “Gjobë”.

Në përfundim të procedurës inspektuese Këshillit Drejtues i AKEP me Vendim nr. 14, datë 24.10.2023, miratoi propozimin e inspektorëve të AKEP-it që sipërmarrësi i komunikimeve elektronike One Albania sh.a., të dënohet sipas pikës 18, paragrafi III, të nenit 137, të ligjit 9918/2008, me masën administrative “Gjobë” në vlerën 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

Masa administrative e vendosur u ekzekutua nga sipërmarrësi One Albania sh.a., më 9 janar 2024.

AKEP-i vijon monitorimin periodik të zbatimit të masave korrigjuese të cilat konsistojnë në:

- respektimin e detyrimeve ligjore dhe kontraktore lidhur me kufizimet e shërbimeve dhe njoftimin e pajtimtarit përpara për zgjidhjen e kontratës;
- respektimin e detyrimeve ligjore lidhur me publikimin e informacionit transparent, të krahasueshëm, të përshtatshëm dhe të përditësuar në përfundim të kontratës;
- respektimin e detyrimeve ligjore lidhur me njoftimet e pajtimtarit dhe AKEP për kufizimin ose ndalimin e aksesit në shërbimet e tyre;
- riparimin e të gjitha problematikave teknike të evidentuara në arkitekturën e moduleve të sistemit B/00S me qëllim eliminimin e pikave të dështimit si dhe përmirësimin e sistemit.

### *2.2.3. Rezultatet e inspektimeve dhe masat korrigjuese të problematikave të vendosura nga AKEP*

Strukturat e AKEP-it (teknike dhe inspektuese) ndoqën nga afër procesin teknik të migrimit të numrave celularë nga rrjeti i sipërmarrësit Albtelecom sh.a., në rrjetin e sipërmarrësit One Albania sh.a., (më datë 1 prill 2023, ora 01:00 e mëngjesit).

Gjatë implementimit të këtij procesi delikat u konstatuan problematika, të cilat nuk mundësuan dot transferimin e pjesës më të madhe të pajtimtarëve të rrjetit Albtelecom sh.a., drejt rrjetit One Albania sh.a., si dhe ndërprerje të shërbimeve telefonike në një kohë relativisht 4 (katër) orë.

Në kushtet kur ky proces paraqiste problematika dhe ishte kompleks, struktura inspektuese e AKEP mori masën urgjente më datë 29.3.2023 kundrejt sipërmarrësit

One Albania sh.a., Vendim, i cili ju përcoll në kohë sipërmarrësit duke i lënë detyra dhe angazhime.

Me qëllim garantimin e shërbimeve të duhura dhe të përshtatshme për çdo përdorues/pajtimtar në territorin e Republikës të Shqipërisë si dhe shmangia e çdo problematike të mundshme, e cila mund të sillte kufizime në shërbimet telefonike të lëvizshme, Grupi i Inspektimit të AKEP, urdhëroi sipërmarrësin inspektues të kryente menjëherë njoftimin e publikut, pajtimtarëve individ, biznese si edhe institucionet e rëndësishme të veçantë mbi problematikat e mundshme që mund të përballëshin në momentin e transferimit të numrave.

Gjithashtu, nëpërmjet Komunikatës për Shtyp datë 2.3.2023, AKEP në faqen e tij zyrtare në web njoftoi publikun e gjerë mbi procedurat e unifikimit të rrjetit dhe përditësimit të shërbimeve të One Albania sh.a.

Në vijimësi, edhe në tentativën e dytë datë 8.4.2023, AKEP monitoroi nga afër procesin e cut-overit duke kryer gjatë gjithë kësaj kohe kontrollin dhe monitorimin e treguesve të cilësisë së shërbimit në terren, për shërbimet GSM, UMTS dhe LTE.

Gjatë implementimit të këtij procesi u mundësua transferimi me sukses i pjesës më të madhe të pajtimtarëve të rrjetit Albtelecom sh.a., drejt rrjetit One Albania sh.a.

Gjithsesi, nga analiza paraprake e situatës u konstatuan problematika në procesin e portabilitetit dhe atë të rrugëzimit të thirrjeve, të cilat e kishin zanafillën në pengesat teknike të sistemeve të aplikuara nga sipërmarrësi One Albania sh.a.

Duke vlerësuar situatën e portimit tepër shqetësuese, struktura inspektuese e AKEP-it konstatoi se sipërmarrësi One Albania sh.a., në veprimtarinë e tij nuk garanton përdorim të rregullt të procesit të portabilitetit sipas dispozitave të Rregullores nr. 43, “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit”. Në këto kushte, sipërmarrësi One Albania sh.a., u dënua me masën administrative kryesore “Paralajmërim” si dhe dënime administrative plotësuese në formë rekomandimi.

Me qëllim verifikimin e rekomandimeve të lëna, gjatë muajit shtator 2023 AKEP ka kryer një riinspektim pranë sipërmarrësit të komunikimeve elektronike One Albania sh.a.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, në veprimtarinë e sipërmarrësit të komunikimeve elektronike One Albania sh.a., janë konstatuar kundërvajtje administrative, detyrimisht të shoqërueshme sipas dispozitave përkatëse të legjislacionit sektorial, me masë administrative “Gjobë”.

Në përfundim të procedurës inspektuese Këshillit Drejtues i AKEP me Vendim nr. 14, datë 24.10.2023 miratoi propozimin e inspektorëve të AKEP që sipërmarrësi i komunikimeve elektronike One Albania sh.a., të dënohet sipas pikës 18, paragrafi III, të nenit 137 të ligjit 9918/2008 me masën administrative “Gjobë” në vlerën 10,000,000 (dhjetë milionë) lekë.

---

Kjo masë administrative tashmë është ekzekutuar në mënyrë vullnetare nga sipërmarrësi One Albania sh.a., dhe ndërkohë vijon monitorimi periodik mbi zbatimin e masave korigjuese të cilat konsistojnë në:

- respektimin e detyrimeve ligjore dhe kontraktore lidhur me kufizimet e shërbimeve dhe njoftimin e pajtimtarit përpara zgjidhjes së kontratës;
- respektimin e detyrimeve ligjore lidhur me publikimin e informacionit transparent, të krahasueshëm, të përshtatshëm dhe të përditësuar në përfundim të kontratës;
- respektimin e detyrimeve ligjore lidhur me njoftimet e pajtimtarit dhe AKEP për kufizimin ose ndalimin e aksesit në shërbimet e tyre;
- riparimin e të gjitha problemeve teknike të evidentuara në arkitekturën e moduleve të sistemit B/00S me qëllim eliminimin e pikave të dështimit si dhe përmirësimin e sistemit.

### 3. Ecuria e mbikëqyrjes rregullatore në sektorin e rrjeteve fikse

#### 3.1. *Përgatitja dhe nxjerrja në Këshillim Publik të dokumentit “Analizë e tregjeve me shumicë të Infrastrukturave të rrjeteve fikse dhe aksesit në broadband”*

Këshilli Drejtues i AKEP me Vendimin nr.1, datë 10.1.2024 miratoi dokumentin për Këshillim Publik *“Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit në Broadband fiks”*.

Dokumenti *Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit në Broadband fiks* është përgatitur në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008, *“Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, si edhe merr në konsideratë udhëzimet dhe rekomandimet e Komisionit Europian për këto tregje, me synimin përmirësimin dhe nxitjen e konkurrencës efektive në tregun *broadband* internet nga vendndodhje fikse në Republikën e Shqipërisë.

Lidhur me hartimin e dokumentit, AKEP, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor ka marrë shërbimin *“Konsulencë për vlerësimin për kryerjen e analizave të tregut Broadband”* nga bashkimi operatorëve Albanian Business Partner sh.p.k., dhe Tera Consultants.

Tregjet me shumicë të aksesit në *Broadband* fiks, janë pjesë e listës së tregjeve të miratuara në rregulloren e AKEP me nr. 9, datë 17.7.2009, *“Për Analizën e tregut”*, e ndryshuar, gjithashtu edhe pjesë e tregjeve për rregullim sipas rekomandimit të Komisionit Europian të vitit 2014, dhe për këtë arsye AKEP nuk e konsideron të nevojshme të bëjë një analizë të tre kritereve nëse këto tregje janë tregje përkatës të justifikueshëm për ndërhyrje *ex-ante*. Ndërsa tregu me shumicë të aksesit në infrastrukturë pasive ndërrurbane në nivel kombëtar nuk është pjesë e kësaj liste dhe është konsideruar e nevojshme kryerja e analizës duke u bazuar në parashikimet e testit të tre kritereve për të përcaktuar nëse ky treg është i justifikueshëm për ndërhyrje *ex-ante*.

AKEP në bashkëpunim me konsulentin ka zhvilluar një analizë të thelluar të tregut *broadband*, për të gjitha tregjet të cilat ndikojnë në zhvillimin e këtij tregu në Shqipëri, tregje të cilat janë në listën e tregjeve të rekomanduara nga BE, por edhe duke konsideruar rrethanat kombëtare në përputhje me Rregulloren nr.9 të analizës së tregjeve dhe përcaktimeve të ligjit 9918, *“Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”*, përfshirë rekomandimet e KE-së, si dhe praktikat më të mira ndërkombëtare si edhe përcaktimeve të VKM nr.434, datë 3.6.2020, *“Plani kombëtar për zhvillimin broadband 2020-2025”*.

Për vetë rëndësinë që paraqet një dokument i tillë në përputhje me përcaktimet e nenit 35, të ligjit 9918/2008, i ndryshuar, Vendimi dhe ky dokument janë publikuar në faqen e internetit të AKEP më datë 11.1.2024 dhe do t'i nënshtrohet procedurave të Këshillimit Publik për një periudhë 60 ditore.

Këshilli Drejtues i AKEP, pas marrjes së komenteve dhe qëndrimeve të palëve të interesuara, do të miratojë përgjatë 2024 dokumentin përfundimtar.

### **3.2. Problematikat e shtrirjes së rrjetit në pikat e aksesit dhe në përdorimin e përbashkët të Infrastrukturës**

AKEP ka ngritur, operon dhe menaxhon Sistemin e Përqendruar të Informacionit (SPI) - ATLAS, në të cilin sipërmarrësit e komunikimeve elektronike janë të detyruar të regjistrojnë rrjetin e tyre aktiv dhe pasiv në zbatim të legjislacionit në fuqi<sup>9</sup>. Gjatë vitit 2023 është vazhduar me punën mbi përditësimin e të dhënave në sistemin e përqendruar të informacionit të rrjeteve të komunikimeve elektronike (ATLAS) për të gjithë sipërmarrësit e komunikimeve elektronike.

Përveç domosdoshmërisë së një ndërfaqeje të re teknologjike dhe menaxhuese të këtij sistemi, përdorimi eficient i tij përballë me dy problematika madhore që ushtrojnë ndikim negativ në zhvillimin e qëndrueshëm dhe afatgjatë të infrastrukturave dhe rrjeteve *broadband* në vendin tonë: popullimin sistematik me të dhëna nga sipërmarrësit e vegjël e të shumtë të shpërndarë në katër këndet e territorit; bashkëpunimin e dobët me njësitë e pushtetit vendor.

Për sa i përket problematikës së parë, nga kontrolli i fundit në përfundim të tre mujorit të katërt të vitit 2023, AKEP-i vërejti të dhëna jopozitive në këtë drejtim. Sipas kontrolleve në sistemin ATLAS rezulton se:

- Përditësojnë rrjetin: 15 sipërmarrës të komunikimeve elektronike;
- Kanë deklaruar rrjet, por nuk kanë kryer përditësime: 144 sipërmarrës të komunikimeve elektronike;
- Nuk kanë deklaruar rrjet: 92 sipërmarrës të komunikimeve elektronike.

Në kuadër të konstatimeve të mësipërme, AKEP i ka ndërgjegjësuar sipërmarrësit për detyrimet e tyre ligjore në përputhje me rregulloren nr. 26, datë 16.8.2012, “Për përmbajtjen, formën dhe funksionimin e regjistrit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si edhe për nevojën e një ndërveprimi më profesional me sistemin ATLAS, megjithë mangësitë teknike dhe strukturore me të cilat sipërmarrësve të vegjël u duhet të përballen në përditshmëri.

Problematikë edhe më madhore të cilat ndeshen në menaxhimin e sistemit ATLAS është ajo që shkaktohet nga mosveprimet e njësisë të pushtetit vendor, pra bashkitë. Bashkitë administrojnë infrastrukturën pasive (infrastrukturë ku mund të kalojnë rrugët kabllore), ku përfshihen infrastruktura nëntokësore, puseta, shtylla, etj.

<sup>9</sup> Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 120/2016, “Për Zhvillimin e Rrjeteve të Komunikimeve Elektronike të Shpejtësisë së Lartë dhe Sigurimin e së Drejtës së Kalimit”, nenet 12 dhe 13.

Pjesa më e madhe e bashkive, ndonëse e kanë detyrim që t'i ngarkojnë të dhënat përkatëse në ATLAS, dhe ndonëse janë sensibilizuar përmes takimeve formuese të organizuara nga AKEP-i mbi rëndësinë e tyre, vijojnë të mbajnë një qëndrim indiferent. Mungesa e këtyre të dhënave thelbësore dhe mosplotësimi i tyre tërheq pas vetes pasoja të konsiderueshme: dëmtim i infrastrukturës rrugore përmes ndërhyrjeve të reja në segmente të asfaltuara, mbingarkesë të infrastrukturës ajrore përmes shumëfishimit të kablove duke neglizhuar atë nëntokësore, si edhe mbipërdorim i radiotransmetuesve në mënyrë masive.

Një tjetër ngërç që vijon të mos gjejë zgjidhje me pushtetin vendor ka të bëjë me rolin që luajnë bashkitë në dhënien e lejeve të ndërtimit për kulla transmetimi. Në mënyrë që të sigurohet mbulim me shërbim sa më të gjerë në të gjithë territorin, AKEP-i në momentin e pajisjes me autorizim të përgjithshëm të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike, iu vendos edhe kushte për sa i përket përqindjes së territorit që ata duhet të mbulojnë me shërbim, duke përcaktuar edhe detyrimet në lidhje me zonat pa mbulim ose me mbulim të ulët. Për të përmbushur detyrimet, sipërmarrësit duhet të investojnë në ndërtim kullash transmetimi çka nevojit një trajtim profesional dhe përgjigje të shpejta ndaj kërkesave për leje ndërtimi. Mirëpo në shumicën e rasteve, koha për t'u pajisur me leje ndërtimi kapërcen çfarëdolloj afati të arsyeshëm, duke arritur mesatarisht nga 2 deri në 3 vjet.

Mangësitë në ndërveprimin me sistemin ATLAS reflektojnë një ndërgjegjësim përgjithësisht të vakët të pushtetit vendor ndaj politikave strategjike të zhvillimit të konektivitetit me anë të ndërtimit të rrjeteve të shpejtësisë së lartë, të cilat janë sot në rajon, në kontinent dhe kudo në botë, shtylla të zhvillimit të qëndrueshëm. Në këto kushte, AKEP-i ka gjykuar të domosdoshme t'i drejtohet në tetor 2023 Kuvendit të Shqipërisë, për të koordinuar një proces disiplinimi përmes strukturave të tij të posaçme të njësive të pushtetit vendor në mënyrë që të krijohen kushtet për një bashkëpunim real dhe një përfshirje domethënëse të tyre në proceset e hartimit të territorit dhe të përparimit të politikave publike në sferën digjitale:

“Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) synon që, në kornizën e zbatimit të kuadrit ligjor dhe nënligjor sektorial për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë, të intensifikojë bashkëpunimin me Kuvendin e Shqipërisë si institucioni më i lartë normues dhe mbikëqyrës i veprimtarive publike që kanë për qëllim përmirësimin e shërbimeve dhe standardizimin e tyre në përditshmëri si edhe përdorimin e tyre sa më eficient dhe të kënaqshëm për konsumatorin.

Përveç raportimit të përvitshëm në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit, AKEP-i gjykon të nevojshëm të vendosë një komunikim të rregullt edhe me Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, i cili ka në përbërjen e tij Nënkomisionin për Qeverisjen Vendore, për të bashkërenduar një serë hapash drejt ndërgjegjësimit të disa aktorëve sektorialë, kryesisht të pushtetit vendor, për domosdoshmërinë e marrjes së një ansambli të koordinuar masash që kanë të bëjnë, në nivel bashkish dhe njësish administrative,

me zhvillimin infrastrukturor të rrjeteve të telekomunikacionit.

Ndërkohë që kuadri normativ në fuqi është mjaft i plotë, sikundër janë mjaft të qarta strategjitë shtetërore dhe dokumentet urdhëruese të Bashkimit Europian në këtë drejtim, jetësimi i tyre me efikasitet në terren paraqitet i ngadaltë dhe problematik. AKEP-i është përpjekur ndër vite të tejçojë pranë pushtetit vendor rëndësinë dhe detyrimet përkatëse që rrjedhin nga ky kuadër, por është përballur me një mungesë të vazhdueshme reagimi proaktiv.

Në kushtet kur zhvillimi i qëndrueshëm digjital i vendit varet në një masë të madhe nga zhvillimi sistematik i rrjeteve dhe infrastrukturave të tyre, sipas standardeve përkatëse, vonesat në zbatimin konkret të kuadrit ligjor dhe europian bëhen shkas për një prapambetje dhe amortizim të avancuar të aksesit në të mirat digjitale, çka impakton rëndë stabilitetin e tregut prej riskut të lartë të informalitetit të gjeneruar dhe zvarritjeve administrative, duke cenuar vijimësinë dhe cilësinë e shërbimeve për konsumatorët.

Në mungesë, deri më sot, të një interlokutori të përqendruar për problematikat e pushtetit vendor në nivel ekzekutiv, AKEP-i iu drejtua Komisionit të nderuar për t'i propozuar fillimin, në suazën e Nënkomisionit për Qeverisjen Vendore, e një procesi angazhues auditimi dhe ndërgjegjësimi të pushtetit vendor në lidhje me problematikat e zhvillimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike në terren dhe të bashkëpunimit serioz institucional me AKEP-in.

Referuar sa më sipër, u përcoll një parashtrim sinoptik i çështjeve që meritojnë një vëmendje të posaçme duke mirëpritur në vijim çdo nismë të Komisionit dhe Nënkomisionit përkatës për trajtimin e tyre në dialog me autoritetin rregullator dhe pushtetin vendor<sup>10</sup>.

Gjatë vitit 2024 AKEP-i do të angazhohet edhe pranë Ministrisë së re të Pushtetit Vendor për të mundësuar një qasje proaktive ndaj problemeve që u cekën më lart dhe që kërkojnë trajtim mjaft emergjent për të çuar përpara politikat publike të digjitalizimit që impaktojnë sot të gjithë fushat e veprimtarisë publike dhe private në Republikën e Shqipërisë.

### *3.3 Përditësimi teknologjik i hartëzimit të territorit, përmes sistemit ATLAS në bashkëpunim me Unionin Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve (ITU)*

Me qëllim përmbushjen e detyrave të veta për të jetësuar politikat dhe strategjitë e konektivitetit dhe digjitalizimit, AKEP në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë ka punuar gjatë vitit 2023 për përmirësimin e sistemit

<sup>10</sup> Letër nr. 2137 prot., datë 3.10.2023, "Përcillet Informacion", dërguar Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.



ATLAS nëpërmjet projektit “Zhvillimi i ATLAS të *Broadband* të Shqipërisë”, në kuadër të investimeve të BE dhe programit të investimeve në Ballkanin Perëndimor (WBIF).

ATLAS-i, ose Sistemi i Përqendruar i Informacionit, ruan të gjitha të dhënat gjeografike të komponentëve të rrjeteve të komunikimeve elektronike për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ndryshimi i teknologjive, zhvillimi i shpejtë i rrjeteve dhe standardet ndërkombëtare gjithmonë e më shumë angazhuese imponojnë një zhvillim të shpejtë dhe të përkorë të sistemit ATLAS.

Përgjatë gjithë vitit 2023, në kuadër të shqyrtimit të gjetjeve prurë nga studimi i parafizibilitetit kryer në kuadër të programit të WBIF, ka kërkuar mbështetje teknike dhe financiare për implementimin e një ATLAS-i të ri duke bashkëpunuar nga afër me ekspertë të Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU) për të vlerësuar modele të implementuara në mënyrë të suksesshme në vende të ndryshme të Europës, për të konkluduar në një version të përshtatshëm për rastin e Shqipërisë.



*Takim me përfaqësuesin e ITU Z. Elind Sulmina lidhur me bashkëpunimin për zhvillimin e ATLASIT  
(Burimi: AKEP)*

Nga bashkëpunimi me ekspertët e ITU-së është arritur në konceptimin e një versioni

---

të mundshëm të ATLAS-it të ardhshëm, i cili do të adresojë të gjitha problematikat aktuale. Pritet gjithashtu që ky version të ofrojë më shumë funksionalitete, të cilat do të japin mundësinë që ATLAS-i të kthehet në një sistem të kompletuar gjeo-datash të sakta, e të jetë i aftë të gjenerojë raporte e statistika të dobishme në kohë reale.

Synimet:

1. Menaxhim më i thjeshtë i sistemit;
2. Gjenerim i automatizuar i raporteve për statusin e përditësimeve të rrjetit;
3. Krijim i një datamodel-i të ri, i cili garanton me saktësi vlefshmërinë e të dhënave;
4. Mundësimi i ofrimit të të dhënave që nga Backbone, deri te linjat e abonentëve brenda banesave;
5. Ofrim i të dhënave për rrjetet e ofruara me qira;
6. Ofrim i të dhënave për cilësinë e shërbimit;
7. Ofrim i të dhënave për zonat e mbulimit.

Projekti i ATLAS-it të ri ka hyrë aktualisht në fazën e hartimit. Drafti përfundimtar do të jetë objekt konsultimesh gjithëpërfshirëse me grupet e interesit, njësitë e pushtetit vendor dhe sipërmarrësit e komunikimeve elektronike.



## II. SFIDAT E QENDRUESHMËRISË SË SIGURISË KIBERNETIKE

### 1. Përforcimi i sigurisë kibernetike në infrastrukturat e institucionit

#### 1.1. Implementimi i platformës për menaxhimin e sigurisë kibernetike (SIEM)

Që prej vitit 2021 AKEP-i e ka trajtuar sigurinë kibernetike si një përparësi absolute, çka është reflektuar në investimet dhe shpenzimet në rritje për mirëmbajtje të buxhetuara në tri vitet e fundit. Qëndrueshmëria e infrastrukturave dhe sistemeve të institucionit gjatë krizës kibernetike rajonale të vitit 2022 e përligji edhe më tepër vëmendjen e shtuar që i duhej kushtuar këtij komponenti strategjik të mirëfeksionimit dhe të vazhdimësisë së shërbimeve publike digjitale. Në këtë kuadër, në buxhetin e vitit 2023 u planifikua implementimi i platformës për menaxhimin e ngjarjeve (eventeve) të incidenteve të sigurisë kibernetike (*Security Information and Event Management* - SIEM). Vitin që shkoi platforma u vu në jetë me sukses, me një arkitekturë eficiente dhe një performancë të garantuar.

Për sa i përket arkitekturës dhe performancës, platforma ofron një mjedis virtual që garanton mirëmenaxhimin e log-eve dhe analizës së ngjarjeve problematike në kohë reale. Ngjarjet identifikohen, gjenerohen në formë raporti, analizohen, ruhen dhe monitorohen në kohë reale. Përmes një zinxhiri veprimesh të automatizuara konstituohet një regjistër i plotë i aktiviteteve të rrjetit me të dhëna gjithëpërfshirëse, të integrueshme dhe të personalizuara. Prurja minimale e ngjarjeve është 1500 për sekondë. Koordinimi i proceseve sigurohet nga një ndërfaqe qendrore e unifikuar e cila kryen funksione të disafishta kontrolli, menaxhimi dhe vendimmarrjeje për trajtimin e ngjarjeve problematike dhe që përfshin 4 komponentë: Menaxherin e Sigurisë, Menaxherin e Logjistikës, Mbledhësin e të Dhënave nga Pikat Fundore dhe Serverat, Raportuesin dhe Monitoruesin e Aplikacioneve.

Sistemi ka aftësinë të ofrojë performancë analitike brenda 10 sekondave, si kohë mesatare të përgjigjes për të gjeneruar një raport mujor të përbërë nga të gjitha ngjarjet që kanë ndodhur gjatë një periudhe prej 30 ditësh me deri 300,000 ngjarje për sekondë. SIEM në vetvete ka për qëllim kryesor sigurinë e pajisjeve edhe është i aftë që të kategorizojë çdo incident sigurie në bazë të rrezikshmërisë, duke krijuar edhe alarme në kohë reale, për zgjidhjen e problematikës së shfaqur.

Sistemi zotëron aftësinë për të modeluar të dhënat hyrëse të ngjarjeve në grupe logjike, siç janë domains, rrjetet, aplikacionet, rëndësia e pajisjeve të shenjestrura, etj. Ky model i të dhënave asiston në filtrimin dhe dallimet logjike mes eventeve. Për të ofruar zgjidhje në situata komplekse dhe në kohë reale të situatës, duke

---

minimizuar kohën e hetimit dhe korrigjimit të incidenteve, SIEM aktivizon modulën e Menaxhimit të Avancuar të Ngjarjeve për të automatizuar veprimet e adresimit të problematikave të sigurisë.

Gjithashtu, si një element shumë i rëndësishëm i teknologjive të mbrojtjes kibernetike, SIEM ka aftësinë të shpalosë një analizë të avancuar të forensikës, nga i njëjti GUI (Ndërfaqja Grafike e Përdoruesit) i Menaxherit të Sigurisë, pa qenë nevoja e instalimit të një agjenti ose të eksportimit të të dhënave jashtë ndërfaqes.

### **Karakteristikat kryesore të SIEM**

- Ofron performancë, inteligjencë vepruese dhe integrim zgjidhjesh me shpejtësinë dhe shkallën e nevojshme për sigurinë.
- Dashboard-e (Panele), raporte, rishikime, rregulla dhe sinjalizime të përqendruara.
- Content Packs - grupe alarmesh, raportesh, variablash, rregullash/korrelacione dhe lista vëzhgimi që trajtojnë rastet e zakonshme të sigurisë.
- Korrelacion të informacionit të dyshimtë ndaj të dhënave të ngjarjeve historike ose në kohë reale.
- Aftësia për të mbledhur të dhëna nga pajisje të sigurisë së palëve të treta, produkte të Trellix-it si edhe nga kërcënime të sofistikuara (*threat intelligent feeds*).
- Qasje e thjeshtë në ruajtjen e të dhënave të eventeve të sigurisë.

Me rëndësi është të vërehet, në arkitekturën e përgjithshme të sistemit, asemi që përbën Pika Fundore Mbrojtëse Antivirus (*Endpoint Protection Antivirus - EPA*). EPA është i shtrirë në mënyrë kapilare më anë të “agjentit të antivirusit” në të gjithë pikat fundore në institucion, përfshirë edhe postet kompjuterike të punës të çdo punonjësi të AKEP-it, me qëllim mbrojtjen e tyre nga elementë të korruptuar ose të korruptueshëm. Antivirusi bën të mundur mbrojtjen nga elementë keqdashës dhe nga lundrimi i pasigurt në internet. Gjithashtu, duke qenë se AKEP-i është në kontakt të vazhdueshëm me AKCESK, por edhe me aktorë të tjerë të sigurisë kibernetike në vend, bëhet i mundur grumbullimi i IOC-ve (*Indicator of Compromise/Indikatorë të Cenueshmerisë*) më të fundit, IP-ve dhe domain-eve që gjenerojnë trafik të pasigurt, vlerave HASH të aplikacioneve që mund të dëmtojnë infrastrukturën dhe sistemet e teknologjisë së informacionit. Bllokimi i vazhdueshëm i të gjithë këtyre elementeve mund të kryhet në Panelin e administrimit të platformës antivirus në Cloud. Agjentë të ngjashëm janë instaluar edhe në makinat/serverat virtualë për të përforcuar edhe më tej gjendjen e sigurisë kibernetike në infrastrukturën e AKEP-it. Menaxhimi i sistemit antivirus bëhet nëpërmjet Cloud-it, gjë që ofron akses të shpejtë dhe të pandërprerë për administratorin e sistemit. Duke qenë në Cloud, nuk rrezikohet në asnjë çast humbja e kontrollit të menaxhimit të Antivirusit nga ndonjë incident i dëmtimit fizik të serverave ose humbje të dhënash.



### **1.2. Ngritja e Qendrës së monitorimit për infrastrukturën kritike dhe trafikun (SIEM)**

Gjatë vitit 2023, Drejtoria Teknike në AKEP ka mundësuar ngritjen e një qendre që garanton monitorimin në kohë reale të platformës SIEM si edhe të gjithë trafikun në infrastrukturën e institucionit. Për të patur një panoramë edhe më të plotë të sigurisë në infrastruktura, Drejtoria Teknike është në monitorim të trafikut, si në rrjetin e brendshëm, ashtu edhe në atë të jashtëm, për të verifikuar nëse ka anomali komunikimit mes pajisjeve apo serverave të caktuar, anomali të cilat janë indikatorë incidentesh të mundshëm të sigurisë kibernetike.

Me anë të platformave Open Source, Drejtoria Teknike kryen kontrollin e rrjetit të brendshëm dhe në monitorimin e firewall-ve, por edhe të rekordeve që gjeneron Cloudflare, për trafikun drejtuar domain-it akep.al. Monitorimi i trafikut nga jashtë është i domosdoshëm për shmangien e sulmeve të ashtuquajtura DDoS (Distributed Denial of Service), të cilat janë shumë të përhapura kohët e fundit, me qëllim izolimin e menjëhershëm të shërbimeve, për të mos shkaktuar dëme të mëtejshme në infrastruktura.

### **1.3 Përmirësimi i Infrastrukturës fizike të Sistemit të Administrimit të Domain-it (DNS)**

DNS (Domain Name Server), njohur ndryshe edhe si ccTLD, ruan të gjitha të dhënat e faqeve për të gjithë komponentët e rrjeteve të komunikimeve elektronike në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sofistikimi i teknologjive dhe i standardeve ndërkombëtare kanë rritur kërkesat në lidhje me adaptimin dhe modernizimin e kësaj infrastrukture kritike. Gjatë vitit 2023 ka nisur edhe përmirësimi i DNS-së, si në aspektet hardware ashtu edhe në ato software, duke pasur parasysh që kjo infrastruktura është nga më të rëndësishmet për garantimin e një hapësire digjitale funksionale në Republikën e Shqipërisë.

Strategjia e zhvillimit të DNS-së synon krijimin e një mjedisi të ri infrastrukturor për DR Site (Disaster Recovery Site) duke optimizuar performancën. Çelësi qëndron në ngritjen e një mjedisi strehues/hostues dhe shfrytëzues “Infrastructure-as-a-Service”, të bazuar në zgjidhje konvergjente dhe virtualizim Software Defined, duke respektuar pikat e dështimit dhe mundësinë e mbrojtjes së të dhënave në formë Objektesh VM (Virtual Machine/Makinë Virtuale).

Zgjidhja teknologjike për përmirësimin e infrastrukturës fizike të ccTLD.al, në aspektin fizik është zbatuar me implementimin e serverave të gjeneratës së fundit dhe me storage me hapësirë të madhe dhe shpejtësi të lartë shkrimi dhe leximi të dhënash. Kjo e ka bërë sistemin të ketë një performancë shumë të lartë funksionimi dhe të ketë një probabilitet shumë të ulët për humbje shërbimi.

## 2. Menaxhimi i sulmeve kibernetike mbi rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike.

### 2.1 *Bashkëpunimi teknik me AKCESK-un gjatë vitit 2023*

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, AKEP-i ka një rol specifik në garantimin e sigurisë kibernetike në shkallë vendi, për arsye të mbikëqyrjes sistematike që ushtron mbi implementimin dhe respektimin e standardeve të sigurisë nga sipërmarrësit e shërbimeve të komunikimeve elektronike. Në këtë kuadër, edhe gjatë vitit 2023, bashkëpunimi ndërmjet AKEP dhe Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK) ka vijuar si në aspektin parandalues, ashtu edhe në aspektin e mitigimit të incidenteve kibernetike. Ky bashkëpunim në shumë raste është shtrirë edhe te sipërmarrësit e komunikimeve elektronike dhe postare. Komunikimi ndërmjet dy autoriteteve ka qenë i përditshëm, bazuar në shkëmbime informacioni, por edhe në asistencë të ndërsjellë teknike. Në shumë raste, në frymën e bashkëpunimit institucional, dhënia e asistencës nga AKEP-i është shtrirë edhe jashtë fushës së përgjegjësisë së institucionit, duke iu përgjigjur pozitivisht kërkesave për asistencë nga institucione ose shërbime jetike për qytetarët. Këtu mund të përmenden institucione si Bashkia Tiranë, Autoriteti Portual Durrës, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Kuvendi, Garda e Republikës së Shqipërisë, Posta Shqiptare etj.

AKEP e ka mbështetur AKCESK-un në lidhje me bllokimin nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike të Domain-eve dhe IP-ve me përmbajtje të dëmshme dhe gjithashtu me bllokimin e IOC. Komunikimi ka konsistuar edhe në sinjalizimin e koordinuar të përditësimeve të nevojshme të masave të sigurisë dhe në rast kërcënimesh të mundshme kibernetike. Kur kërcënime të tilla janë identifikuar, AKEP-i ka vënë në dispozicion specialistët e Drejtorisë Teknike për të dhënë asistencë të menjëhershme. Duhet nënvizuar se në shumicën e rasteve, AKEP-i ka qenë vendimtar në mitigimin e sulmeve kibernetike si në infrastruktura publike, ashtu edhe në infrastruktura private që garantojnë shërbime publike për qytetarët. Vlen të përmendet se AKCESK-u ka qenë në mbështetje të AKEP-it gjatë sulmit të ndodhur në infrastrukturën e sipërmarrësit One Albania sh.a., në dhjetor të vitit 2023. Mbështetja ka konsistuar si në burime njerëzore, ashtu edhe në instrumente për të bërë të mundur investigimin e rastit dhe vlerësimin fillestar të gjendjes. Gjatë vitit 2023, sulmet që janë mitiguar nga bashkëpunimi AKEP – AKCESK kanë qenë kryesisht të llojit DDoS, Phishing, Exfiltration & Wipe etj. Gjithashtu, në kuadër të këtij bashkëpunimi, AKEP i ka ardhur në ndihmë edhe sektorit bankar dhe atij të energjisë.

## 2.2 Mitigimi i sulmeve kibernetike mbi rrjetet e operatorëve të komunikimeve elektronike

Më datë 25.12.2023, ora 01.30, ekipi i Qendrës Operacionale të Rrjetit (NOC) të sipërmarrësit One Albania sh.a., konstatoi pamundësinë e komunikimit me disa servera të kompanisë. Për rrjedhojë u njoftuan ekipet përkatëse të IT Group të One Albania sh.a., për marrjen e masave të menjëhershme dhe fillimin e hetimit të brendshëm në lidhje me problematikën. Gjatë reagimit të parë, nga qendra e të dhënave virtuale (VM), u vërejt një disfunkcionim i dyshimtë i serverave pasivë si dhe një aktivitet nga përdorues të tretë të paidentifikuar që fshinin të dhënat e stokuara. Megjithë përpjekjet e ekipit të One Albania sh.a., i cili funksiononte me efektiv të reduktuar, aktiviteti nuk mundi të mitigohej deri në orët e para të mëngjesit.

Në orën 07:20, One Albania sh.a., njoftoi AKEP-in dhe i kërkoi asistencë teknike në lidhje me situatën. Me urdhër të Kryetarit, AKEP-i u angazhua menjëherë dhe dërgoi një ekip të Drejtorisë Teknike në mjediset e kompanisë për të dhënë suportin e nevojshëm dhe për të mbikëqyrur situatën. Në kuadër të bashkëpunimit institucional, AKEP-i vuri shumë shpejt në dijeni Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK) i cili u tregua menjëherë i gatshëm në dhënien e një asistence teknike shtesë. AKEP-i dhe AKCESK-u koordinuan gjatë gjithë ditës punën për t'i siguruar kompanisë nën sulm një asistencë eficiente falë bashkëpunimit ndërkombëtar me partnerë të besueshëm, të cilët kryen analiza rrënjësore të shkaqeve të suksesit të sulmit dhe mundësuan rikuperimin e të dhënave të humbura nga serverat përmes kopjeve rezervë ose rindërtimit tërësor, si edhe rikuperimin e sistemeve të ruajtjes.

Nga vlerësimi teknik gjithëpërfshirës i situatës u konstatua se ishte fshirë një pjesë e informacionit të stokuar në disa servera dhe ishte kompromentuar aksesimi në një sërë sisteme të brendshme IT. Aksesimi i kompromentuar në sisteme ndikoi negativisht në aksesueshmërinë dhe funksionimin normal të disa pikave të kontaktit të klientëve si dyqanet, aplikacioni MyONE dhe pikat e tjera të shërbimeve *online*.

Me udhëzim të AKEP-it, ekipet teknike të ngarkuara për kthimin në normalitet të situatës, u fokusuan në sigurimin dhe garantimin e shërbimeve esenciale të furnizimit me telefoni dhe internet. Një degradim i lehtë dhe shumë i kufizuar në kohë i shërbimeve zanore ndodhi për arsye të ridrejtimin në rrjet të këtyre shërbimeve si dhe të trafikut të shtuar të një dite festive. Falë angazhimit të AKEP-it dhe të ekipeve të One Albania sh.a., është shmangur tërësisht çdo ndërprerje, qoftë edhe pjesore, e këtyre shërbimeve. Kanë vijuar të jenë të disponueshme për të gjithë pajtimtarët shërbimet bazë në rrjetin e lëvizshëm dhe atë fiks (të dhëna, zë dhe sms), përfshirë edhe shërbimet audiovizuale.



---

Incidenti u klasifikua si sulm kibernetik dashakeq. Përgjegjësia u mor nga grupi “Homeland Justice”, përmes deklaratave publike në rrjetet sociale.

Që prej datës 25 dhjetor 2023, nën mbikëqyrjen e AKEP-it, One Albania sh.a., bëri të mundur ringritjen e sistemeve dhe rikuperimin e shumicës së të dhënave duke i vendosur sërish në funksion të plotë.

### **2.3 Rekomandime për përforcimin e qëndrueshmërisë së infrastrukturave kritike**

- Krijimi i një Fondi Shtetëror për investime dhe mirëmbajtje të tërësisë së infrastrukturave kritike në shkallë vendi;
- Rritja e kapaciteteve në burime njerëzore të specializuara dhe trajnimi i punonjësve në bashkëpunim me mjedisin universitar dhe akademik në vend, rajon dhe më gjerë;
- Inkurajimi i një kulture komunikimi dhe shkëmbimi sistematik të informacionit në nivel teknik dhe vendimmarrës mes institucioneve që administrojnë infrastruktura kritike;
- Përditësim i vazhdueshëm i politikave të menaxhimit të sigurisë, të planeve të vijimësisë së biznesit dhe të politikave të menaxhimit të akseseve të privileguara;
- Izolimi dhe ruajtja nga efektet e dëmshme të pajisjeve të caktuara, si për shembull EOL/EOSL në të gjitha entitetet ku gjenden të instaluar dhe në pamundësi për t’u zëvendësuar;
- Implementim kudo ku është e mundur të sistemeve antivirus të gjeneratës së re, ndërtimi i platformave të monitorimit të trafikut, ngritje qelizash SOK-u lokalë;
- Implementim kudo ku është e mundur të platformave të menaxhimit të incidenteve të sigurisë kibernetike (SIEM) dhe të sistemeve SOAR (Security Orchestration, Automation and Response) që sigurojnë një përmirësim eficient të operacioneve të sigurisë fizike dhe digjitale të infrastrukturave kritike;
- Ndërtim i Cold (offline) Backup/DRS që siguron stokimin e pacenueshëm dhe rikthimin e të dhënave të kompromentuar nga sulme kibernetike *online*;
- Ndërmarrje sistematike testesh mbi mbrojtjen efektive ndaj depërtimeve të sulmeve dashakeqe në infrastrukturat kritike (Pentest).

## III. PANORAMË E ZHVILLIMEVE NË TREGUN POSTAR

### 1. Vështrim i përgjithshëm mbi aspekte rregullatore në sektor

Sektori postar luan një rol të rëndësishëm për ekonominë, nga njëra anë duke kryer shërbime e siguruar furnizimin e mallrave për qytetarët dhe bizneset, dhe nga ana tjetër duke punësuar njerëz e duke ndikuar kështu sado pak në uljen e papunësisë.

Në vitet e fundit vihet re një transformim i tregut postar për sa i përket evolucionit të produkteve të ofruara dhe metodave të funksionimit të ofrimit të shërbimit.

Digjitalizimi i sektorit ka, në fakt, një efekt të dyfishtë:

Nga njëra anë vëllimet e korrespondencës (letrave) sa vijjnë e zvogëlohen për shkak të zëvendësimit të komunikimeve me metoda elektronike (si p.sh., e-billing, e-mail apo rrjetet e ndryshme sociale) - dhe ky është një trend global;

Nga ana tjetër, falë rritjes së tregtisë elektronike (*online*), shfaqja e platformave digjitale që ofrojnë shërbime të dërgesës, apo që shesin produkte komerciale në lidhje me shërbimet e dërgesës, rritën dërgesat e pakove/kolive.

Ky është një trend në rritje, e për pasojë është e imagjinueshme që procesi i tkurrjes së vëllimeve të produktit të korrespondencës (letër) do të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme.

#### 1.1 Rishikim i kuadrit ligjor

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), në sektorin postar funksionon bazuar në ligjin 46/2015 “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”, si dhe akteve të tjera të nxjerra në zbatim të këtij ligji.

Vitet e fundit, shërbimi postar është zhvilluar shumë në drejtim të blerjeve *online*, (e-commerce) duke sjellë paralelisht ulje të shërbimeve standarde të postës, siç janë dërgesat e letrave, telegrameve etj., e duke bërë që si tregtarët dhe blerësit, ashtu edhe ofruesit e shërbimeve postare të përshtaten me modele të reja të biznesit dhe të lindi nevoja për një qasje të re rregullatore. Për këtë arsye, ky ligj kërkon disa ndryshime, ku të përfshihen parashikimet e mënyrës së funksionimit të të gjitha hallkave të e-commerce.

Edhe Grupi i Rregullatorëve Europianë për Shërbimet Postare (The European

---

Regulators Group for Postal Services- ERGP), në dokumentin argumentues mbi raportin e Komisionit Europian për aplikimin e Direktivave të Shërbimeve Postare e prillit të kaluar, nënvizoi nevojën për të përshtatur kuadrin rregullator aktual, që daton mbi 25 vjet më parë.

Fakti që vitet e fundit ka një orientim të shtuar kryesisht tek blerjet online, nga faqet zyrtare web, apo edhe nga faqet reklamuese në rrjetet sociale të tregtarëve të ndryshëm, dhe ngërçet apo vakumet e ligjeve aktuale, vihet re fenomeni që punonjësit përgjegjës për dorëzimin e objekteve postare të funksionojnë jo vetëm si korrierë, por edhe si agjentë monetarë.

Për këtë arsye, ky ligj kërkon ndërhyrje, ku të përfshihen parashikimet e mënyrës së funksionimit të të gjitha hallkave të e-commerce.

Njëkohësisht, ajo që është vënë re gjatë inspektimeve, është fakti se subjektet lidhin marrëveshje bashkëpunimi/partneriteti me njëri-tjetrin për ofrimin e shërbimeve postare, kryesisht ndërkufitare, por jo vetëm, duke u bazuar kryesisht në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë. Edhe në lidhje me këtë pikë mendojmë se kërkon ndryshim në ligjin aktual dhe kërkon pasqyrim më qartë në ligjin 46/2015 që ka të bëjë me “ruajtjen e konfidencialitetit”.

Rekomandime të posaçme mund të sugjerohen edhe në terminologjinë e përdorur nga legjislacioni aktual. Konkretisht, kur përdorim fjalën “Transport” duhet të jemi të kujdesshëm pasi si term shkakton konfuzitet:

*Shërbimet Postare nuk ofrojnë dhe nuk duhet të ofrojnë Shërbime Transporti – Ky shërbim i përket një fushe tjetër, i cili funksionon mbi bazën e një ligji dhe rregullore krejt të ndryshme nga Shërbimet “Postare & Korrieri”.*

Në legjislacion vlerësojmë se duhet të vendoset edhe një lloj kriteri (garancie monetare) për t’u pajisur me autorizimin e përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare, apo edhe një kufizim në ofrimin e shërbimit, jo në numër, por me territor. Pas kalimit të një periudhe të caktuar kohe, kjo në varësi të plotësisht të disa kriterëve, të mundësohej më pas leja e ofrimit të shërbimit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

## **1.2. Treguesit statistikorë të tregut postar**

### **Tregu i shërbimeve postare**

Sektori i shërbimeve postare rregullohet mbi bazën e Ligji 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, si dhe aktet nënligjore dhe rregullatore në zbatim të tij, si edhe merr në konsideratë aktet rregullatore të UPU dhe udhëzimet dhe objektivat e përcaktuara në dokumentet e politikave postare të hartuara dhe

miratuara nga Qeveria.

Edhe përgjatë vitit 2023, ecuria e tregut të ofrimit të shërbimeve postare në Shqipëri, ka shfaqur shenja të ngjashme me ecurinë e tregjeve rajonale dhe ato të vendeve të BE. Përgjatë kësaj periudhe AKEP i ka kushtuar vëmendje të veçantë përmirësimit të legjislacionit vendas dhe përafrimin me praktikat më të mira ndërkombëtare. Konkretisht, në zbatim të akteve të miratuara për shërbimet e dërgesave të pakove ndërkufitare dhe transparencën e tarifave, AKEP, në Janar të vitit 2023, ka miratuar ndryshimet e formularëve të të dhënave statistikore të cilat mundësojnë mbledhjen e informacionit edhe për shërbimin e pakove postare ndërkufitare.

Me anë të këtyre ndryshimeve, AKEP ka mundësuar përafrimin e legjislacionit me rregulloren e Komisionit Europian (Regulation (EU) 2018/644) lidhur me shërbimet e shpërndarjes së pakove postare ndërkufitare, rregullore e cila synon mbështetjen për nxitjen e shërbimeve të tregtisë elektronike nëpërmjet rritjes së transparencës mbi aplikimin e tarifave të pakove postare ndërkufitare, si edhe vlerësimin e tyre në funksion të nxitjes së konkurrencës dhe eficiencës në tregjet postare.

AKEP është rregullatori i vetëm në rajon që ka kryer përmbledhjen dhe publikimin e tarifave për ofrimin e shërbimeve të pakove postare ndërkufitare<sup>11</sup>, si edhe ka përgatitur raportin për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës mbi vlerësimin nëse këto tarifa janë në nivele të ngjashme me tarifatat e aplikuara nga ofruesit e shërbimeve të ngjashme nga operatorët postarë të vendeve të rajonit.

Tregu i ofrimit të shërbimeve postare përgjatë vitit 2023 ka shënuar ndryshime të rëndësishme në aspektin e numrit të ofruesve të këtyre shërbimeve. Konkretisht, numri i operatorëve në fund të këtij viti numërohen 24 subjekte të pajisur me “Autorizim të Përgjithshëm”, nga këto Posta Shqiptare sh.a., është ofruesi i vetëm i ofrimit të Shërbimit Universal Postar, nga 36 ofrues të shërbimeve postare që ishin në fund të vitit 2022.

Numri total i objekteve postare të pranuar gjatë vitit 2023 nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare ishte rreth 23 milionë, një rënie me 15% krahasuar me vitin 2021. Rënia më e ndjeshme ka qenë në objektet postare pjesë e zërit “*Shërbim Universal Postar*” nga Posta Shqiptare si ofrues i vetëm i Shërbimit Universal Postar, ku faktori kryesor që ka ndikuar në këtë rënie është ulja e numrit të faturave të shpërndara për llogari të OSHEE.

Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare përgjatë vitit 2023 kanë raportuar ofrimin e shërbimeve postare (shërbim ekspres dhe shërbim jouniversal postar) në masën 3.3 milionë objekte postare, duke shënuar rritje me rreth 6% krahasuar me vitin 2022 ku kjo shifër paraqitej rreth 3.1 milionë objekte. Pavarësisht rritjes së volumit të objekteve në total për këtë grup operatorësh në zërin e ofrimit të shërbimit postar

11 <https://akep.al/wp-content/uploads/2023/02/TARIFAT-E-SHERBIMEVE-POSTARE-PER-PUBLIKIM-Shkurt-2023.pdf>

---

jouniversal, vërehet rënie me rreth 58% krahasuar me vitin 2022, rënie e cila ka qenë e vazhdueshme nga vitet e kaluara.

### **1.3. Statusi i Shërbimit Universal**

Sektori postar përbën një sektor të rëndësishëm të ekonomisë duke luajtur një rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve të komunikimit postar për qytetarët dhe bizneset, dhe veçanërisht në ofrimin e shërbimit bazë apo universal postar.

Ligji nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” i kushton një rëndësi të veçantë sigurimit të Shërbimit Universal Postar në gjithë territorin e RSH, në përputhje me kërkesat specifike të përcaktuara në ligj dhe aktet nënligjore.

AKEP-i, si organ rregullator në fushën e shërbimeve postare, ndër të tjera, ka detyrimin për të përcaktuar ofruesin e Shërbimit Universal Postar në përputhje me ligjin nr. 46/2015, si dhe aktet nënligjore edhe rregullat për ofrimin e shërbimit postar dhe shërbimit universal postar. Bazuar në këto përcaktime, AKEP me Vendimin e Këshillit Drejtues nr.13, datë 30.6.2020, ka miratuar dhënien e autorizimit individual shoqërisë Posta Shqiptare sh.a., për ofrimin e Shërbimit Universal Postar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, për një periudhë 5-vjeçare, duke filluar nga data 7 korrik 2020.

Ligji nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, i kushton një rëndësi të veçantë sigurimit të Shërbimit Universal Postar në gjithë territorin e RSH në përputhje me kërkesat specifike të përcaktuara në ligj dhe aktet nënligjore si dhe rregullat për ofrimin e shërbimit postar dhe shërbimit universal postar. Sipas përcaktimeve të këtyre akteve ligjore dhe nënligjore, Posta Shqiptare sh.a., si ofruesi i shërbimit universal postar ka një sërë detyrimesh për të garantuar disponueshmërinë e shërbimit universal postar në të gjithë territorin e RSH dhe me çmime të përballueshme.

Për të garantuar mbulimin e territorit dhe popullsisë me shërbim universal sipas kërkesave të përcaktuara në Urdhrin e Ministrit të Energjisë dhe Infrastrukturës, me nr.6174, datë 16.12.2019, Posta Shqiptare sh.a., gjatë vitit 2023 ka raportuar treguesit e mëposhtëm lidhur me numrin e pikave të aksesit të shërbimit postar:


- 535 zyra postare të përhershme të hapura për publikun;
- 704 sportele, nga të cilët 525 të automatizuar/kompjuterizuar;
- 579 kuti postare për pranimin e objekteve postare;
- 667 kuti postare për dorëzimin e objekteve postare.

Për sa i përket infrastrukturës së automjeteve të transportit Posta Shqiptare ka raportuar se në vitin 2023 ka pasur në përdorim 153 mjete transporti (furgona, vetura, motoçikleta dhe biçikleta) që përbën një reduktim të ndjeshëm nga 244

mjete të raportuar për vitin 2022.

Numri total i objekteve postare të shërbimit universal në vitin 2023 ishte 18.4 milionë, që përbën një reduktim të ndjeshëm me 16% në krahasim me vitin 2022. Objektet postare pjesë e SHU në vitin 2023 përbënin 95% të totalit të objekteve postare të Posta Shqiptare dhe 80% të totalit të gjithë objekteve postare në Shqipëri.

Rënia e ndjeshme e numrit të objekteve postare të SHU ka ardhur kryesisht për shkak të rënies me 17% të numrit të objekteve postare brenda vendit, të cilat përbëjnë 96% të totalit të SHU. Objektet postare ndërkombëtare rezultuan me rritje me 2% në vitin 2023, ku objektet postare ndërkombëtare hyrëse u rritën me 4%, ndërsa numri i objekteve postare ndërkombëtare dalëse u reduktua me 6%.




Për sa i përket standardeve të cilësisë në lidhje me kohën e shpërndarjes së objekteve postare të SHU, tabela e mësipërme paraqet të dhënat për afatet kohore të shpërndarjes së objekteve postare brenda vendit sipas objektivave të përcaktuar në Rregulloren nr.35/2015 të AKEP për SHU dhe realizimi i tyre nga Posta Shqiptare për vitin 2023.

Në vitin 2023 treguesit e kohës së shpërndarjes së objekteve postare brenda vendit janë realizuar nga Posta Shqiptare brenda afateve të përcaktuara nga Rregullorja e AKEP për SHU, ku 97% e objekteve postare në zonat urbane janë shpërndarë në D+1 (1 ditë pas pranimit) krahasuar me objektivat 95% dhe 85% për dorëzimin brenda dhe midis qyteteve respektivisht. Për objektet postare me destinacion zonat rurale, 85% e objekteve postare janë dorëzuar në D+2, krahasuar me detyrimin 60%.

## Të ardhurat dhe investimet e tregut postar

Bazuar në raportimet e kryera nga ofruesit e shërbimeve postare që kanë ushtruar aktivitet përgjatë vitit 2023, rezulton se këta sipërmarrës kanë gjeneruara rreth 2.3 miliardë lekë, cka përbën një rënie me rreth 10% krahasuar me periudhën pararendëse.



Rënie ka shënuar Posta Shqiptare, i cili është sipërmarrësi me pjesën më të madhe të të ardhurave në fushën e ofrimit të shërbimeve postare. Gjithashtu, ndikim në rënie të të ardhurave të raportuara ka pasur edhe ulja e numrit të ofruesve të shërbimeve postare, numër i cili është reduktuar në 24 nga 36 që ishte në vitin 2022.

Përgjatë vitit 2023, sipërmarrësit e ofrimeve postare kanë investuar rreth 280 milionë lekë në përmirësimin e infrastrukturës së ofrimit të shërbimeve postare, kjo vlerë investimesh është dukshëm më e ulët rreth 30% krahasuar me vitin 2022. Më shumë se gjysma e investimeve të raportuara janë kryer nga sipërmarrësi United Transport me rreth 56% të totalit.




## 2. Ecuria e mbikëqyrjes rregullatore në sektorin postar

Sektori postar ka pësuar ndryshime të herëpashershme, duke u përpjekur të përshtatet edhe me kërkesat e tregut. Sidomos pas periudhës së pandemisë u vu re një shtim i subjekteve të cilët u pajisën me autorizimin e përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare. Nga viti 2020 në 2022 vihet re një rritje me 50% të numrit të subjekteve ofrues të shërbimeve postare, duke e çuar numrin e tyre nga 18 në vitin 2020, në 36 në vitin 2022.

Nga 36 ofrues të shërbimeve postare numër i cili arriti kulmin në vitin 2022, në fund të vitit 2023 operojnë në treg 24 subjekte të tillë, çka tregon formalizimin e këtij sektori.


Luhatje ka pasur edhe në numrin e subjekteve që kanë dalë nga tregu i ofruesve të shërbimeve postare, duke kërkuar vetë çregjistrim, ose në përfundim të inspektimeve ka rezultuar që nuk kanë përmbushur kushtet për ofrimin e shërbimeve postare sipas ligjit dhe rregulloreve në fuqi. Arsyeja kryesore e këtyre rasteve ka qenë fakti se nuk kanë mundur të futen në treg në mënyrën e duhur, duke mos arritur dot të sigurojnë klientë të mjaftueshëm, e për pasojë të kenë hasur në probleme financiare. Një fenomen që u vu re kryesisht përgjatë 2 viteve të fundit ishte fakti se disa subjekte postare u bashkuan, duke krijuar një subjekt të vetëm.

Kjo pasqyrohet edhe në grafikun më poshtë, ku vihet re një numër i konsiderueshëm në rritje i subjekteve të çregjistruara.



*\*Paraqitja grafike e numrit të subjekteve ofrues të shërbimeve postare të çaktivizuar përgjatë 5 viteve të fundit*

Ndërkohë, sa i takon volumit të dërgesave postare përgjatë vitit 2023, duke përjashtuar nga studimi “Postën Shqiptare”, si ofrues i Shërbimit Universal Postar dhe si dominant në treg sa i takon volumit të dërgesave dhe shpërndarjeve postare, vihet re se subjekti “Albanian Delivery Express” sh.p.k., është ofrues në pjesën të madhe të tregut, duke u ndjekur nga “United Transport” sh.p.k. (Unitrans).



*\*Paraqitja grafike e volumit të dërgesave postare nga ofruesit e shërbimeve postare jouniversale për vitin 2023*

## 2.1 Realizimi i planit të inspektimeve për vitin 2023

Bazuar në Rregulloren nr. 45, datë 27.10.2016, “Metodikë e Inspektimit të Veprimtarisë së Ofruesve të Shërbimeve Postare”, objektivi i AKEP-it është që çdo ofrues i shërbimit postar i regjistruar në databazë të inspektohet minimalisht jo më pak se 1 herë në vit.

Në planin vjetor të inspektimeve të subjekteve ofrues të shërbimeve postare për vitin 2023 ishin planifikuar të kryheshin 34 (tridhjetë e katër) inspektime të programuara tek ofruesit e shërbimeve postare, të cilat janë realizuar 100% nga inspektorët e AKEP.

Tematika e këtyre inspektimeve të programuara ka qenë e fokusuar për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr.46/2015, datë 7.5.2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të akteve të tjera në zbatim të tij, të kushteve dhe termave të përcaktuara në Autorizimin e Përgjithshëm dhe Autorizimin Individual për ofrimin e shërbimeve postare.

Në përfundim të procedurave inspektuese vihet re zvogëlim i numrit të subjekteve që ofronin shërbime postare.

Nga 34 ofrues, aktualisht në treg operojnë 25 të tillë,

- 11 (njëmbëdhjetë) ofrues të shërbimeve postare, ose 32 %, janë çregjistruar nga Regjistri i Autorizimit të Përgjithshëm gjatë vitit 2023.

Problematikat e hasura gjatë inspektimit lidhen me zbatimin pjesërisht të kushteve të Autorizimit të Përgjithshëm.

Konkretisht, për 8 (tetë) ofrues të shërbimeve postare që kanë zbatuar pjesërisht kushtet e Autorizimit të Përgjithshëm, janë vendosur dënime plotësuese në formën e rekomandimeve me afate kohore respektive për plotësimin e tyre sipas ligjit nr. 46/2015, *“Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”*.

Si çdo vit, bazuar në Rregulloren nr. 45, datë 27.10.2016, *“Metodikë e Inspektimit të Veprimtarisë së Ofruesve të Shërbimeve Postare”*, u krye edhe inspektimi i ofruesit të Shërbimit Universal Postar, *“Posta Shqiptare”* sh.a., ku kryesisht u fokusua mbi zbatimin e kushteve të autorizimit individual, si dhe zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm.

Në përfundimin e procedurave inspektuese është vlerësuar vullneti dhe hapat konkretë të ndërmarra nga ofruesi i Shërbimit Universal Postar *“Posta Shqiptare”* sh.a., në plotësimin e rekomandimeve të lëna nga inspektimet e mëparshme dhe rezoluta e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Gjithsesi, është konstatuar se për plotësimin e kërkesave të nenit 31, të ligjit nr.46/2015, *“Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”*, dhe rregullores nr.41, datë 3.3.2016, *“Për ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostove të Shërbimit Universal Postar”*, nga ky subjekt kërkohet angazhim i mëtijshëm, rritje e investimeve në fushën teknologjike deri në përmbushjen plotësisht të këtij rekomandimi.

Lidhur me masat për ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostove të Shërbimit Universal Postar, *“Posta Shqiptare”* sh.a., procesi është në vijimësi, me qëllim përmbushjen plotësisht në një periudhë kohe sa më të shpejt., është<sup>12</sup> raportuar pranë AKEP në lidhje me hapat e ndjekur nga Posta Shqiptare sh.a., sa i takon ecurisë së procesit. Sipas këtij raportimi, por edhe sqarimeve të bëra gjatë procedurës inspektuese, në programin ETERNA:

- ✓ Është arritur të identifikohen dhe të regjistrohen të gjithë zërat e shërbimit universal postar;
- ✓ Nëpërmjet raporteve mujore të gjeneruara nga ky program, është arritur regjistrimi në një llogari specifike në kontabilitetet e ardhura nga shërbimi universal postar;
- ✓ Po punohet mbi mundësinë e implementimit të sistemit të kostos sipas metodologjisë së përcaktuar në rregulloren nr. 41, datë 3.3.2016;
- ✓ Është realizuar përlllogaritja e pagave të punonjësve në Drejtorinë e Përgjithshme dhe shumicës së filialeve rajonale, aktualisht po punohet dhe për realizimin e saj për punonjësit e filialeve Tiranë e Shkodër;

12 Shkresa nr.697 prot., datë 4.4.2024 e Postes Shqiptare me lende *“Dergohet informacion”*

- ✓ Është kërkuar nga firma zhvilluese që të identifikojë të ardhurat për të gjitha zërat e shërbimit universal postar duke i lidhur me llogarinë përkatëse sipas listës së paraqitur në udhëzim;
- ✓ Ka filluar procesi për fiskalizimin e faturave direkt në sportel për shërbime të ndryshme, në mënyrë që të ardhurat të llogariten në sistem dhe që shërben për koston e shërbimeve universale postare.

Një pikë tjetër e rëndësishme, e pasqyruar edhe në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë është dhe dorëzimi në adresë i pakove/kolive postare, pikë për të cilën Posta Shqiptare kryen raportime periodike 3-mujore në AKEP. Referuar këtyre raportimeve, në fund të vitit 2023:

Përqindja e paketave dhe kolive të dala për dorëzim në adresë për vitin 2023 rezulton 57.5% dhe 3 % më e lartë krahasuar me 9/mujorin 2023 ( 55.8%), ndërsa dorëzimi në adresë 42% ose 3.2% më i lartë se 9/mujori.

Pavarësisht rritjes së treguesve, adresat e paplota (vetëm me një element) e bëjnë të pamundur dorëzimin në adresë, veçanërisht në Tiranë e cila ka edhe fluksin më të madh të paketave dhe kolive të hyra nga jashtë vendit, duke impaktuar kështu negativisht rezultatin e të gjithë kompanisë.

AKEP dhe Posta Shqiptare sh.a., janë në kontakt të vazhdueshëm, duke kryer takime në nivel institucional, por edhe raportime periodike në lidhje me hapat e ndjekur për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Gjatë vitit 2023 u realizuan 3 (tre) inspektime rastësore, të cilat u bazuan në indicie apo ankesa me shkrim të drejtuara nga autoritetet shtetërore, personat fizikë apo juridikë. Në përfundim të inspektimeve rastësore janë konstatuar në shkelje të procedurave të pranimit, regjistrimit dhe dorëzimit të objekteve postare, dhe ndaj të 3 (tre) subjekteve të inspektimit janë marrë masa administrative “Gjobë”.

Krahas inspektimeve të programuara në terren, si dhe atyre rastësore, struktura përgjegjëse inspektuese e AKEP, në zbatim të Rregullores nr. 45, datë 27.10.2016, “*Metodika inspektimit të veprimtarisë së ofruesve të shërbimeve postare*”, realizuan inspektimin në distancë duke verifikuar në bashkëpunim me strukturat e tjerë të AKEP të gjithë subjekte që operojnë në treg. Në përfundim të procedurës inspektuese, vetëm 1 (një) subjekt nuk përmbushi detyrimet rregullatorë dhe ndaj tij u ndoqën procedurat për çregjistrim nga regjistri i ofruesve të shërbimeve postare.

## **2.2 Fokusi mbi luftën ndaj informalitetit**

AKEP, si organ rregullator edhe në fushën e ofrimit të shërbimeve postare, ka si qëllim

mbrojtjen dhe të drejtat e çdo përdoruesi dhe ofruesi të shërbimeve postare. Nga ana e strukturave inspektuese janë kryer disa fushata evidentuese të subjekteve që ofrojnë shërbim postar në mënyrë të paautorizuar, duke përdorur rrjetet sociale, të cilët janë referuar më pas në organet kompetente ligj zbatuese. Këto fushata do vijojnë të kryhen në mënyrë periodike, por edhe sporadike, sa herë të ketë ndonjë sinjal nga secili aktor, pjesë e sektorit postar.

Edhe gjatë inspektimeve të programuara, vëmendje e veçantë i është kushtuar verifikimit të zbatimit të kushteve të autorizimit të përgjithshëm, duke u siguruar që të mos ketë devijime nga subjektet as në zonën e ofrimit të shërbimeve, e as në llojet e shërbimeve të ofruara. Njëkohësisht janë kryer verifikime faktike mbi të dhënat përkundrejt vlerave të deklaruara në raportimet periodike për t'u siguruar mbi saktësinë e tyre.

Në fokus të veprimtarisë së AKEP do të vijojë thellimi i luftës kundër informalitetit në bashkëpunim edhe me institucione të tjera ligj zbatuese, me qëllim përmirësimin e klimës së biznesit dhe ndërgjegjësimin e subjekteve në përmbushjen e rregullave dhe standardeve ligjore të vendosura.

Autoriteti e ka orientuar veprimtarinë e tij në mbikëqyrje me një objektiv të dyfishtë: zgjidhje të çështjeve kritike, nga njëra anë; dhe një aktivitet më i gjerë ndërgjegjësues, që synon të tërheqë vëmendje më të madhe për mbrojtjen e përdoruesve nga operatorët, nga ana tjetër.

### ***2.3 Pritshmëritë e sektorit për një treg të qëndrueshëm***

Për të pasur një treg të qëndrueshëm në sektorin postar, AKEP ka qenë e do vijojë të jetë proaktiv, duke u fokusuar në disa fusha, si:

- Kontrolli periodik dhe rastësor i subjekteve, për të siguruar respektimin e ligjeve dhe rregullorëve në fuqi;
- Parandalimi dhe shmangia e informalitetit;
- Vëzhgimi i tregut dhe rritja e konkurrencës;
- Sigurimi për mos krijimin e barrierave për subjektet e reja që synojnë të hyjnë në treg;
- Organizim i takimeve me përfaqësues të subjekteve, me qëllim ndarjen e përshtypjeve, zgjidhjen e problematikave apo shqyrtimet e ankesave;
- Organizim i sondazheve në publik mbi cilësinë e shërbimeve dhe kënaqësinë e përdoruesve të shërbimeve postare.

---

Vlerësojmë se tregu i shërbimeve postare do të vijë drejt normalizimit dhe formalizimit, në mënyrë të veçantë me postën e shërbimeve *online*, kjo edhe me punën që është bërë deri më tani, e që do bëhet në vijim mbi evidentimin e herëpashershëm të subjekteve që reklamojnë shërbim postar dhe që nuk rezultojnë të autorizuar nga AKEP, dhe referimin e çdo rasti pranë organeve ligj zbatuese.

Gjatë viteve 2021-2022 tregu postar dhe sidomos ai i shërbimeve *online* mori një hov dhe lulëzoi pasi u ndikua edhe nga situata pandemike.

Kjo u reflektua edhe në shtimin e ofruesve të licencuar për ofrimin e shërbimeve postare duke e çuar numrin e tyre në Regjistrin e Përgjithshëm të AKEP në vitin 2022 në 36 (tridhjetë e gjashtë) subjekte.

Gjithsesi, pritshmëritë janë që ky treg, i cili kohët e fundit ka marrë një vëmendje të shtuar sa i takon mënyrës dhe shpeshësisë së përdorimit, mund të jetë i qëndrueshëm duke mbajtur nën monitorim subjektet ekzistuese, duke siguruar një treg të lirë për futjen në sektor të subjekteve të reja e duke minimizuar barrierat, e duke qenë të fokusuar në luftën kundër informalitetit. Vetëm në këtë mënyrë nxitet konkurrenca e lirë dhe efektive në ofrimin e shërbimeve postare, mbrohen të drejta e përdoruesve të sektorit postar dhe rritet kënaqësia e klientit dhe nevojat në ndryshim të përdoruesve.

Trendet tregojnë një rritje në strukturën konkurruese edhe midis vetë subjekteve, duke bërë që ata të fokusohen në rritjen e cilësisë së ofrimit të shërbimeve postare, në shtimin e investimeve në teknologji, duke krijuar aplikacione të ndryshme, apo përditësuar sistemet që përdorin në funksion të kryerjes së shërbimit dhe në krijimin e mundësive të reja të ofrimit të shërbimeve, siç është edhe shërbimi *pick-up*.

Gjithashtu, një element plotësues është dhe ndërveprimi me Institucionet Europiane dhe Botërore mbi praktikën, udhëzimet dhe ndryshimet rregullatore koherente.

Në përfundim, për të siguruar konkurrencë dhe mbrojtje efektive të përdoruesve, aktiviteti mbikëqyrës është i përqendruar kryesisht për çështjet e cilësisë së shërbimeve, respektimit të detyrimeve ligjore dhe mbi identifikimin e mekanizmave të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

## IV. MONITORIMI I PËRDORIMIT TË SPEKTRIT TË FREKUENCAVE

### 1. Rishikimi i Planit të Përdorimit të Frekuencave në përputhje me *acquis communautaire* dhe harmonizime të tjera me standarde ndërkombëtare

#### *Përgatitja e Planit të Përdorimit të Frekuencave dhe administrimit të brezave të frekuencave të caktuara për qëllime civile*

AKEP ka dhënë kontributin e tij maksimal me pjesëmarrjen në grupet ndërinstitucionale të ngritur për menaxhimin e spektrit të frekuencave.

Me Vendimin e Këshillit Drejtues nr.07, datë 6.9.2023, AKEP ka miratuar Planin e Përdorimit të Frekuencave.

Ky plan është në përputhje me Planin Kombëtar të Frekuencave (PKF), miratuar me VKM nr.1187, datë 24.12.2020, dhe Planin Kombëtar të Integritimit European (PKIE) 2023-2025 për Kapitullin 10, "Shoqëria e Informacionit dhe Media".

Plani është përgatitur bazuar në dispozitat e ligjit nr.9918, datë 19.5.2008, «Për komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë», i ndryshuar, Konventës dhe Radio Rregulloreve (RR) të Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU), Rekomandimeve të ITU-së dhe Rekomandimeve dhe Vendimeve të Konferencës Europiane të Administratave të Telekomunikacioneve dhe të Postave - CEPT, e direktivave të Komisionit European, si dhe sipas standardeve të Institutit European të Standardeve të Telekomunikacionit (ETSI), duke marrë parasysh përdorimin e radiofrekuencave deri tani.

Për shkak të kërkesës që erdhi nga PKIE për transpozimin e 7 *acquis* që lidhen me spektrin e frekuencave në dokumentin e Planit të Përdorimit të Frekuencave, lindi nevoja për të bërë ndryshime në PPF.

PPF u hartua në mbështetje të shkronjës "ë", të nenit 8, pika 2 e nenit 62, neni 64 i ligjit nr.9918, datë 19.5.2008, «Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë», i ndryshuar (ligji nr. 9918), Planin Kombëtar të Frekuencave, miratuar me VKM nr. 1187, datë 24.12.2020, "Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave", Plani i Përdorimit të Frekuencave, miratuar me VKD nr. 06, datë 31.3.2022, «Për miratimin e Planit të Përdorimit të Frekuencave» (PPF) dhe Planin Kombëtar të



---

Integrimit European (PKIE) 2023-2025.

Plani Kombëtar i Integrimit European (PKIE) është një dokument i qeverisë shqiptare, i cili përgatitet në kuadër të procesit të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin European. Ai përfshin aktet ligjore të parashikuara për t'u miratuar nga institucionet shqiptare për një periudhë 3-vjeçare. Këto akte përafrojnë direktiva dhe rregullore të BE-së si dhe standardet më të mira europiane dhe ndërkombëtare. Aktet ligjore të parashikuara për përafrim janë të ndara në 33 kapituj të *acquis*, ku secili kapitull trajton një fushë të caktuar të politikës së BE-së.

## 2. Rritja e kapaciteteve për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave

### a) Shkëmbim eksperience dhe trajnim nga Organizata Ndërkombëtare e Telekomunikacionit (ITU) dhe Agjencia Kombëtare e Telekomunikacionit (CTU)

Sektorii Monitorimit në AKEP, në kuadër të një trajnime Organizatën Ndërkombëtare të Telekomunikacionit (ITU), Agjencinë Kombëtare të Telekomunikacionit (CTU) ka përfunduar një përvojë të pasur, duke sjellë bashkëpunim të ngushtë dhe ndarje të njohurive të rëndësishme mes organizatave dhe profesionistëve të fushës së telekomunikacioneve.

Në kuadër të trajnimit, ekspertë dhe përfaqësues të CTU dhe AKEP kanë shkëmbyer përvojat dhe praktikat më të mira në fushën e telekomunikacioneve. Kjo është bërë e mundur nga diskutimet intensive, seminarët dhe trajnimet praktike, që kanë përfshirë tematika si zhvillimet më të fundit teknologjike, monitorimi i spektrit të frekuencave sipas standardeve ndërkombëtare dhe aspektet ligjore të fushës.

Një aspekt i rëndësishëm ka qenë shkëmbimi i njohurive mbi monitorimin e spektrit të frekuencave dhe përdorimin e tij efikas. Përvojat e ITU nga një perspektivë ndërkombëtare, njohuritë e CTU në kontekstin rajonal, dhe praktikat e AKEP-it në nivel kombëtar kanë kontribuar në një kuptim të pasur dhe të thelluar të sfidave dhe mundësive në këtë fushë.

Nëpërmjet këtij shkëmbimi njohurish, është stimuluar bashkëpunimi dhe koordinimi i përpjekjeve midis organizatave dhe vendeve të rajonit në monitorimin e spektrit të frekuencave dhe ndërveprimi midis përfaqësuesve të CTU dhe AKEP, duke hapur hapësira për bashkëpunime të ardhshme, përfshirë mundësinë e projekteve të përbashkëta të monitorimit dhe përmirësimit të infrastrukturës së monitorimit.

**b) Zhvillimi i sistemit kombëtar të monitorimit të frekuencave me një sistem kompakt monitorimi dhe sistem informativ për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave të monitorimit**

Në vitin 2023, në kuadër të zhvillimit të Sistemit Kombëtar të Monitorimit të Frekuencave, AKEP ka ndërmarrë një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të sistemit të monitorimit të spektrit të frekuencave, duke implementuar me sukses një sistem kompakt informativ të monitorimit, për të siguruar një shfrytëzim të efektshëm të të dhënave të monitorimit të frekuencave nga 20 MHz deri në 8500 MHz dhe përpunimin e tyre.

Nëpërmjet këtij investimi, është ndërtuar një platformë e avancuar që ofron një gamë të gjerë të mundësive për ruajtje, analizë dhe vizualizim të të dhënave të matjeve. Gjithashtu ky sistem i mundëson AKEP-it të zhvillojë strategji dhe politika të informuara nga një pamje e plotë kombëtare e përdorimit të spektrit. Ky hap është shembull i një strategjie të qartë dhe të përgjegjshme për përmirësimin e monitorimit të spektrit të frekuencave, duke përcaktuar një rrugë të pastër drejt një përdorimi më efikas të burimeve të frekuencave në Shqipëri.

Ky sistem përbën një pjesë të rëndësishme të infrastrukturës së AKEP-it, duke integruar teknologji të avancuara për menaxhimin dhe monitorimin efikas të spektrit të frekuencave për të siguruar një komunikim të qëndrueshëm dhe të përshtatshëm në mjedisin e sotëm të rrjeteve të komunikimit.

Integrimi i sistemit në nivel kombëtar sjell shumë përparësi për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) në monitorimin dhe menaxhimin e spektrit të frekuencave, duke përfshirë:

**Analiza, raportime dhe vizualizime të një game më të gjerë**, për identifikimin e trendeve, pikave të larta dhe të ulëta në zënie e brezave të frekuencave. Mundësimin e një raportimi të strukturuar dhe vizualizim të dhënash në bazë të rajonit gjeografik, kohës dhe frekuencës.

**Procedura të udhëzimit të stacioneve matëse**, më të shpejta dhe automatike, duke lejuar fillimin e matjes njëkohësisht për të gjitha stacionet matëse. Kjo siguron një proces monitorimi të koordinuar, duke rritur efikasitetin e operacioneve.

**Centralizim dhe ruajtje të rezultateve**, për periudha të gjata. Mundëson një databazë të qëndrueshme dhe të arritshme për historikun e matjeve për muaj dhe vite, duke përmirësuar transparencën dhe disponueshmërinë e të dhënave.

**Efikasitet në përdorimin e spektrit:** mundëson përdorimin optimal të burimeve të spektrit, duke zvogëluar interferencat dhe konfliktet.


**Siguri të infrastrukturës:** Integrimi në nivel kombëtar rrit sigurinë duke identifikuar dhe parandaluar ndërhyrjet në spektrin e frekuencave nga operatorë të paautorizuar.

**Analizë të trendeve dhe ndërhyrjet eventuale:** Pas specifikimit të zonës, analizohen trendet në brezin e frekuencave 20-8500 MHz dhe identifikohen pikat e larta dhe të ulëta, duke ndihmuar në zbulimin e përdorimit të spektrit dhe ndërhyrjeve eventuale.

**Monitorim Efikas:** Mundëson monitorimin e spektrit në të gjitha rajonet në mënyrë të koordinuar dhe të përbashkët. Siguron një pasqyrë të plotë të përdorimit të spektrit në nivel kombëtar, duke lejuar identifikimin e ndërhyrjeve potenciale dhe konflikteve.



*Qendra Kombëtare të Monitorimit të Frekuencave*



*Vizualizim në mënyrë grafike që tregon përdorimin e spektrit të frekuencave, në njësinë e kohës*

### 3. Veprimtaria monitoruese gjatë vitit kalendarik 2023

Veprimtaria monitoruese gjatë vitit 2023 është konceptuar në komponentët si më poshtë;


- *Monitorimi i spektrit të frekuencave me anë të stacioneve fikse RFMS dhe SRFMS;*
- *Monitorimi i spektrit të frekuencave të radiolidhjeve fikse;*
- *Trajtim i ankesave për interferenca të dëmshme;*
- *Monitorimi i frekuencave gjatë zhvillimit të eventeve të një rëndësie të lartë (Samiti i Liderëve të Procesit të Berlinit 2023);*
- *Monitorim i cilësisë së shërbimit QoS për telefoninë e lëvizshme.*

#### i. **Monitorimi i spektrit të frekuencave me anë të stacioneve fikse RFMS dhe SRFMS**

Monitorimi i spektrit të frekuencave kryhet nëpërmjet stacioneve të monitorimit RFMS – Krujë dhe RFMS – Pinet në brezin e frekuencave 20 MHz deri në 3000 MHz, ndërsa nëpërmjet stacioneve të monitorimit SRFMS – Shkodër, Vlorë, Korçë, Gjirokastër dhe Fier në brezin e frekuencave 20 – 8500 MHz.

Kontrolli i sistemit të monitorimit realizohet nga Qendra Kryesore e Kontrollit (MCC), e cila është vendosur në zyrat në Tiranë dhe zyrat rajonale Vlorë, Korçë dhe Shkodër. Nga këto zyra është e mundur të kontrollohen në distancë të gjithë Stacionet Fikse të Monitorimit (RFMS) dhe Stacioni përkatës i Thjeshtë Fiks i Monitorimit (SRFMS).

Nga Analiza për Okupimin e Brezave të Frekuencave për rajonin e Tiranës dhe qytetet kryesor ku AKEP ka instaluar stacione fikse monitorimi, jepen Brezat me Okupim të Ulët (0-5%) të Mesëm (5-15%) dhe të Lartë (15-30%), si më poshtë:



*Okupimi i Brezave, Rajonal.*

## ii. Monitorimi i spektrit të frekuencave të radiolidhjeve fikse



Monitorimi i spektrit të frekuencave i cili është realizuar bazuan në Urdhrin e Kryetarit nr.15, datë 10.1.2023, “Për Monitorimin Periodik të Spektrit të Frekuencave”, kryhet nëpërmjet stacioneve të lëvizshme të monitorimit Mobile Monitoring Station – MMS.

Stacionet e monitorimit janë të pajisur me të njëjtat pajisje si RFMS, si dhe me një komplet pajisjesh portative, në mënyrë që të kryejnë gjithë tipet e matjeve speciale, p.sh., tek lidhjet radio fikse (radio reletë apo radio-linqet) ose matësit e intensitetit të fushës elektromagnetike. Me anë të MMS janë kryer operacione monitorimi në të gjithë vendin.

Qëllimet kryesore të përdorimit të këtyre pajisjeve gjatë vitit 2023 kanë qenë verifikimi i përputhshmërisë ligjore dhe administrative i detyrimit të sipërmarrësve që operojnë nën regjimin e Autorizimit Individual të AKEP-it, si dhe që përdorimi i frekuencave të dhëna me autorizim të jetë në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, në zbatim të kushteve të autorizimit, kryesisht për përdorimin e brezit të frekuencave të caktuara për përdorim radiolidhje fikse sipas Planit Kombëtar të Frekuencave dhe Planit të Përdorimit të Frekuencave të AKEP.

Kryerja e monitorimit nga sektori i Administrimit të Qendrës Kombëtare dhe Zyrave Rajonale të Monitorimit të SFR në kuadër të veprimtarisë vjetore të monitorimit të spektrit të frekuencave, për monitorimin e radiolidhjeve fikse, u realizua të paktën një herë në vit, në vendndodhjet kryesore ku janë instaluar pajisjet transmetuese të sipërmarrësve.





*Kulla transmetimi të operatorëve të telefonisë së lëvizshme*

Monitorimi në secilën pikë transmetimi është realizuar nga grupi i monitorimit në përbërjen e të cilit janë pjesëtarë nga sektori i Administrimit të Qendrës Kombëtare dhe Zyrave Rajonale të Monitorimit të SFR. Pasi janë mbledhur të dhënat nga matjet në terren për secilin stacion transmetimi të monitoruar, ato janë përpunuar në raporte monitorimi ku janë detajuar parametrat teknike të transmetimeve.

Për verifikimin e përmbushjes së detyrimit të sipërmarrësve që operojnë nën regjimin e Autorizimit Individual, janë kryer verifikime për të parë nëse frekuencat e identifikuar janë në përdorim sipas Autorizimeve Individuale.

Realizimi i monitorimeve për vitin 2023 është kryer në 24 pika transmetimi, në dhe pas verifikimeve përfundimtare, nuk janë konstatuar operatorë të cilët emetojnë transmetime në radio frekuencë pa u pajisur më parë me Autorizim Individual ose jo në përputhje me të.

### iii. Trajtim i ankesave për interferenca të dëmshme

Monitorimi i spektrit të frekuencave për trajtimin e ankesave për interferenca realizohet kryesisht në bazë të ankesave nga operatorët.

Gjatë vitit 2023 rastet e trajtuara, bazuar në ankesa për interferenca, paraqiten si në Tabelën më poshtë:

Nr.	Operatori	Numri i ankesave	Ankesa të trajtuara	Burime të identifikuar
1	One Albania sh.a.	7	7	3
2	Vodafone Albania sh.a.	6	6	3
3	Operatorë të tjerë	2	2	0
	<b>TOTALI</b>	15	15	6

Tabela. Rastet e interferencave të trajtuara gjatë vitit 2023

Një analizë e rasteve të raportuara të interferencës tregon se shumica e tyre lidhen me frekuencat e përdorura për transmetimet *broadband* GSM, UMTS dhe LTE në frekuencat që përdorin operatorët e rrjeteve të lëvizshëm.


Për këto tipe interferencash, stacionet monitoruese fikse nuk janë gjithmonë të përshtatshëm, meqenëse identifikimi i problemit në këto raste kërkon të identifikohet dhe burimi (drejtimi) i sinjalit interferues, që në përgjithësi operon me një fuqi të ulët dhe në një zonë të ngushtë veprimi. Metoda më praktike dhe tipike në monitorimin e interferencave është kombinimi i stacioneve fikse me pajisjet e stacionit të lëvizshëm të monitorimit për të rritur efikasitetin në hetimin e interferencës.

### Monitorimi i frekuencave gjatë zhvillimit të Samitit të Liderëve të Procesit të Berlinit 2023

Gjatë vitit 2023 AKEP-i ka realizuar monitorimin e spektrit të frekuencave përgjatë zhvillimit të Samitit të Liderëve të Procesit të Berlinit 2023, i cili i zhvilloi punimet në Tiranë, më 15-16 tetor 2023.

Për mbarëvajtjen e Samitit u realizuan monitorime të brezit të frekuencave, si dhe monitorime për treguesit e cilësisë së shërbimit për telefoninë e lëvizshme, para dhe gjate datës së zhvillimit të tij. Ky monitorim u realizua në kuadër të masave për të përmirësuar cilësinë e komunikimit dhe për të zvogëluar interferencat e mundshme, që mund të ndikojnë në transmetimet *live* të televizioneve dhe gazetarëve të shumtë të pranishëm në këtë event.

Angazhimi i AKEP dhe masat e marra nga operatorët e telefonisë së lëvizshme kanë kontribuar drejtpërdrejtë në sigurimin e një ofrueshmërie maksimale të shërbimit gjatë Samitit të Liderëve të Procesit të Berlinit 2023.



Histograma e sinjalit UMTS, LTE për shërbimet voice të VODAFONE Albania sh.a., për Samitin e Procesit të Berlinit në Tiranë

**iv. Monitorim i cilësisë së shërbimit QoS për telefoninë e lëvizshme**  
**a) Monitorim i cilësisë së shërbimit për 100 fshatrat**

Gjatë vitit 2023 AKEP ka realizuar monitorimin e treguesve QoS për:

- 100 Fshatrat e përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.21, datë 12.1.2018, "Për disa shtesa në Vendimin nr. 709, datë 29.10.2014 Për Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural Dhe Bujqësor 2014-2022";
- akset e reja rrugore kombëtare Kardhiq - Delvinë, By Pass i Vlorës, Vlorë - Ura Laskos -Qeparo, Kuç Gusmar - Tepelenë, Rruga e Arbrit, Orikum - Dukat, Palas - Dhërmi, zonat turistike Vermosh, Theth, Valbonë, Dardhë, Voskopojë;
- plazhet kryesore të vendit konsideruar si zona turistike; si dhe
- ndjekjen e përmirësimit të shërbimit të telefonisë së lëvizshme të përcaktuar në monitorimet e viteve të mëparshme.



*Pamje gjatë një monitorimi në terren, viti 2023  
(Burimi: AKEP)*




*Pajisje të përdorura për monitorimin e spektrit të frekuencave  
(Burimi: AKEP)*




Bazuar në rezultatet e monitorimit QoS të fshatrave të sipërcituar, rezulton se në fshatin Sotir të bashkisë Dropull nuk ofrohen shërbimet e telefonisë së lëvizshme nga asnjë prej operatorëve mobile, dhe në fshatin Lëpush të bashkisë Malësi e Madhe nuk ofrohen shërbime nga operatori Vodafone Albania sh.a..

Edhe pse detyrimet e operatorëve të telefonisë së lëvizshme janë për mbulimin me shërbime të 95% të territorit të Republikës së Shqipërisë, i cili sipas informacionit të tyre ky detyrim të përmbushet, AKEP ka kërkuar ofrimin e shërbimeve për këto fshatra, por edhe përmirësimin e shërbimeve të listës së mësipërme brenda parametrave KPI (Key Performance Indicators).

Për të paraqitur një situatë më të qartë të ofrimit të shërbimit Data për fshatrat e mësipërm po paraqesim edhe grafikët e shpejtësive mesatare të shprehura në Mbps të shpejtësive data downloaded.



Grafiku i shpejtësisë mesatare në Mbps për Data Downloaded për zgjedhje automatike të teknologjive 2G/3G/4G



*Grafiku i shpejtësisë mesatare në Mbps për Data Downloaded për zgjedhje automatike të teknologjive 2G/3G/4G*


### **b) Monitorim i cilësisë së shërbimit QoS të akseve të reja rrugore kombëtare**

AKEP, nisur nga fakti i rëndësisë së akseve të reja rrugore të inauguruar përgjatë vitit 2023, ka realizuar monitorimin për cilësinë e shërbimit QoS të akseve Orikum - Dukat, Palas - Dhërmi mbuluar me shërbim optimal nga operatorët One Albania sh.a., dhe Vodafone Albania sh.a..


Akset e reja rrugore kombëtare Kardhiq - Delvinë, By Pass i Vlorës, Vlorë - Ura Laskos - Qeparo, Kuç – Gusmar - Tepelenë, Rruga e Arbrit, operatorët pas kërkesës së AKEP kanë marrë masa provizore dhe të shpejta për përmirësimin e rrjetit aktual.

Këto akse kërkojnë investime për ndërtim të stacioneve të reja, të cilat janë planifikuar për ndërtim nga operatorët, por procedura për lejet e ndërtimit është e tejzgjatur dhe kërkon shumë dokumentacione.





*Grafiku i mbulimit në % për Data Downloaded për zgjedhje automatike të teknologjive 2G/3G/4G në akset e reja rrugore*




*Grafiku i shpejtësisë mesatare në Mbps për Data Downloaded për zgjedhje automatike të teknologjive 2G/3G/4G në akset e reja rrugore*

**c) Monitorim i cilësisë së shërbimit QoS të plazheve të vendit gjatë sezonit veror**


Pritshmërisë të rritjes së fluksit të numrit të turistëve gjatë vitit 2023, e ka angazhuar AKEP-in për të kërkuar nga operatorët e telefonisë së lëvizshme që të merren masa për ofrimin e shërbimit të telefonisë së lëvizshme brenda parametrave KPI në plazhet e vendit gjatë sezonit turistik. Edhe pas kërkesës së AKEP-it, është konstatuar se këto masa nuk kanë qenë të mjaftueshme për të gjitha plazhet.

Operatorët e shërbimit të telefonisë së lëvizshme, sidomos operatori One Albania sh.a., nuk i kanë paraprirë kësaj rritje të numrit të turistëve gjatë vitit 2023, duke mos përmbushur plotësisht detyrimet për ofrimin e shërbimit sipas parametrave KPI.

Grafiku i mëposhtëm e shpjegon më qartë ofrimin e shërbimit të telefonisë së lëvizshme në plazhet e vendit.



Grafiku në % për Data Downloaded në zgjedhje automatike të teknologjisë 2G/3G/4G për plazhet gjatë sezonit veror 2023




Grafiku i shpejtësisë mesatare në Mbps për Data Downloaded për zgjedhje automatike të teknologjive 2G/3G/4G për plazhet gjatë sezonit veror 2023

**d) Monitorim i cilësisë së shërbimit QoS të zonave turistike.**


Rëndësi të veçantë, si çdo vit tjetër, AKEP i ka kushtuar monitorimit të zonave turistike, konkretisht: Vermoshi, Thethi, Valbona, Dardha, Voskopoja. Në këto zona ofrimi i shërbimit të telefonisë së lëvizshme është përmirësuar ndjeshëm duke qenë brenda parametrave KPI.

Gjatë monitorimit të treguesve të cilësisë së shërbimit të telefonisë së lëvizshme në zonën turistike të Thethit është konstatuar ndërprerje e përkohshme e këtij shërbimi nga operatorët. Për këtë rast AKEP ka marrë masat sipas parashikimeve ligjore.

Për zonën turistike të Thethit, por edhe në zona të tjera, një problematikë shqetësuese për operatorët e telefonisë së lëvizshme ka qenë ndërprerja e energjisë elektrike nga OSHEE, e cila ka çuar në furnizimin e këtyre stacioneve me burime të tjera alternative, por nisur nga pozita gjeografike e këtyre stacioneve si dhe i kushteve atmosferike, këto burime kanë kohë të kufizuar duke çuar në mosofrimin e shërbimeve të telefonisë për pajtimtarët. Ofrimin e shërbimit të telefonisë së lëvizshme në zonën kryesore turistike ilustron me grafikët e mëposhtëm.



*Grafiku në % për Data Downloaded në zgjedhje automatike të teknologjisë 2G/3G/4G për zonat turistike*



*Grafiku i shpejtësisë mesatare në Mbps për Data Downloaded për zgjedhje automatike të teknologjive 2G/3G/4G për zonat turistike*



*Pamje nga procesi i monitorimeve të treguesve QoS në zona turistike*

---

# V. BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL I AKEP

## 1. Bashkëpunimi institucional në nivel kombëtar

### *1.1. Bashkëpunimi me AMA-n për parandalimin e piraterisë dhe shtrembërimeve të konkurrencës në shërbimet e komunikimeve elektronike*

Gjatë vitit 2023 u realizuan Inspektive rastësore të cilat u bazuan në indicie apo ankesa me shkrim të sjella nga autoritetet shtetërore, operatorët, personat fizikë, juridikë apo individë, dhe pjesa më e madhe e tyre janë kryer në bashkëpunim të frytshëm me AMA-n.

Në zbatim të Memorandumit të Bashkëpunimit, nënshkruar në vitin 2021, gjatë gjithë vitit 2023 operoi në terren një TASK-FORCE e përbashkët nëpërmjet strukturave të AKEP dhe AMA me qëllim luftën kundër paligjshmërisë në rrjetet e komunikimeve elektronike dhe zhvillimin e veprimtarisë vetëm nga subjekte/sipërmarrës të licencuar dhe autorizuar nga autoritetet rregullatorë.

Si rezultat i veprimeve të kësaj Task Force janë vendosur masa administrative (3 gjoba) ndaj sipërmarrësve që nuk plotësonin detyrimin mbi respektimin e rasteve të kufizimeve në lidhje me përmbajtjen e paligjshme ose të dëmshme apo detyrime të tjera rregullatorë.

Lidhur me fenomenin e piraterisë audiovizive nëpërmjet internetit, theksojmë se, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, AKEP pasi administron kërkesat nga organet ligj zbatuese me objekt bllokimi i faqeve web me përmbajtje të paligjshme, njofton me shkresë zyrtare, por edhe përmes postës elektronike, sipërmarrësit e komunikimeve elektronike për të kryer veprimet e mbylljes së aksesit të faqeve elektronike.

AKEP në bashkëpunim AMA ndjek në vazhdimësi problematikat e shkaktuara nga pirateria në tregun e komunikimeve elektronike. Në vijimësi të këtij bashkëpunimi, u realizua një takim i përbashkët i dy institucioneve si dhe me praninë e ISP-ve më të mëdha në vend (Vodafone Albania sh.a.; One Albania sh.a.; Abissnet sh.a.; ASC sh.a.; Digi Com sh.p.k.) në të cilin u diskutuan problematika dhe mundësitë për mbylljen e linqeve të ndryshme të internetit të cilat kryejnë pirateri televizive, me qëllim nxitjen e konkurrencës së lirë dhe të drejtë të tregut të komunikimeve elektronike. Si përfundim, theksojmë se AKEP-i do të vijoj bashkëpunimin si me AMA-n ashtu edhe me të gjithë sipërmarrësit me qëllim përmbushjen e objektivave lidhur me mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike.



## 1.2 Bashkëpunimi me Autoritetin e Konkurrencës

AKEP-i përgjatë vitit 2023 ka shtuar vëmendjen mbi evoluimin e tre prej parametrave kryesorë që mban nën mbikëqyrje:

- çmimet e pakicës;
- treguesit e cilësisë së shërbimit;
- nivelin e investimeve të operatorëve.

AKEP-i është i gatshëm të ndërhyjë përmes instrumenteve ligjorë dhe rregullatorë, që janë në dispozicion të tij, dhe t'i referojë Autoritetit të Konkurrencës rastet që mund të ngrenë dyshime për marrëveshje të ndaluara apo abuzim me pozitën dominuese. Në këtë kuadër, në vijim të bashkëpunimit midis dy institucioneve, AKEP-i ka përcjellë pranë Autoritetit të Konkurrencës informacion të detajuar mbi planet tarifore të shërbimeve mobile, si dhe ndryshimet e tyre me arsyetimet mbështetëse. Pjesë e rëndësishme e bashkëpunimit midis dy institucioneve ka qenë edhe përgatitja mbi raportimin e statusin e harmonizimit të legjislacionit kombëtar me atë të BE-së, procesi i njohur si 'screening'. Në këtë kuadër strukturat e AKEP-it kanë bashkëpunuar me Autoritetin e Konkurrencës, institucion i cili ka drejtuar dhe koordinuar diskutimet mbi Kapitullin 8, "Politika e Konkurrencës".

Gjithashtu, strukturat e AKEP-it kanë marrë pjesë në eventet dhe takimet e organizuara nga Autoriteti i Konkurrencës gjatë vitit 2023 për tematika që lidhen me promovimin dhe nxitjen e konkurrencës në fushën e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare.



*Anëtari i Këshillit Drejtues të AKEP, Z. Armer Juka, në një panel mbi temën “Pavarësia dhe roli i Autoritetit në reformën rregullatore” në kuadrin e Konferencës ndërkombëtare të organizuar nga Autoriteti i Konkurrencës për të kremtuar 20-vjetorin e ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”*

*(Burimi: Autoriteti i Konkurrencës)*





### **1.3. Bashkëpunimi me sipërmarrësit dhe grupet e interesit në kuadër të zbatimit të Rregullores për të drejtat e përdoruesve**

Gjatë vitit 2023, AKEP-i ka pasur komunikime me dy operatorët kryesorë, One Albania sh.a., dhe Vodafone Albania sh.a., në lidhje me kryerjen e disa ndryshimeve dhe saktësimeve në termat dhe kushtet e përgjithshme të kontratave të pajtimit për shërbimet e ofruara nga rrjetet celulare dhe fikse si dhe për përmirësimin e informacionit të publikuar për konsumatorët/pajtimtarët në faqet e internetit të sipërmarrësve.

Komunikimet me One Albania kanë qenë në kuadër të vlerësimit nga AKEP të termave dhe kushteve të përgjithshme të kontratave të pajtimit të hartuara nga sipërmarrësi pas bashkimit të operatorëve One Telecommunications dhe Albetelecom. Nëpërmjet këtyre komunikimeve AKEP-i ka kërkuar nga sipërmarrësi kryerjen e ndryshimeve përkatëse në termat dhe kushtet e përgjithshme të kontratave të pajtimit me qëllim respektimin e plotë përcaktimeve të ligjit 9918/2008 si dhe të Rregullores 49/2021, “Për mbrojtjen e konsumatorëve dhe pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”.

Për sa i përket përmirësimit të informacionit për pajtimtarët, publikuar në faqet e internetit të dy sipërmarrësve, AKEP ka kërkuar ndër të tjera që:

- informacioni për pajtimtarët në lidhje me termat dhe kushtet e përgjithshme të kontratave të pajtimit, mjetet e pranimi të ankesave të pajtimtarëve etj., i ndodhur në seksione të ndryshme të faqes së internetit të sipërmarrësit, të përfshihet në një seksion lehtësisht të aksesueshëm nga konsumatorët/pajtimtarët si “Suport” apo “Kujdesi për klientët”;
- dokumenti i termave dhe kushteve të përgjithshme të kontratave të pajtimit

në faqen e internetit të sipërmarrësit të përmbajë datën e hyrjes në fuqi të tyre si dhe detaje kontakti, për të vënë në dispozicion të personave me aftësi të kufizuar këtë dokument në version 'large print' apo 'braille'.

Në vijim të komunikimeve dhe diskutimeve me dy sipërmarrësit, në lidhje me njoftimin e sipërmarrësit në përfundim të kontratës me afat të caktuar dhe kalimin e kontratës, në kontratë me afat të pacaktuar apo ndërprerjen e shërbimit, AKEP-i ka vlerësuar se vijueshmëria e ofrimit të shërbimit është e rëndësishme për pajtimtarin, dhe aplikimi i parimit të miratimit në heshtje (në rast se pajtimtari nuk shprehet me shkrim për mbylljen/ndërprerjen e kontratës pas marrjes së njoftimit përkatës) për kalimin e kontratës me afat të caktuar mund të zbatohet në kushtet kur pajtimtari ka të drejtën e zgjidhjes së saj (kontratës me afat të pacaktuar) në çdo kohë dhe pa penalitet/kosto shtesë, nëpërmjet njoftimit 30 ditor ndaj sipërmarrësit, përveç koston së shërbimeve të përfituara gjatë periudhës së njoftimit maksimalisht 30 ditor të pajtimtarit ndaj sipërmarrësit për zgjidhje/mbyllje të kontratës me afat të pacaktuar.

Një aspekt i rëndësishëm i Rregullores 49/2021 ishte përcaktimi i masave që duhet të ndërmarrin sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve elektronike publike për të garantuar akses të barabartë për personat me aftësi të kufizuar (PAK).

Nga informacioni i dërguar nga dy sipërmarrësit kryesorë të rrjeteve celulare dhe fikse, Vodafone Albania sh.a., dhe One Albania sh.a., në lidhje me zbatimin e masave dhe lehtësirave të parashikuara në Rregulloren 49/2021 si dhe përdorimin e tyre nga PAK gjatë vitit 2023, rezulton se të dy sipërmarrësit:

- kanë krijuar dhe zbatojnë procedura për identifikimin dhe regjistrimin e pajtimtarëve si persona me aftësi të kufizuar në sistemet tyre të brendshme të menaxhimit të marrëdhënieve me klientët;
- kanë të publikuar në faqet e tyre të internetit seksione të dedikuara për PAK me informacion të detajuar sipas llojit të aftësisë së kufizuar, si kufizime në shikim, dëgjim/artikulim, lëvizje etj., përfshirë ofrimin e paketave të veçanta tarifore me zbritje për këto kategori përdoruesish dhe udhëzime për lehtësirat e ofruara dhe komunikim të veçantë të kujdesit të klientit të operatorit me këta pajtimtarë;
- kanë përgatitur dhe publikuar termat dhe kushtet e përgjithshme të kontratave të pajtimit (shërbime celulare dhe fikse) në format audio, për përdoruesit me aftësi të kufizuar në shikim;
- kanë marrë masa për trajtimin me prioritet të gjithë kërkesave, ankesave dhe suporti teknik për pajtimtarët e regjistruar si PAK;
- u kanë dhënë pajtimtarëve mendësinë që me vullnetin e tyre të lirë të mund të zgjedhin të japin të dhëna mbi llojin e paaftësisë, nëse kanë apo dëshirojnë të kenë kujdestar ligjor/person të autorizuar, për të menaxhuar faturat dhe

---

marrëdhënien me sipërmarrësin, mënyrën e preferuar për t'u kontaktuar nga operatori dhe nëse dëshirojnë të marrin kontratën apo faturën në format Large Print/Braille/Audio, si dhe të përfitojnë nga oferta/zbritjet në paketa të veçanta tarifore;

Deri në fund të vitit 2023 numri i pajtimtarëve të regjistruar si PAK në sistemet e dy sipërmarrësve ishte 197 (182 Vodafone Albania dhe 15 One Albania):

- 12 pajtimtarë PAK të One Albania kanë përfituar ulje deri në 50% të tarifës mujore për paketat e shërbimit të aksesit në internet me fibra optike/IPTV në rrjet fikse, ndërsa
- 180 pajtimtarë PAK të Vodafone kanë mundësinë të përfitojnë 50% ulje në paketat mujore celulare me parapagim sipas zgjedhjes individuale të paketës nga pajtimtari.

Përveç sa më sipër, sipërmarrësi Vodafone Albania ka informuar AKEP-in se gjatë vitit 2023 ka bashkëpunuar me shoqatën ANAD (Shoqata Kombëtare Shqiptare e Njerëzve që nuk Dëgjojnë) për identifikimin e PAK në dëgjim (180 pajtimtarë), si dhe nëpërmjet fondacionit Vodafone Albania ka dhuruar:

- 50 aparate celulare dhe 50 karta SIM me lidhje interneti për mbështetjen e grave dhe grave me aftësi të kufizuara;
- 20 pajisje elektronike, 7 karta SIM me paketë bazë me parapagim;
- 40 paketa *roaming* për Ekipin Olimpik Special për të marrë pjesë në Lojërat Botërore të Olimpiadës Speciale, Berlin 2023 (event sportiv botëror për personat me aftësi të kufizuara).

Gjithashtu, AKEP-i në kuadër të zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025, të miratuar me VKM nr. 276, datë 12.5.2021, ka komunikuar me MSHMS duke dërguar informacion për përfshirjen dhe integrimin shoqëror të Personave me Aftësi të Kufizuara në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike publike për periudhën 2021-2023.

## Bashkëpunim me Komisionin e Mbrojtjes së Konsumatorit (KMK)

Gjatë vitit 2023 AKEP-i ka vijuar bashkëpunimin me Komisionin e Mbrojtjes së Konsumatorit (KMK) në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, për trajtimin e ankesave të qytetarëve si dhe në dhënien e kontributeve dhe raportimit në procesin e shqyrtimit analitik të *acquis (screening)* për Kapitullin 28 “Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndetit”, në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Europian.

Në takimin bilateral BE – Shqipëri, të zhvilluar më 16-17 shkurt 2023 për Kapitullin 28, AKEP prezantoi ndër të tjera bazën ligjore dhe kompetencat kryesore të tij për mbrojtjen e konsumatorit në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare, procedurat për zgjidhjen (alternative) të mosmarrëveshjeve (ZAM) midis përdoruesve/konsumatorëve dhe ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe postare, si dhe ecurinë dhe trajtimin e ankesave dhe procedurat ZAM gjatë tre viteve të fundit (2020-2022).

Përfaqësuesit e Komisionit vunë në dukje se Shqipëria është në rrugën e duhur për ZAM dhe trajtimin e ankesave të konsumatorëve, dhe rritja e numrit të rasteve të trajtuara tregon për rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve dhe punën e kryer për trajtimin e tyre.

## Bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Emergjencave Civile (AKMC)

Gjatë vitit 2023, AKEP ka bashkëpunuar me Agjencinë Kombëtare të Emergjencave Civile (AKMC) në kuadër të zbatimit të Urdhrit të përbashkët nr. 125, datë 28.2.2023, të Ministrit të Mbrojtjes dhe të Ministrit të Brendshëm, nëpërmjet të cilit është ngritur Grupi Ndërinstitucional i Punës për hartimin e projektvendimit «Për ngritjen dhe funksionimin e numrit të unifikuar të thirrjeve emergjente 112».

Në kuadër të detyrimeve të Rregullores 49/2021 për aksesin në shërbimet e emergjencës dhe për personat me aftësi të kufizuara, AKEP në komentet dhe sugjerimet e dhëna për draft-VKM e përgatitur nga GNP, “Për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të numrit të unifikuar të thirrjeve emergjente 112”, ka kërkuar ndër të tjera që të përfshihen përcaktime për mundësitë teknike të sistemit 112 për marrjen e Caller Location Information dhe SMS/text, pra që Sistemi i trajtimit të thirrjeve/komunikimeve të emergjencës të numrit 112 të mundësojë:

- *marrjen e informacionit për vendndodhjen e thirrësit, përfshirë informacionin për vendndodhjen nëpërmjet zgjidhjes AML (Advanced Mobile Location) të gjeneruar nga aparatet e lëvizshme smart me sistem android dhe iOS;*
- *komunikimin me SMS, apo mënyra të tjera komunikimi me tekst, përfshirë video kur është teknikisht e mundshme, të përshtatshëm për personat me aftësi ndryshe/të kufizuara në komunikim (dëgjim dhe/ose të folur).*

---

AKEP ka dhënë gjithashtu sugjerime për GNP në lidhje me përfshirjen e përkufizimeve të lidhura me shërbimet e emergjencës, në përputhje me përkufizimet përkatëse të draft-ligjit të ri për komunikimet elektronike, që synon transpozimin e EECC si dhe raporte të KE-së mbi efektivitetin dhe përvojat më të mira në vendet e BE-së për implementimin e numrit unik të emergjencave 112.

## Ankesat e pajtimtarëve

Në vitin 2023 në AKEP u depozituan 2123 ankesa nga pajtimtarët e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike, që përbën një rritje të ndjeshme në krahasim me 415 ankesa të paraqitura në vitin 2022.

- 1371 ankesa apo 65% e totalit ishin në lidhje me problematikat e hasura në refuzimin e kërkesave për bartjen e numrit celular nga operatori transferues; ndërsa,
- 752 ankesa ishin për problematika të tjera si faturimi, barrierat/vonesat për mbylljen e kontratës apo kalimin nga plane tarifore paspagesë në ato me parapagesë, cilësinë e shërbimit, penalitete për përfundim të parakohshëm të kontratës nga pajtimtari në rast ndryshimi të adresës së pajtimtarit etj.

Rreth 90% e volumit të ankesave të depozituara në AKEP në vitin 2023 ishin për sipërmarrësin One Albania sh.a., kryesisht për portimin e numrit dhe problematika të lidhura me faturimin dhe aspekte të ndryshme të cilësisë së shërbimit të ofruar për pajtimtarët.

Në vijim të një serie problematikash të konstatuara nga AKEP dhe numrit të konsiderueshëm të ankesave, AKEP ka kryer disa inspektime pranë sipërmarrësit One Albania në vitin 2023, duke kërkuar ndër të tjera trajtimin e problematikave të evidentuara nga ankesat e pajtimtarëve, si dhe duke vendosur masë administrative me gjobë nëpërmjet VKD nr. 14, datë 24.10.2023.

AKEP ka vendosur një sërë mjetesh në dispozicion të pajtimtarëve për depozitimin e ankesave në rrugë shkresore dhe elektronike me *e-mail*, përfshirë formular për pajtimtarët për kërkesa për zgjidhje mosmarrëveshje me operatorët, të publikuar në faqen e internetit të AKEP.

Me qëllim lehtësimin e mëtejshëm të procesit të depozitimit të ankesave të qytetarëve, AKEP gjatë vitit 2023 krijoi dhe një modul *online* (<https://akep.al/e-ankesa/>) i disponueshëm direkt në faqen kryesore (*homepage*) të internetit të AKEP.

Në vitin 2023, Komisioni i Zgjidhjes Alternative të Mosmarrëveshjeve (KZAM) të AKEP zhvilloi:

- 10 procedura zgjidhje mosmarrëveshje midis pajtimtarëve dhe ofruesve të

shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Nga këto, në 8 mosmarrëveshje është arritur zgjidhje miqësore midis palëve në seanca dëgjimore/pajtimi apo nëpërmjet rekomandimeve të KZAM, ndërsa në 2 mosmarrëveshje, pavarësisht rekomandimit të KZAM për zgjidhje në favor të pajtimtarit, dhe pranimit e zbatimit nga operatori të rekomandimit, pajtimtarët kanë kërkuar dëmshpërblim monetar më të madh për dëm moral (duke ju referuar edhe Kodit Civil), të cilat janë jashtë objektit të KZAM dhe ankimesit kanë të drejtën të kërkojnë zgjidhjen në rrugë gjyqësore.

Pas rënies së konsiderueshme të ankesave për refuzim/vonesa në portim të numrit celular në vitin 2022, ankesat për portimin e numrit u rritën sërish në vitin 2023, duke arritur nivelet e larta të viteve 2020 dhe 2021. Problematikat e raportuara lidhen me refuzimet e kërkesave për portim të numrit nga operatori transferues, për arsye të mospërputhjes së ID së përdoruesve me parapagim në sistemet e operatorit dhënës/transferues me ID në kërkesën për portim të dërguar nga operatori marrës/përfitues dhe detyrimeve kontraktore të pajtimtarit me paspagim tek operatori transferues.

Bazuar në problematikat e evidentuara në këtë proces bashkëpunimi për portimin e numrit, AKEP synon që gjatë vitit 2024, krahas proceseve të monitorimit/inspektimit të zbatimit nga operatorët të detyrimeve dhe rekomandimeve të lëna në inspektimet e mëparshme, të kryejë dhe disa ndryshime në Rregulloren e portabilitetit. Këto ndryshime do synojnë përmirësimin e procesit të portimit nëpërmjet vendosjes së detyrimeve dhe përgjegjësive edhe për operatorin dhënës për informim të pajtimtarit për arsyet e refuzimit të kërkesës për portim.



---

## 2. Bashkëpunimi institucional në nivel rajonal

### 2.1. *Nënshkrimi i marrëveshjeve ndërkufitare midis vendeve të rajonit për koordinim në sistemet MFCN në bandat 800Mhz, 900Mhz, 1800Mhz, 2100Mhz dhe 2600Mhz*

AKEP vitet e fundit ka shtuar të gjitha përpjekjet për të bërë të mundur nënshkrimin e marrëveshjeve teknike me qëllim koordinimin ndërkufitar. Kryesisht është punuar për arritjen e marrëveshjeve për koordinim në sistemet MFCN në brezat 800 MHz, 900 MHz, 1800 MHz, 2100 MHz, 2600 MHz dhe 3400-3800 MHz për të shmangur në maksimum interferencat në zonat kufitare.

Gjatë vitit 2023, AKEP ka nënshkruar marrëveshjet teknike për harmonizimin e frekuencave ndërkufitare me:

- Agjencinë e Komunikimeve Elektronike dhe Shërbimeve Postare të Malit të Zi (EKIP);
- Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare të Republikës së Kosovës (ARKEP).

Marrëveshjet teknike ndërmjet Agjencisë së Komunikimeve Elektronike dhe Shërbimeve Postare të Malit të Zi (EKIP) dhe Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) të Republikës së Shqipërisë, të nënshkuara në 19.4.2023 në Podgoricë, kanë si qëllim të përcaktojnë parimet, dispozitat teknike dhe procedurën administrative të nevojshme për të rregulluar vendosjen e përbashkët të sistemeve MFCN në brezat e frekuencave 800/900/1800/2100/2600 MHz në zonat kufitare.



*Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit mes AKEP dhe EKIP, Podgoricë, Mali i Zi, prill 2023  
(Burimi: EKIP)*







*Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit mes AKEP dhe EKIP, Podgoricë, Mali i Zi, prill 2023  
(Burimi: EKIP)*

Marrëveshjet teknike ndërmjet Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) dhe Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), të nënshkruara në 7.11.2023 kanë si qëllim të përcaktojnë parimet, dispozitat teknike dhe procedurën administrative të nevojshme për të rregulluar vendosjen e përbashkët të sistemeve MFCN në brezat e frekuencave 800/900/1800/2100/2600 MHz dhe 3400-3800 MHz në zonat kufitare.

Gjithashtu, më datë 2.10.2023 janë nënshkruar marrëveshjet teknike rajonale për koordinim kufitar në brezin e frekuencave 3400-3800 MHz midis autoriteteve të Shqipërisë, Bosnje Hercegovinës, Kroacisë, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë. Në kuadër të nenit 6, të Rregullores së Radios ITU, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) (Administrata e Republikës së Shqipërisë), Agjencia Rregullatore e Komunikimeve (CRA) (Administrata e Bosnjës dhe Hercegovinës), Autoriteti Rregullator Kroat për Industrinë e Rrjetit (HAKOM) (Administrata e Republikës së Kroacisë), Agjencia për Komunikime Elektronike dhe Shërbime Postare (EKIP) (Administrata e Malit të Zi), Agjencia për Komunikime Elektronike (AEC) (Administrata e Republikës së Maqedonisë së Veriut) dhe Agjencia Rregullative për Komunikime Elektronike dhe Shërbime Postare (RATEL) (Administrata e Republikës së Serbisë) (në tekstin e mëtejshëm: Autoritetet nënshkruese) kanë lidhur këtë Marrëveshje Teknike për koordinimin kufitar të rrjeteve të komunikimit celular/fiks (MFCN) në brezin e frekuencës 3400-3800 MHz.



*Nënshkrimi i marrëveshjeve ndërkuftare midis vendeve të rajonit për koordinim në sistemet MFCN në bandat 800Mhz, 900Mhz, 1800Mhz, 2100Mhz dhe 2600Mhz ndërmjet AKEP, ARKEP, EKIP dhe AEK të nënshkruara në Prishtinë, nëntor 2023*

(Burimi: AKEP)

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje Teknike është të përcaktojë parimet, dispozitat teknike dhe procedurën administrative të nevojshme për të rregulluar vendosjen e përbashkët të sistemeve MFCN në brezin e frekuencave 3400-3800 MHz në zonat kufitare.

Brezi i frekuencës 3400-3800 MHz është caktuar për sistemet MFCN sipas Vendimit të ECC ECC/DEC/(11)06 (versioni që është në fuqi në kohën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje Teknike është bashkangjitur për referencë). Kjo Marrëveshje Teknike është e zbatueshme për sistemet MFCN TDD me jo-AAS dhe AAS, që funksionojnë brenda rregullimit të harmonizuar të frekuencës dhe kushteve teknike të përcaktuara në Vendimin e përmendur më sipër të ECC.





*Nënshkrimi i marrëveshjeve ndërkufitare midis vendeve të rajonit për koordinim në sistemet MFCN në bandat 800Mhz, 900Mhz, 1800Mhz, 2100Mhz dhe 2600Mhz ndërmjet AKEP, ARKEP, EKIP dhe AEK të nënshkruara në Prishtinë, nëntor 2023*

*(Burimi: AKEP)*

Ndërkohë AKEP vazhdon bashkëpunimin me autoritetet rregullatore kufitare dhe operatorët për menaxhimin e parametrave teknikë të stacioneve të përcaktuara në marrëveshjet përkatëse dhe vendosjen e tyre në normat e lejuara.

## **2.2 Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me autoritetin homolog të Kosovës**

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare i Republikës së Shqipërisë dhe Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare i Republikës së Kosovës kanë nënshkruar më datë 7.9.2023, një Memorandum Mirëkuptimi në lidhje me bashkëpunimin midis palëve në hartimin e politikave dhe programeve për të adresuar sfidat rregullatore aktuale dhe në të ardhmen, në të dy vendet si edhe në rajon, bazuar në praktikat e mira të BE-së dhe angazhimet ndërkombëtare.



*Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit mes AKEP dhe ARKEP, nëntor 2023  
(Burimi: AKEP)*

Pjesë e nënshkrimit ishin edhe Marrëveshje lidhur me Koordinimin Kufitar të rrjeteve Mobile/Fikse, në Brezin e Frekuencave 3400 – 3800, 1920-1980 MHz dhe 2110-2170 MHz, 880-915 MHz dhe 925-960 MHz, 2500-2690 MHz, 1710-1785 MHz, 1805-1880 MHz dhe 790-862 MHz

Nëpërmjet Memorandumit të Mirëkuptimit do të:

- Rritet bashkëpunimi dhe koordinimi për sa i përket implementimit në të ardhmen e afërt të gjeneratës së pestë të teknologjive mobile (5G) për rrjetet e komunikimeve elektronike, veçanërisht sa i përket harmonizimit ndërkufitar të frekuencave;
- Rritet bashkëpunimi në fushën e harmonizimit të frekuencave ndërkufitare, në përgatitjen e marrëveshjeve teknike dhe përshtatjen e tyre me planet e përdorimit të frekuencave dhe harmonizimin e spektrit të frekuencave 5G;
- Vioj bashkëpunimi për zbatimin e marrëveshjes RLAH për heqjen e tarifave *roaming* midis vendeve të Ballkanit Perëndimor;
- Vioj bashkëpunimi për uljen dhe përshtatjen e tarifave të *roaming*-ut midis vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Bashkimit Europian.



---

Nënshkrimi i marrëveshjeve ndërkufitare me Republikën e Malit të Zi dhe Republikën e Kosovës ka si qëllim të përbashkët përcaktimin e rregullave administrative dhe procedurat teknike për planifikimin dhe koordinimin e frekuencave, me qëllim përdorimin sa më optimal të radiospektrit, si dhe parandalimin e interferencave të dëmshme në rrjetet e shërbimeve fiks radio dhe ato telefonike tokësore të lëvizshme.

### 3 Bashkëpunimi institucional në nivel ndërkombëtar

#### *3.1. Rishikimi i marrëveshjeve të punës mes BEREC dhe autoriteteve rregullatore të Ballkanit Perëndimor*

AKEP ka shënuar një moment të rëndësishëm në bashkëpunimin e tij me BEREC, duke nënshkruar një Marrëveshje Pune në fillim të vitit 2019. Ndërveprimi i vazhdueshëm dhe zhvillimi i raporteve mes AKEP dhe BEREC ka bërë që, në vitin 2023, të nënshkruhet një Marrëveshje e re Pune mes tyre. Kjo marrëveshje shënoi një fazë të re dhe përmirësime thelbësore, duke sjellë disa ndryshime të rëndësishme në bashkëpunim.

Ndër ndryshimet kryesore të kësaj marrëveshje, një aspekt i veçantë ishte kërkesa për aprovim nga Komisioni Europian për nënshkrimin e saj. Kjo kërkesë për aprovim tregoi rëndësinë dhe impaktin e këtij bashkëpunimi në kontekstin më të gjerë europian. Pas një procesi vlerësimi nga ana e Komisionit Europian, aprovimi për nënshkrimin e marrëveshjes u mor më 2 qershor 2023.

Kjo hapje e re rruge për bashkëpunim, u pasua nga faza e diskutimeve dhe miratimit, duke kulmuar në një moment vendimtar gjatë Mbledhjes Plenare të BEREC në Budva, Mali i Zi, më 9 qershor 2023.

Miratimi i kësaj marrëveshje shënon një sukses të përbashkët për AKEP dhe BEREC, duke krijuar një kornizë të rregulluar dhe të avancuar për bashkëpunimin e tyre në fushën e telekomunikacioneve. Në një proces të tillë kaluan dhe autoritetet rregullatore të Ballkanit Perëndimor. Ky rezultat i arritur është i rëndësishëm për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, pasi theksohet vazhdimësia e angazhimit të përbashkët në zhvillimin dhe harmonizimin e sektorit të telekomunikacioneve në rajon dhe Europë. Marrëveshja e përfunduar është tashmë e publikuar në faqen zyrtare të BEREC, duke bërë kështu të mundur qasjen dhe njohjen e saj nga publiku.

### 3.2. Planifikimi i bashkëpunimit teknik me Unionin Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve (ITU)



*Kryetari i AKEP dhe z. Zavazava, Drejtor i ITU  
Telecommunication Development Bureau,  
gjatë një takimi bilateral në Budva, shtator 2023  
(Burimi: AKEP)*

Përgjatë Forumit Rajonal Rregullator të zhvilluar në Budva, organizuar nga EKIP (Agjencia e Komunikimeve Elektronike dhe Postare të Malit të Zi) dhe ITU (Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit), një delegacion i AKEP, i kryesuar nga Kryetari z. Tomi Frashëri, zhvilluan në datën 28 shtator 2023, një takim Bilateral me përfaqësues të lartë të ITU-së për çështje me interes të përbashkët, nën frymën e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave.

ITU përfaqësohej në këtë takim nga z. Cosmas Zavazava, Drejtor për Zhvillimet Rregullatore në Telekomunikacion dhe z. Jaroslaw Ponder, Drejtor për zyrën e ITU për Europën.

Përgjatë këtij takimi, AKEP kërkoi nga ITU mbështetje për të çuar përpara disa projekte të rëndësishme, si:

- *Ndërtimi i Atlasit të ri.*

Mbështetja u kërkua për hartimin e termave të referencës, por edhe mundësi për financimin e këtij projekti nga ITU si dhe dhënien e ndihmës për marrjen e eksperiencave më të mira për ndërtimin e Atlasit *broadband*.

- *Zgjerimi, zhvillimi dhe përditësimi i sistemit kombëtar të monitorimit*

Sistemi kombëtar i monitorimit është implementuar përpara 12 vitesh me ndihmën e ITU. AKEP ka si synim të zgjerojë dhe përditësojë sistemin për të analizuar brezat për shërbimet dhe rrjetet e gjeneratës së ardhshme, duke përfshirë këtu teknika të reja për monitorimin e frekuencave në vendet kufitare, frekuencave të përdorura për qëllime ushtarake, stacionet satelitore tokësore, etj.



*Përfaqësues të AKEP përgjatë një takimi bilateral me zyrtarë të lartë të ITU z. Zavazava, Director of the ITU Telecommunication Development Bureau Jaroslav Ponder, Head of the ITU Office for Europe, Budva, shtator 2023  
(Burimi: AKEP)*

- *Organizimi i AKEP bazuar në Kodin e Komunikimeve Elektronike dhe çështjet e të ardhurave.*

Mbështetja u kërkua lidhur me hartimin e një studimi mbi strukturën organizative të AKEP, nën suazën e misioneve dhe detyrave të ngarkuara nga draft ligji i ri për komunikimet elektronike, për të përcaktuar qartë kompetencat, përkrahjet e punës, aftësitë, për një strukturë sa më eficiente.

Gjithashtu, u kërkua asistencë lidhur me çështjet financiare të AKEP, rritjen e të ardhurave si rezultat i rritjes së kostove, shpenzimeve administrative për investimet dhe mirëmbajtjen e infrastrukturave kritike, rekrutimin dhe mbajtja e burimeve njerëzore cilësore, etj.

### **3.3 Bashkëpunimi me autoritetet rregullatore amerikane FCC dhe NTIA**

Një delegacion i AKEP-it, zhvilloi në Washington D.C. një sërë takimesh të nivelit të lartë me homologë dhe partnerë të institucionit.

Takimi me NTIA, Agjencinë Kombëtare të Telekomunikacioneve dhe të Informacionit,



pjesë e Departamentit të Tregtisë, u përqendrua në përgatitjen, hartimin, konsultimin dhe miratimin e politikës spektrale. Scott Blake Harris, Këshilltar i Lartë i Spektrit/ Drejtor i Strategjisë Kombëtare Spektrale, ndau përvojën e agjencisë së tij në këtë proces delikat dhe të domosdoshëm.

Në cilësinë e entit të ngarkuar me administrimin e spektrit të frekuencave në përdorim nga autoritetet federale, NTIA nënvizoi rëndësinë e alokimit të një sasive të caktuar spektri në breza të ndryshëm për përdorime jo-tregtare, duke përfshirë mbrojtjen dhe sigurinë, aviacionin civil, kërkimin shkencor, etj.

Megjithë vështirësitë e parashikueshme dhe të paparashikueshme, NTIA përqafon idenë se përdorimi përherë e më intensiv i spektrit nga teknologjitë e reja implikon në mënyrë të pashmangshme forma të ndryshme bashkëpërdorimi të brezave të frekuencave.

Nga ana tjetër, zhvillimet e vullshme teknologjike bëjnë të domosdoshëm parashikimin e një fondi zhvendosjeje, të krijuar nga të ardhurat e shitjes së të drejtave të frekuencave, me synim kompensimin e operatorëve ekzistues në brezat e frekuencave të ridestinuara për teknologji të reja dhe të përparuara.



*Përfaqësues të AKEP gjatë takimit zyrtar me Agjencinë Kombëtare të Telekomunikacioneve dhe të Informacionit (NTIA), pjesë e Departamentit të Tregtisë, Uashington DC, korrik 2023  
(Burimi AKEP)*

Takimi në FCC, Komisionin Federal të Komunikimeve, ishte i një rëndësie të posaçme për shkak se u trajtuan dy prej çështjeve kryesore në agjendën institucionale të AKEP, siç janë alokimi i brezave të rinj për shtrirjen e teknologjisë 5G dhe siguria e rrjeteve.



*Përfaqësues të AKEP gjatë takimit zyrtar me Komisionin Federal të Komunikimeve FCC, Uashington DC, korrik 2023*

*(Burimi: AKEP)*

Martha Stancill, asistent/shefe në Divizionin e Ankandëve, paraqiti filozofinë dhe objektivat ligjorë të zbatueshëm në Sh.B.A. për caktimin e frekuencave. Përfshirja e hershme e palëve të interesuara u evidentua si një faktor kryesor për hartimin e formatit optimal për suksesin e procesit në këndvështrimin e maksimizimit të vlerës financiare të spektrit, nxitjes së konkurrencës, dhe ofrimit të një game të gjerë teknologjish inovative.

Sa i përket çështjes së sigurisë së rrjeteve, drejtuesit e Zyrës së Çështjeve Ndërkombëtare të FCC, Ethan Lucarelli, Shefi i Zyrës, dhe Jared Carlson, Zëvendës shefi i kësaj Zyre, vlerësuan dhe përgëzuan hapat e ndërmarrë nga Republika e Shqipërisë dhe nga AKEP në këtë front.

Kolegët e FCC prezantuan qasjen e adoptuar nga shteti amerikan në këtë çështje sensitive dhe shtjelluan modalitetet, kriteret, dhe pasojat e përfshirjes së një furnitori pajisjesh të rrjeteve të komunikimeve elektronike në “listën e mbuluar”. Përveç sigurisë së pajisjeve, u vu në dukje se FCC është ligjërish e ngarkuar të refuzojë ose revokojë licencën e operatorëve të vlerësuar si kërcënim për sigurinë kombëtare.



AKEP i njohu kolegët e FCC me zhvillimet ligjore në vendin tonë sa i përket transpozimit të Kodit Europian të Komunikimeve Elektronike (EECC) dhe Direktivës mbi Sigurinë e Rrjeteve dhe të Informacionit (NIS 2) si dy instrumente kyçe për operacionalizimin dhe bashkërendimin institucional në lëndën e sigurisë së rrjeteve, një prioritet i vendit tonë.



*Përfaqësues të AKEP gjatë takimit zyrtar me Komisionin Federal të Komunikimeve FCC,  
Uashington DC, korrik 2023  
(Burimi: AKEP)*

## 4. Përfshirja e AKEP-it në punën dhe veprimtaritë e forumeve rregullatore shumëpalëshe

### 4.1. Roli i AKEP-it në mbledhjen e të dhënave për roaming-un rajonal në BEREC

Gjatë vitit 2022, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) ka marrë një rol thelbësor si “Drafting Leader” në Grupin e Punës të BEREC për hartimin e raportit “WB Benchmark Data Roaming”.

Ky raport përgatitet nga BEREC dhe përmbledh të dhëna të dërguara nga Autoritetet Rregullatore të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Ndryshe nga praktika e mëparshme të raportimit të të dhënave në bazë 6 mujore, ky raport i ri përmbledh dhe prezanton të dhëna për një periudhë të gjatë prej 4 tremujorësh, duke e bërë atë një dokument vjetor. Ky është një ndryshim në metodologjinë e raportimit dhe do të vazhdojë të jetë i tillë edhe në të ardhmen.

Me rolin e rëndësishëm si Drafting Leader në hartimin e këtij raporti, AKEP ka pasur një ndikim pozitiv në përmirësimin e punës së Grupit të Punës përgjegjës për *Roaming* në BEREC.

Nisur nga puna intensive dhe profesionalizmi i shfaqur nga AKEP, gjatë përpunimit të të dhënave për raportet e mëparshme dhe ato aktuale, Grupi i Punës ka pranuar propozimet e bëra nga “Drafting Leader” për korrigjimin e disa të dhënave dhe përmirësimin e mënyrës së raportimit nga Autoritetet Rregullatore të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Këto ndryshime dhe përmirësime janë reflektuar në raportet e BEREC, duke treguar një ndërveprim konstruktiv.

Aktualisht, po punohet intensivisht për hartimin e Raportit të radhës, i cili, siç u përmend më lart, do të jetë vjetor. Për të garantuar saktësinë dhe cilësinë e të dhënave, AKEP po angazhohet në një proces të kujdesshëm përpunimi, duke përfshirë korrigjime dhe përmirësime në procedurat dhe mënyrën e raportimit.

Si rezultat i përpjekjeve dhe punës intensive të kryera në këtë periudhë, është kënaqësi që të konstatojmë se BEREC dhe Grupi i Punës për Raportin *Roaming* kanë tashmë në përdorim Raportin e ripërpunuar nga “Drafting Leader” pjesë e AKEP. Ky model i ri i ripërpunuar përmban të gjithë periudhën e raportimit nga viti 2019, kur për herë të parë është zbatuar tarifa *Roaming Like at Home Plus (RLAH+)*, deri aktualisht.

Raporti i hartuar përmban një vëllim të madh të të dhënave, dhe përpunimi i tij për 6 vendet e Ballkanit Perëndimor ka qenë një detyrë vërtetë sfiduese. Megjithatë, kënaqësia jonë është shumë e madhe kur vërejmë se ky version i ripërpunuar tashmë është në përdorim nga ekspertët e BEREC.

#### **4.2. Pjesëmarrja në Asamblenë e përgjithshme të Radiokomunikimit (ITU)**

Konferencat Botërore të Radiokomunikacionit (WRC) mbahen çdo tre deri në katër vite, për të rishikuar dhe, nëse është e nevojshme, për të korrigjuar Rregulloret e Radios, traktatin ndërkombëtar që rregullon përdorimin e spektrit të radiofrekuencave dhe orbitat gjeostacionare-satelite dhe jogjeostacionare-satelite. Rishikimet bëhen në bazë të një agjende të përcaktuar nga Këshilli ITU, i cili merr parasysh rekomandimet e bëra nga konferencat e mëparshme botërore të radiokomunikacionit. Fusha e përgjithshme e agjendës së konferencave botërore të radiokomunikacionit përcaktohet katër deri në gjashtë vjet përpara, me agjendën përfundimtare të vendosur nga Këshilli i ITU-së dy vjet përpara konferencës, me pëlqimin e shumicës së Shteteve Anëtare.

Konferenca Botërore e Radiokomunikacionit ITU 2023 (WRC-23) u mbajt nga 20 nëntori deri më 15 dhjetor 2023. WRC '23 u organizua nga Emiratet e Bashkuara Arabe, e përfaqësuar nga Autoriteti Rregullator i Qeverisjes Digjitale dhe Telekomunikacionit (TDRA) dhe u zhvillua në Qendrën Botërore të Tregtisë, Dubai, Emiratet e Bashkuara Arabe.

Gjatë konferencës, përfaqësuesit e AKEP-it ndoqën seancat plenare të ITU që kishin të bëjnë me rregullimet që prekin zonën që Shqipëria bën pjesë. Gjithashtu, u ndoq në mënyrë aktive puna e CEPT duke marrë pjesë në takimet që kishin të bëjnë me propozimet për ndryshime që preknin Bashkimin Europian.



*Konferenca Botërore e Radiokomunikacionit ITU 2023 (WRC-23), zhvilluar në Dubai, Emiratet e Bashkuara Arabe, dhjetor 2023  
(Burimi: AKEP)*

### **4.3 Pjesëmarrje në veprimtari të tjera**

#### **Angazhimi dhe pjesëmarrja në grupet e punës për përafrimin e legjislacionit postar në vendet e CEFTA**

Në vijim të punës së vazhdueshme mbi përafrimin e legjislacionit kombëtar me legjislacionin europian, gjatë vitit 2023 një vëmendje e veçantë i është kushtuar zhvillimeve dhe ecurisë së tregut të ofrimit të shërbimeve postare.

Gjatë vitit 2023 AKEP ka marrë pjesë aktive në aktivitetet dhe takimet e punës të organizuara nga CEFTA, në funksion të harmonizimit të legjislacionit të vendeve të CEFTA me legjislacionin e BE-së në fushën e shërbimit të dorëzimit të pakove postare ndërkufitare me qëllim promovimin e bashkëpunimit rajonal për nxitjen e tregtisë elektronike nëpërmjet lehtësimit të barrierave për ofrimin e shërbimeve postare ndërkufitare, si edhe rritjen e transparencës mbi tarifrat që aplikojnë ofruesit e shërbimeve postare ndërkufitare.

Gjatë këtyre takimeve është evidentuar dhe vlerësuar mjaft pozitivisht puna që AKEP ka kryer gjatë viteve 2021 – 2023, ku në përputhje me përcaktimet Udhëzimi të MIE nr.5, datë 25.6.2021, “Për miratimin e rregullave mbi shërbimet e dërgesave të pakove postare ndërkufitare”, ka evidentuar subjektet postare që ofrojnë shërbime të shpërndarjes së pakove postare ndërkufitare dhe ka publikuar në një seksion të veçantë në faqen e internetit tarifrat që këto operatorë ofrojnë për shpërndarjen e këtyre pakove.

Nëpërmjet zbatimit të kësaj pjese të legjislacionit, përdoruesit e shërbimeve postare në Shqipëri apo edhe më gjerë aksesojnë informacionin adekuat dhe mund të bëjnë krahasimet dhe zgjedhjen optimale të ofruesit të shërbimeve postare ndërkufitare.

Përgjatë datave 6 - 7 dhjetor 2023, në kuadër të “CEFTA Week 2023” zhvilluar në Podgoricë të Malit të Zi, u zhvilluan takime me përfaqësuesit e vendeve të CEFTA, ku në një sesion të veçantë u trajtuan angazhimet dhe zhvillimet e ndërmarra nga vendet e rajonit për nxitjen e *e-commerce* ku një rol mjaft të rëndësishëm luajnë edhe ofruesit e shërbimeve postare.



---

## CEFTA WEEK 2023 – Podgoricë, dhjetor 2023

Pjesë e Panelit ishte edhe përfaqësuesi i AKEP ku prezantoi në mënyrë të detajuar para të pranishmëve hapat konkretë të ndërmarra nga institucionet shqiptare MIE dhe AKEP mbi transpozimin e legjislacionit të BE-së në këtë fushë, si edhe zbatimin konkret nga autoriteti rregullator në Shqipëri, ku vend të veçantë zënë masat e marra për vlerësimin dhe publikimin e tarifave të pakove postare ndërkufitare në harmoni edhe me parashikimet e rregullores së BE 644/2018.

### **Angazhimi dhe pjesëmarrja në grupet e punës për zbatimin e marrëveshjeve të roaming në vendet e BP dhe BE**

Reduktimi i tarifave për ofrimin e shërbimeve të komunikimit mobile për qytetarët shqiptarë që udhëtojnë në vendet e rajonit dhe më gjerë në BE, ka qenë në fokus të qeverisë shqiptare gjatë këtyre viteve.

Në kuadër të këtij procesi, duke filluar nga data 1 korrik 2021 qytetarët shqiptarë që udhëtojnë në vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor komunikojnë me tarifa njësoj si brenda vendit.

Edhe përgjatë vitit 2023 në bashkëpunim me vendet e rajonit, strukturat e Komisionit Europian nën koordinimin e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC), kanë vijuar punën për reduktimin deri në heqje edhe për tarifën e shërbimeve *roaming* midis vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe atyre të Bashkimit Europian, proces i cili është konkretizuar me nënshkrimin e deklaratës së përbashkët të nënshkruar nga disa operatorë të vendeve të BE dhe BP.

Në përputhje me parashikimet e kësaj deklarate, duke filluar nga data 1 tetor 2023 pajtimtarët e këtyre rrjeteve përfitojnë tarifa më të ulëta për marrjen e shërbimit të internetit gjatë *roaming* në këto rrjete mobile.

Roli i AKEP-it dhe MIE-s në funksion të implementimit me sukses të kësaj iniciative është konkretizuar me pjesëmarrjen në grupet e punës të koordinuara nga RCC, në fokus të të cilave qëndron krijimi i kushteve sa më të favorshme për nxitjen e konkurrencës dhe eficiencës në fushën e ofrimit të shërbimeve *broadband* në rajon dhe më gjerë.

### **Forumi Rregullator Rajonal për Europën**

Në muajin shtator 2023, në Budva, Mali i Zi, Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit

(ITU), në bashkëpunim me Agjencinë për Komunikime Elektronike dhe Shërbime Postare të Malit të Zi (EKIP) mbajtën “Forumin Rregullator Rajonal për Europën 2023”.



*Pamje gjatë nënshkrimit të marrëveshjes teknike për koordinim kufitar në brezin e frekuencave 3400-3800 MHz midis autoriteteve të Shqipërisë, Bosnje Hercegovinës, Kroacisë, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë, gjatë Forumit Rregullator Rajonal për Evropën 2023 ITU-EKIP, mbajtur në Budva, shtator 2023  
(Burimi: AKEP)*

Forumi i këtij viti kishte në qendër “Lidhjen universale në Europë: Gjendja aktuale dhe perspektivat e së ardhmes”. Forumi u ndërtua mbi rezultatet e “Simpoziumit Global për Rregullatorët 2023” dhe udhëzimeve të tij më të mira e praktike.





*Pamje gjatë fjalës së Kryetarit të AKEP në Forumin Rregullator Rajonal për Evropën 2023 ITU-EKIP, në Budva, shtator 2023  
(Burimi: AKEP)*

Eventi u mbajt në kuadrin e Iniciativës Rajonale të ITU për Europën mbi Zhvillimin e Infrastrukturës Digjitale, e cila synon të lehtësojë arritjen e lidhjes Gigabit përmes zhvillimit të infrastrukturës elastike dhe sinergjike dhe një mjedisi mundësues që siguron mbulim të kudondodhur.

Ai ofroi një mundësi unike për dialog të nivelit të lartë midis palëve të interesuara mbi strategjitë dhe politikat e drejtuara drejt zhvillimit të brezit të gjerë në rajon, ndërsa diskutoi sfidat dhe mundësitë e ofruara nga rrjetet elastike me shpejtësi të lartë, shoqëruar me veprime rregullatore fleksibël dhe bashkëpunues.

Anëtari i Këshillit Drejtues të AKEP-it, Z. Armer Juka, mbajti një prezantim, që u prit me mjaft interes, mbi temën “Sfidat e rregullimit në një treg me dy lojtarë: promovimi i konkurrencës dhe i hyrjes në treg në një situatë post merger” (The challenges of regulation in a two-players market: Promoting competition and market entry in a post-merger situation).



*Pamje gjatë prezantimit të Anëtarit të Këshillit Drejtues të AKEP gjatë Forumit Rregullator Rajonal për Evropën 2023 ITU-EKIP, mbajtur në Budva, shtator 2023  
(Burimi: AKEP)*

## **Simpoziumi Botëror i Rregullatorëve 2023 “Rregullorë për një të ardhme digjitale të qëndrueshme”**

Në periudhën 5 - 8 qershor 2023, në Sharm EL-Sheik të Egjiptit u zhvillua Simpoziumi Botëror i Rregullatorëve 2023 (*Global Symposium for Regulators 2023*), me temë “Rregullorja për një të ardhme digjitale të qëndrueshme”, me sesione tematike që sjellin së bashku rregullatorët, politikëbërësit dhe aktorë të tjerë digjitalë nga e gjithë bota dhe duke ofruar një platformë globale për shkëmbimin e njohurive.





*Simpoziumi Botëror i Rregullatorëve 2023 “Rregullorë për një të ardhme digjitale të qëndrueshme”, Sharm EL-Sheik, Egjipt, qershor 2023  
(Burimi: AKEP)*

Përgjatë ditëve të Simpoziumit u diskutuan tema të ndryshme, që kishin të bënin me:

- Sfidat dhe mundësitë kryesore rregullatore të kësaj dekade, që ndikojnë në mënyrën se si industria operon në lidhje me spektrin, të dhënat ndërkufitare, apo instrumente të reja rregullatore.
- Shqyrtimi i politikave dhe inovacionet rregullatore, me fokus në strukturat e reja të qeverisjes, politikat dhe kornizat rregullatore dhe mekanizmat financuese, për të nxitur procesin e transformimit digjital, investimet dhe adoptimin e shërbimeve digjitale për një shoqëri digjitale gjithëpërfshirëse.
- Ndikimi i zhvillimit të shpejtë të teknologjisë, ndryshimin e sjelljeve të konsumatorëve dhe realitetet e reja të tregut mbi nevojat e spektrit dhe opsionet e menaxhimit të spektrit, zhvillimi i teknologjive *wireless* (tokësore, satelitore dhe HAPS/HIBS) dhe shërbimet tradicionale: si të balancohen nevojat e spektrit, inovacioni dhe konkurrenca, përdorimi efikas i spektrit në industri dhe shërbime, roli i rregullatorit dhe bashkëpunimi me sektorë publikë dhe privatë.
- Politikat e aksesueshmërisë digjitale dhe masat rregullatore, që së bashku me strategjitë dhe qasjet e duhura teknike kërkohen për të siguruar që të gjithë përdoruesit, pavarësisht nga mosha, gjinia, aftësia për të përdorur teknologjinë mund të kenë akses dhe të përdorin informacionin, produktet dhe shërbimet digjitale.

- Objektivi i ri i OKB-së për të siguruar që gjatë 5 viteve të ardhshme çdo person në botë të mbulohet nga një sistem paralajmërimi i hershëm, që do të shpërndahet përmes rrjeteve digjitale, duke përfshirë rrjetet celulare, për të dhënë mesazhe alarmuese për ata që janë në rrezik, për të zbutur ndikimet dhe për të shpëtuar jetë.

## **Seminari i Sigurisë 5G dhe Diversitetit të Furnizuesve**

CLDP në bashkëpunim me Byronë e Politikave Kibernetike dhe Digjitale dhe Ambasadën e SHBA-së në Varshavë, mbledhi përgjatë muajit qershor 2023, palët e interesuara të qeverisë dhe sektorit privat nga 17 vende për të diskutuar çështje që lidhen me sigurimin e ekosistemeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK). Seminari u fokusua kryesisht në çështjet e sigurisë 5G, Open RAN dhe çështjet e diversitetit të shitësve dhe u përpoq të inkurajonte miratimin dhe zbatimin e legjislacionit që vlerëson rrezikun e sigurisë së shitësve në vendosjen e rrjeteve të gjeneratës së ardhshme.

Gjatë këtij seminari u ndanë informacione mbi qasjet e rregullatorit të SHBA ndaj sigurisë 5G dhe dobësitë e përdorimit të vetëm rrjeteve të komunikimit pikë-pikë. Dolën në pah gjithashtu përditësimet që FCC ka ndërmarrë që nga viti 2022 në lidhje me sigurinë 5G.

Diskutimi u përqendrua në gamën e plotë të mënyrave të ankandit/alokimit 5G, duke përfshirë çështjet para dhe pas ankandit. Konsideratat kryesore ishin sfida ligjore për përjashtimin e furnizuesve të caktuar, ligjet e sigurisë të zinxhirit të furnizimit dhe publikimi i listave të furnizuesve të besuar ose të pabesueshëm.

Përfaqësuesit e vendeve u ftuan të ndajnë përvojën e tyre në zbatimin dhe/ose sfidat e zbatimit të 5G Security Toolbox të BE-së. Ky diskutim u ndihmua në demonstrimin e mësimave të nxjerra dhe përparimit lidhur me zbatimin e 5G Security Toolbox të BE-së.

Gjithashtu, gjatë seminarit u adresuan implikimet e sigurisë dhe kostos së gamës së gjerë të përdorimit të furnitorëve të pabesueshëm, me diskutime mbi rritjen e furnitorëve të pabesueshëm, si të verifikohet për sigurinë, si të shikohet precedenti ekzistues për sigurinë konsideratat në vendosjen e 5G dhe implikimet e sigurisë kombëtare të përdorimit furnitorë të pabesueshëm. Gjithashtu u preken edhe përfitimet nga implementimi i Open RAN.



*Pamje gjatë fjalës së Anëtarit të Këshillit Drejtues të AKEP në Konferencën Ndërkombëtare të Rregullatorëve në Ohër, maj 2023  
(Burimi: AEK)*



## 5 Takim me strukturat e Komisionit European në kuadër të procesit të ‘screening’

Përgjatë vitit 2023 Shqipëria realizoi me sukses një proces shumë të rëndësishëm për sa i përket aspiratave për integrim në Bashkimin European, ku strukturat e qeverisjes qendrore patën nderin dhe mundësinë që në kuadër të *screening*, nëpërmjet takimeve dypalëshe të paraqisnin fotografinë e plotë të hapave të ndërmarra nga shteti shqiptar për harmonizimin e legjislacionit kombëtar me *Acquis communautaire*, si edhe masat e ndërmarra për implementimin e tij në praktikë. Në kuadër të këtij procesi, AKEP ka ofruar bashkëpunimin dhe ka dhënë kontributin e tij në një sërë kapitujsh që lidhen me veprimtarinë në fushën e ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe atyre postare.

Më konkretisht, skuadrat e AKEP kanë përgatitur dhe prezantuar në strukturat e Komisionit European informacion për kapitujt si më poshtë vijon:

- I. Nën drejtimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Anëtarët e Kapitullit 3, “E drejta e vendosjes dhe liria e ofrimit të shërbimeve”, në takimin bilateral të zhvilluar përgjatë datave 17-18 Janar 2023 prezantuan pranë strukturave të Komisionit European raportimin lidhur me harmonizimin e legjislacionit kombëtar shqiptar me legjislacionin e BE-së, si dhe nivelin e implementimit të tyre. Në kuadër të raportimit për këtë Kapitull, AKEP dhe MIE (si institucione përgjegjës për Shërbimet Postare), kanë bashkërenduar përgatitjet e përgjigjeve të pyetjeve të ardhura nga KE, dhe në përputhje me parashikimet e agjendës së takimit janë përgatitur prezantimet e përbashkëta mbi dy temat që lidhen me sektorin e ofrimit të shërbimeve postare, konkretisht:
  - Përafrimi i bazës ligjore dhe rregullatore në tregun e shërbimeve postare me *acquis* e BE-së;
  - Ofrimi i shërbimeve të shpërndarjes së pakove postare ndërkufitare.

Raportimi për harmonizimin e legjislacionit për ofrimin e shërbimeve postare u fokusua në dy nivele, *së pari* transpozimi i legjislacionit nga politikëbërësi dhe, *së dyti* aplikimi i këtij legjislacioni në praktikë në funksion të përmbushjes së objektivave për mbikëqyrjen dhe rregullimin e tregut të shërbimeve postare.

Për sa i përket përafrimit të legjislacionit të shërbimeve postare, u theksua se ligji për shërbimet postare 46/2015 është i përafuar me Direktivat e EU për Shërbimet Postare konkretisht Direktiva 97/67/EC, Direktiva 2002/39/EC dhe Direktiva 2008/6/EC. Gjithashtu, gjatë vitit 2021 është bërë përafrimi edhe

---

me rregulloren e BE 644/2018 për shërbimet e pakove postare ndërkufitare. AKEP në këtë takim prezantoi hapat e ndërmarra për zbatimin e bazës rregullatore në funksion të nxitjes së konkurrencës dhe rritjen e cilësisë së ofrimit të shërbimeve postare, si edhe mbikëqyrjes së vazhdueshme të këtij tregu.

Përfaqësuesit e delegacionit të KE-së, një vëmendje e veçantë i kushtuan prezantimit lidhur me transpozimin e legjislacionit për ofrimin e shërbimeve të shpërndarjes së pakove postare ndërkufitare, ku përgëzuan palën shqiptare mbi hapat konkretë që ka ndërmarrë në transpozimin e rregullores së BE (*Regulation (EU) 2018/644*) për shpërndarjen e pakove postare ndërkufitare, duke qenë ndër vendet e para në rajon në këtë aspekt.

Në raportin final të Komisionit Europian të përgatitur për Shqipërinë “*Albanian 2023 Report*” të datës 8.11.2023 pasqyrohet se legjislacioni kombëtar është plotësisht i përafuar me *acquis* të BE-së për ofrimin e shërbimeve postare. Shqipëria është plotësisht e përafuar me Direktivën Europiane për Shërbimet Postare që në vitin 2017, periudhë në të cilën është hequr zona rezervuar dhe tregu është hapur plotësisht për konkurrencë, gjithashtu hap mjaft pozitiv vlerësohet transpozimi në vitin 2021 i rregullores së BE-së për shpërndarjen e pakove postare ndërkufitare.

- II. Takimit Bilateral për Kapitullin 8 «Politika e Konkurrencës» u mbajt në Bruksel në datat 6 - 8 mars 2023, udhëheqës i këtij kapitulli është Autoriteti i Konkurrencës. Ky takim kishte për qëllim raportimin lidhur me harmonizimin e legjislacionit kombëtar shqiptar me Legjislacionin e BE-së, si dhe nivelin e implementimit të tij në nxitjen e konkurrueshmërisë në treg.

Skuadrat e AKEP dhe MIE (institucione përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregjeve të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare), kanë bashkërenduar punën në përputhje me parashikimet e agjendës së takimit dhe kanë përgatitur prezantimet e përbashkëta mbi dy temat që lidhen me sektorin e ofrimit të shërbimeve postare dhe atë të komunikimeve elektronike në Shqipëri, konkretisht:

- Përafrimi i bazës ligjore dhe rregullatore të aspekteve të konkurrencës në tregun e shërbimeve postare me *acquis* e BE-së;
- Përafrimi i bazës ligjore dhe rregullatore të aspekteve të konkurrencës në tregun e shërbimeve të komunikimeve elektronike me *acquis* e BE-së.

Gjatë këtyre prezantimeve u theksua se jo vetëm përafrimi dhe përmirësimi i legjislacionit është mjaft i rëndësishëm, por akoma më i rëndësishëm është zbatimi dhe krijimi i strukturave adekuate dhe buxhetet e nevojshme për implementimin e këtij legjislacioni në praktikë.

Nga skuadra e AKEP u prezantuan hapat e ndërmarra për harmonizimin e bazës ligjore rregullatore për secilin nga sektorët e komunikimeve elektronike

dhe atë postare, si dhe masat e ndërmarra nga institucionet shqiptare për zbatimin në praktikë të këtij legjislacioni me praktikat më të mira të aplikuara në vendet e BE-së.

Për sa i përket përafrimit të legjislacionit të shërbimeve postare, u theksua se ligji për shërbimet postare 46/2015 është i përafuar me Direktivat e EU për Shërbimet Postare, konkretisht Direktiva 97/67/EC, Direktiva 2002/39/EC dhe Direktiva 2008/6/EC. Gjithashtu, gjatë vitit 2021-2022 është bërë përafrimi edhe me rregulloren e BE 644/2018 për shërbimet e pakove postare ndërkufitare.

Edhe për sa i përket legjislacionit në fushën e komunikimeve elektronike, Shqipëria me ndryshimet e fundit të bëra në vitin 2018 ka përafuar legjislacionin me Direktivat e vitit 2002 dhe 2009, si edhe ndryshimet e bëra nga BE për metodologjinë e përcaktimit të tregjeve përkatëse në sektorin e komunikimeve elektronike. Në vijim, u citua se Shqipëria është në procesin final të transpozimit të Kodit të Komunikimeve Elektronike Europiane në legjislacionin vendas, të cilat pritet të bëhen efektive brenda vitit 2023.

Për të dy sektorët, komunikimet elektronike dhe atë të shërbimeve postare u theksua se tregjet janë plotësisht të hapura ndaj konkurrencës në përputhje me praktikat e ndjekura nga vendet e BE-së.

III. Një takim mjaft i rëndësishëm ishte takimi Bilateral për Kapitullin 10 “Shoqëria e Informacionit dhe Media” i cili u zhvillua në datat 27-28 mars 2023, në Bruksel. Puna përgatitore për Kapitullin 10 u koordinua dhe bashkëdrejtua nga Ministria për Infrastrukturën dhe Energjinë, dhe Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit, Kapitull i cili kishte në epiqendër *acquis* e reja të ndara në tre shtylla kryesore:

- *Politika e komunikimeve elektronike dhe kuadri rregullator*, ku u prezantuan masat e ndërmarra mbi përafrimin me *acquis* veçanërisht kodin e Komunikimeve Elektronike Europiane, shërbimet *roaming*, politikat e spektrit, shoqëria gigabit, 5G dhe siguria kibernetike, Inteligjenca Artificiale, Programi Dekadës për Politikën Digjitale 2030, etj.;
- *Transformimi Digjital*, ku u prezantuan zhvillimet dhe arritjet e Shqipërisë në ofrimin e shërbimeve *online*, planet për përmirësimin e aftësive digjitale, Internet Governance, iniciativën Europiane për shërbimet *Cloud*, sigurinë e të dhënave dhe mbrojtjen e privatësisë së këtyre të dhënave, etj.
- *Politika e Medias Audiovizuale*, ku u prezantua mbi rregullimin e shërbimeve audio-vizuale, ofruesit e shërbimeve, pavarësinë e medias, etj.;

AKEP dhe MIE, kanë bashkërenduar punën në përputhje me parashikimet e agjendës së takimit dhe kanë përgatitur prezantimet e përbashkëta mbi temat që lidhen me sektorin e komunikimeve elektronike në Shqipëri.



Pamje nga diskutimet mbi procesin e *screening* Kapitulli 10, mars 2023

Skuadra e AKEP prezantoi një panoramë të gjerë të hapave të ndërmarra nga AKEP për krijimin e kushteve të nevojshme për implementimin me sukses së politikës së *roaming* në Ballkanin Perëndimor në përputhje me praktikën e ndjekur në vendete BE-së RLAH (*Roam Like At Home*), falë së cilës qytetarët e Ballkanit Perëndimor, që nga data 1 korrik 2021, komunikojnë njësoj si në shtëpi gjatë udhëtimit të tyre në këtë rajon. Gjithashtu, vëmendje pati paraqitja e masave të ndërmarra për avancimin e këtij procesi edhe me vendet e BE-së, proces i cili ka dhënë rezultatet e para duke filluar që nga data 1 tetor 2023, ku të gjithë pajtimtarët e operatorëve nënshkrues të deklaratës së përbashkët për *roaming* BE - BP, flasin me tarifa të reduktuara gjatë udhëtimit dhe qëndrimit të tyre në rrjetin e secilit prej këtyre operatorëve mobile.

Temat me rëndësi të veçantë që u trajtuan nga anëtarët e Kapitullit 10 për politikën elektronike u fokusuan edhe në politikën për menaxhimin dhe miradministrimin e spektrit radio, qeverisjen nëpërmjet internetit, zhvillimet për implementimin e teknologjive 5G, si edhe masat për rritjen e sigurisë kibernetike.

# VI. PERFORMANCA E BRENDSHME DHE MIRADMINISTRIMI FINANCIAR

## 1. Mbledhja e të ardhurave vjetore

### 1.1. Performanca në mbledhjen e të ardhurave nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike dhe operatorët e shërbimeve postare

Gjate vitit 2023 janë realizuar të ardhurat nga pagesat e kryera prej sipërmarrësve që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare:

- Pagesa për caktim dhe përdorim të frekuencave;
- Pagesa për numeracion;
- Pagesa për mbikëqyrje tregu;
- Pagesa për koston e shërbimit të portabilitetit;
- Pagesa për domain;
- Komisioni i përfituar si agjent tatimor.

Në zbatim të VKM nr.750, datë 1.12.2022, AKEP u angazhua në faturimin dhe mbledhjen në kohë të të ardhurave dhe përdorimin e tyre sipas kriterëve të përcaktuar për këtë qëllim.

Pagesat dhe komisioni i përfituar si agjent tatimor për AKEP gjatë vitit 2023 paraqiten si më poshtë:

- janë faturuar rreth 370.10 milionë lekë, ose rreth 97.00 % e buxhetit;
- janë arkëtuar rreth 365.42 milionë lekë, ose rreth 98.75 % e faturimit.

Krahasuar me një vit me parë, janë faturuar dhe arkëtuar rreth 2 % më pak fonde. Shkak për këtë janë ndryshimet teknologjike të operatorëve, të cilat lidhen me kërkesën në ulje për pajisje me frekuenca të lidhjeve fikse si dhe të pajisjeve të radiokomunikimit të cilat për vitin 2023 janë reduktuar në masën 40% në krahasim me vitin 2022.



## Pagesat për AKEP



- **Pagesat nga mbikëqyrja e tregjeve**

Lidhur me procesin e realizimit të kësaj pagese, faturimet dhe arkëtimet janë:

- ✓ 169 milionë lekë faturuar nga mbikëqyrja e tregut të komunikimeve elektronike dhe arkëtuar 163.03 milionë lekë.
- ✓ 9.5 milionë lekë nga pagesa e mbikëqyrjes për tregun postar dhe arkëtuar 9.44 milionë lekë.

Gjatë vitit 2023, bazuar në deklaratimet e pasqyrave financiare të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike, tregu i komunikimeve elektronike ka pësuar një rritje në masën 104% në krahasim me vitin 2022.

- **Pagesat nga përdorimi i spektrit të frekuencave**

Gjatë vitit 2023 janë:

- ✓ faturuar rreth 111.7 milionë lekë nga caktimi dhe përdorimi i frekuencave dhe arkëtuar rreth 111.6 milionë lekë;

Referuar sa më lart, janë faturuar rreth 89% e pagesave për frekuenca dhe nga këto faturime janë arkëtuar rreth 99.9 %.

Ky zë i pagesave për shkak të ndryshimeve teknologjike si dhe rrethanave të reja sektoriale të ndodhura gjatë 2023 ka pësuar rënie të konsiderueshme, të cilat do të reflektohen dhe në vitet në vijim.

- **Pagesat për numeracion**

- ✓ Janë faturuar rreth 26.3 milionë lekë nga caktimi dhe përdorimi i numeracionit dhe arkëtuar rreth 26.3 milionë lekë.

Në lidhje me pagesat për numeracion janë arkëtuar rreth 100 %.

- **Pagesat për koston e shërbimit të portabilitetit**
  - ✓ Gjatë vitit 2023 janë faturuar rreth 19.4 milionë lekë nga pagesat për koston e shërbimit të portabilitetit dhe janë arkëtuar rreth 19.4 milionë lekë, 100% e vlerës së programuar.

- **Pagesa për Domain dhe të tjera**

Nga pagesat për Domain janë faturuar rreth 10.1 milionë lekë dhe janë arkëtuar 9.96 milionë lekë ose 98.6%.

- **Komision si agjent tatimor**

Në programin e vitit 2023 ky zë u parashikua të ishte rreth 24.5 milionë lekë.

Nisur nga kërkesa e sipërmarrësve për breza të ndryshëm frekuencash dhe brezat që kanë në përdorim, janë faturuar rreth 479.72 milionë lekë nga tarifat për përdorimin e spektrit të frekuencave.

Nga këto faturime, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë janë derdhur rreth 455.74 milionë lekë.

Si rezultat i faturimit, arkëtimit dhe derdhjes në Buxhetin e Shtetit të këtyre tarifave, janë arkëtuar në AKEP nga komisioni si agjent rreth 23.98 milionë lekë, ose rreth 97.87% e programit.

### ***1.2. Problematikat e të ardhurave të prapambetura dhe procedurat gjyqësore përkatëse***

Gjate vitit 2023 AKEP ka llogaritur dhe dërguar faturat fiskale për vjeljen e detyrimeve të pagesave për AKEP për sipërmarrësit e komunikimeve elektronike dhe postare, si dhe gjatë gjithë vitit ka ndjekur shlyerjen e detyrimeve nën një monitorim të vazhdueshëm nga strukturat përgjegjëse të AKEP. Kështu, në përfundim të vitit 2023 nga 1275 faturime në vlerën e 370.10 milionë lekë, rezultuan të pashlyera detyrimet e 5 subjekteve sipërmarrëse në masën 1.6% të totalit të faturimeve si më poshtë:

---

Bazuar në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, veprimtaria e AKEP është e orientuar ngushtësisht me zbatimin e përcaktimeve ligjore, sa i përket detyrimit të të tretëve për kryerjen në kohë të pagesave përkundër përdorimit të frekuencave, *domain*-eve, serive numerike në përdorim prej tyre, etj., ndërkohë që në vazhdimësi inician procese gjyqësore, dhe angazhon procedura përmbartimore për arkëtimin e debive.

Nëpërmjet dokumentacionit përkatës sa i përket debitorëve të cilët nuk kanë përmbushur sa më sipër, AKEP ka iniciuar proceset gjyqësore brenda afateve ligjore të parashkrimit.

Gjatë vitit 2023, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike është investuar si palë ndërgjyqëse, në:

- Cilësinë e palës së paditur, në 3 procese gjyqësore;
- Cilësinë e palës paditëse, në 5 procese gjyqësore;
- Cilësinë e personit të tretë, në 2 procese gjyqësore.

Gjithashtu, janë pranuar 4 kërkesë padi, në proces gjykimi janë 5 procese gjyqësore, janë rrëzuar 4 kërkesë padi, ndërkohë që është pushuar 1 proces gjykimi.

## 2. Zbatimi i buxhetit në rrethana të reja sektoriale dhe ndërsektoriale

AKEP, në zbatim të VKM nr.750, datë 1.12.2022, “Për miratimin e buxhetit për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare për vitin 2023”, administroi dhe menaxhoi fondet publike për vitin 2023, në një fond shpenzimesh prej 381.5 milionë lekë.

Zbatimi i buxhetit gjatë vitit u ndikua nga disa zhvillime të rëndësishme objektive në tregun e komunikimeve elektronike që konsistojnë në impaktin e zhvillimeve teknologjike në sektorin e Telekomunikacionit, si dhe nga zbatimi i akteve ligjore dhe nënligjore që përcaktojnë masën dhe kriteret e rregullimeve që u bënë në sistemin e pagave, shpërblimeve dhe shtesave mbi pagë për punonjësit e administratës shtetërore. Rrethanat e reja që impaktuan zbatimin e buxhetit do t’i rendisim në vijim.

### **2.1. Rënia e të ardhurave për shkak të zhvillimeve teknologjike në sektorin e Telekomunikacioneve**

Në zbatim të procedurave ligjore dhe pas autorizimit nga Autoriteti i Konkurrencës, në fund të vitit 2022, përfundoi bashkimi me përthithje midis One Telecommunication sh.a., dhe Altelecom sh.a., duke bërë që nga janari 2023, në tregun e shërbimeve celulare të mbeten 2 operatorë: Vodafone Albania sh.a., dhe One Albania sh.a.

Bashkimi ligjor me përthithje solli edhe bashkimin fizik të rrjeteve të këtyre sipërmarrësve. Shoqëria e re e krijuar, tashmë dispononte rrjet fikse të fibrave optike në të gjitha bashkitë e vendit dhe disa nga rrugët kryesore kombëtare, por edhe një rrjet mobil duke sjelle dublime pajisjesh me radiofrekuenca veçanërisht në lidhjet fikse pikë-pikë, në shumë zona, të cilat shërbejnë për të dërguar sinjal dhe shërbime nga një pikë në një pikë tjetër, të rrjetit celular, në distanca të ndryshme.

Sipërmarrësit One Albania sh.a., dhe Vodafone Albania sh.a., janë pajisur nga AKEP me Autorizime Individuale për përdorimin e frekuenca në disa breza 800 MHz, 900 MHz, 1800 MHz, 2100 MHz dhe 2600 MHz, të cilat përdoren për ndërtimin e rrjeteve celulare për ofrimin e shërbimeve me shpejtësi të larta, të rendeve 2G, 3G, 4G. Për të siguruar këto shpejtësi nga ana teknologjike, është e nevojshme që antenat celulare të lidhen me fibra optike deri në sistemin qendror teknik të operatorit celular. Sipërmarrësi One Albania sh.a., pas bashkimit, përfitoi avantazhet e rrjetit fikse të fibrave optike të ish-Altelecom sh.a.

Sipërmarrësi One Albania sh.a., për të plotësuar domosdoshmërinë teknologjike për furnizimin e antenave celulare me rrjet me fibra optike, por edhe për të shmangur

---

dubliment e frekuencave, ka revokuar (anuluar) në AKEP gjatë vitit 2023 autorizimet individuale të frekuencave për 343 lidhje fikse, deri në fund të vitit 2023.

Po kështu dhe sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a., ka zgjeruar rrjetin e tij fiks të fibrave optike gjatë vitit 2023. Një pjesë e këtyre fibrave përdoren tashme për të zëvendësuar disa nga lidhjet fikse me radiofrekuenca. Në fund të vitit 2023, Vodafone Albania sh.a., ka revokuar (anuluar) 39 lidhje fikse.

Revokimi i lidhjeve fikse, ka pasur një impakt financiar (mungesë) në buxhetin e AKEP të vitit 2023 prej 6.30 milionë lekë.

Revokimi i frekuencave të lidhjeve fikse pikë-pikë, është një proces që pritet të vazhdojë edhe gjatë vitit 2024 e në vijim, si pasojë e zhvillimeve dhe zgjerimeve të rrjeteve me fibra optike të operatorëve, të cilat zëvendësojnë një pjesë të frekuencave të operatorëve celularë në lidhjet fikse pikë-pikë.

## ***2.2. Rishikimet buxhetore gjatë vitit si pasojë e rritjes dhe shtesave të ndryshimit të aketeve nënligjore për nëpunësit e shërbimit civil***

Me hyrjen në fuqi të ndryshimeve ligjore të përcaktuara:

- Ligjin nr. 34/2023, “Për një ndryshim në ligjin nr. 9584, datë 17.7.2006, «Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj», të ndryshuar;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.5.2023, «Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike»;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 326, datë 31.5.2023, «Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike»,

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare si institucion në fushën e veprimit të këtij legjislacioni mori masat e nevojshme për përshtatjen e strukturës së re të pagave nga kategori në klasa, formulën e re të përlogaritjes së vjetërsisë etj., për të gjitha pozicionet e punës në zbatim të strukturës organizative miratuar me Vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 56/2018, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)”.

Gjithashtu pjesë e këtyre ndryshimeve ishte dhe miratimi me Vendim të Këshillit Drejtues i shtesave mbi pagë për pozicionet e punës që ndjekin dhe administrojnë



sistemet informatike në AKEP bazuar në VKM nr. 325, datë 31.5.2023.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 326, datë 31.5.2023, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, u zhvillua procedura e nevojshme me organet kompetente për vlerësimin dhe miratimin e shtesave në pagë për pozicionet mbështetëse që punojnë në kushte të vështira dhe të dëmshme për shëndetin duke kapërcyer kufijtë e lejueshëm të normave të detyrueshme higjieno-sanitare.

Zbatimi i akteve ligjore të mësipërme për të gjithë punonjësit e organikës së AKEP solli një efekt financiar në rritje të zërit për paga në masën e 17.2 milionë lekë, ose 11% mbi fondin e shpenzimeve të miratuara.

Kjo situatë e re financiare kërkonte domosdoshmërisht reflektimin e ndryshimeve dhe një rishpërndarje të zërave të fondit të shpenzimeve, në mënyrë që efektet financiare që mbartën këto ndryshime në zërin paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore, të mos cenonin mbarëvajtjen financiare të veprimtarisë së AKEP për periudhën e mbetur të vitit 2023.

Për këtë qëllim u hartuan dhe u miratuan aktet nënligjore për ndryshimin e VKM nr.750, datë 1.12.2022, “Për miratimin e buxhetit për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare, për vitin 2023”

Efektet financiare në zërin e fondit të pagave u llogaritën duke filluar nga data 1 prill 2023, në zbatim të parashikimeve të pikës 7, kreu IV, të VKM nr.325, datë 31.5.2023.

Nga të gjitha këto ndryshime, zëri i fondit të shpenzimeve për pagat i rishikuar paraqitet si më poshtë:

Nr.	Zërat e fondit të pagave	Fondi i pagave 2023			
		Programi 2023	Ndryshimi i Program 2023	Ndryshimi në vlerë absolute	Në % ndryshimi
1	Shpenzime për paga	103,100,000	117,930,373	14,830,373	-12.6%
2	Shpërblime nga komision si agjent tatimor	14,700,000	14,700,000	-	0.0%
3	Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	15,600,000	18,011,758	2,411,758	-13.4%
	<b>Total</b>	<b>133,400,000</b>	<b>150,642,131</b>	<b>17,242,131</b>	<b>-11%</b>

### 2.3 Realizimi i fondit të shpenzimeve për vitin 2023

AKEP, në zbatim të VKM nr.750, datë 1.12.2022, "Për miratimin e buxhetit për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare, për vitin 2023", administroi dhe menaxhoi fondet publike për vitin 2023, në një fond shpenzimesh prej **381.5 milionë lekë** sipas zërave të mëposhtëm:

• Paga dhe shtesa të tjera	<b>117.800.000 lekë</b>
• Kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore	<b>15,600,000 lekë</b>
• Materiale	<b>6,550,000 lekë</b>
• Shërbime	<b>163,406,000 lekë</b>
• Investime	<b>78,144,000 lekë</b>

Efektet financiare të ndryshimit të pagave filluan nga 1 prill 2023. AKEP u impaktua me një rritje prej 12.6% mbi fondin e shpenzimeve për paga dhe shtesa të tjera, kështu që domosdoshmëria e miratimit të ndryshimeve të buxhetit të realizuar nëpërmjet VKM nr.804, datë 28.12.2023, "Për një ndryshim në VKM nr.750, datë 1.12.2022, "Për miratimin e buxhetit për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare, për vitin 2023"", në një fond shpenzimesh prej 381.5 milionë lekë sipas zërave të mëposhtëm të rishikuar:

Fondi i shpenzimeve i rishikuar

• Paga dhe shtesa të tjera	<b>132.630.000 lekë</b>
• Kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore	<b>18.012.000 lekë</b>
• Materiale	<b>6.550.000 lekë</b>
• Shërbime	<b>148.404.000 lekë</b>
• Investime	<b>75.904.000 lekë</b>

Rishpërndarja e zërave të buxhetit solli realizimin e mbarëvajtjes së veprimtarisë financiare të AKEP, duke siguruar që pagesat e shpenzimeve administrative të kryheshin në kohë.

Gjatë vitit 2023 janë realizuar në total rreth 97% e fondit të shpenzimeve administrative të AKEP, ose rreth 369.2 milionë lekë. Realizimi i fondit të shpenzimeve për vitin 2023 ka pësuar një rritje me 9.2 milionë lekë (10%) në krahasim me vitin 2022 ku fondi i shpenzimeve ishte realizuar në 360 mil. lekë.

Tabela e mëposhtme tregon realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të vitit 2023 kundrejt programit të rishikuar në vlerë absolute dhe në përqindje.

NR	Emërtimi	VITI 2023		Diferenca Program/Fakt	%e realizimit
		Programi	Fakt		
I	<b>Të ardhura nga pagesat gjithsej:</b>	381.5	370.0	11.5	97%
II	<b>Shpenzime gjithsej:</b>	381.5	369.1	12.4	97%
	Shpenzime për paga dhe shtesa të tjera	132.6	125.2	7.4	94%
	Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	18.1	17.2	0.9	95%
	Shpenzime për materiale	6.6	6.5	0.1	99%
	Shpenzime për shërbime	148.4	144.3	4.1	97%
	Shpenzime për Investime	75.9	75.9	0.0	100%
III	<b>Tarifa e shërbimit të radiokomunikacionit</b>				
1	Arketuar tarife radiokomunikacioni		479.7		
2	Derdhur tarife radiokomunikacioni në buxhetin e shtetit		455.7		
3	Te ardhura si agjent tatimor nga arketimi dhe derdhja e tarifës së shërbimit të radiokomunikacionit	24.5	24.0		98%

## i. Pagat

Gjatë vitit 2023 shpenzimet për pagat dhe shtesa janë realizuar në masën 94 % të programit. Në këtë nivel kanë ndikuar vakancat në strukturën e miratuar në program, lëvizjet e stafit si dhe zbatimi i Vendimeve të Këshillit të Ministrave për kufizimin e shpenzimeve për shpërblimet e performancës për administratën.

Nga të gjitha këto ndryshime zëri i fondit të shpenzimeve për pagat ka ndryshuar dhe është realizuar si më poshtë:

Nr	Zerat e fondit të pagave	Fondi pagave 2023					
		Programi 2023	Ndryshimi I Program 2023	Ndryshimi në vlerë absolute	Ne % ndryshimi	Realizimi 2023	Ne % ndryshimi
1	Shpenzime për paga	103,100,000	117,930,373	14,830,373	-12.6%	110,542,270	93.7%
2	Shpërblime nga komisioni si agjent tatimor	14,700,000	14,700,000	-	0.0%	14,700,000	100.0%
3	Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	15,600,000	18,011,758	2,411,758	-13.4%	17,202,700	95.5%
	Total	133,400,000	150,642,131	17,242,131	-11.4%	142,444,970	94.6%

## ii. Sigurime shoqërore

Për të njëjtat arsye edhe niveli i sigurimeve shoqërore ka një realizim në masën 95.5% të programit dhe rezulton me një diferencë mosrealizimi në vlerën rreth 0.9 milionë lekë.

### **iii. Materialet**

Gjatë vitit 2022 shpenzimet për materiale janë realizuar 6.49 milionë lekë, ose në masën 99.2 % të programit.

### **iv. Shërbime**

Zëri i shpenzimeve për shërbime u realizua në shumën 144.3 milionë lekë, ose në masën 97% të programit. Nga shërbimet nuk u arritën të përdoren rreth 4 milionë lekë, kjo ka ardhur si pasojë e vlerës së përlogaritur dhe ofertave të paraqitura gjatë procedurave të prokurimit, si dhe reduktimi i shpenzimeve social-kulturore.

### **v. Investimet**


Duke u bazuar në fondin e miratuar për t'u investuar, zëri i investimeve u realizua me rreth 100%. Si procedura të prokurimit publik, programi fillestar i shpenzimeve për investime u krye 100%. Pra u përdorën rreth 75.9 milionë lekë, nga rreth 78.1 milionë lekë të planifikuar.

Diferencat e krijuara nga ndryshimi i fondit limit me ofertat fituese u përdorën për rialokimet e fondeve për të mbuluar efektin e rritjes së pagave.

Lidhur me zërin e investimeve sqarojmë se:

- Janë kryer të gjitha investimet e programuara për vitin 2023.
- Janë kryer me sukses të gjitha procedurat e prokurimit, duke u lidhur kontrata me operatorët ekonomik fitues.
- Ka pasur miradministrim dhe transparencë në menaxhimin e fondeve, duke kryer rishpërndarje brenda limiteve ligjore.

Gjatë vitit 2023, ka vijuar të zhvillohet infrastruktura e teknologjisë së informacionit si dhe përmirësime të aplikacioneve ekzistuese. AKEP ka aplikuar metodat më bashkëkohore në ndërtimin e sistemeve të informacionit, mbështetur edhe në detyrat e caktuara në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë dhe aktet nënligjore të dala.




### Teprica e të ardhurave

Teprica e të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara në fund të vitit 2023 rezulton në shumën 223,912 lekë, si rezultat i diferencave nga pagesat e sipërmarrësve dhe mosrealizimit/kursimit të disa zërave të miratuar në fondin e shpenzimeve të AKEP.

Në krahasim më një vit më parë, kjo vlerë ka pësuar rënie me rreth 96%, duke evidentuar kështu një tregues pozitiv në menaxhimin e fondeve me efektivitet, pavarësisht sfidave që u shfaqën gjatë kësaj periudhe.

Teprica e të ardhurave të derdhura në buxhet për vitet 2016-2023 paraqitet në grafikon e mëposhtëm:





### **3. Nevoja për një reflektim afatgjatë në shtimin e të ardhurave dhe balancën buxhetore**

Duke pasur parasysh disa prirje afatgjata, pritshmëritë janë që niveli i shpenzimeve vjetore të AKEP-it të mbetet i lartë, ndoshta edhe të pësojë rritje, në një hark kohor afatmesëm. Tre janë faktorët kryesorë që ushtrojnë një presion për lart të shpenzimeve të rregullatorit: Investimet dhe mirëmbajtja e infrastrukturave kritike, rekrutimi dhe mbajtja e burimeve njerëzore cilësore, dhe qiraja e mjediseve.

#### **Identifikimi dhe sigurimi i burimeve financiare për investimet dhe mirëmbajtjen e infrastrukturave kritike**

AKEP-i është një rregullator sektorial i ngjashëm me autoritetet e tjera të pavarura si rregullatori i energjisë (ERE), i mediave audiovizuale (AMA), i ujit (ERRU), i mbikëqyrjes financiare (AMA), por karakterizohet edhe nga një veçori sistematike që konsiston, nga njëra anë, në administrimin dhe operimin e infrastrukturave kritike dhe, nga ana tjetër, në detyra përherë e më sfida të kontrollit dhe monitorimit nga pikëpamja e sigurisë, të rrjeteve të komunikimeve elektronike të operuara prej sipërmarrësve privatë.

Sa i përket pikës së parë, është për t'u shënuar se, përmes VKM nr. 553, datë 15.7.2020, "Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe të listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit", e ndryshuar, AKEP konsiderohet operator i infrastrukturave kritike të mëposhtme:

- i. Sistemi i Menaxhimit CctId.AI;
- ii. Sistemi i Bazës së të Dhënave të Centralizuar të Probabilitetit të Numrit (Crdb);
- iii. Sistemi i menaxhimit të Aplikimeve dhe Raportimeve Online (RevZone);
- iv. Sistemi i menaxhimit/ monitorimit të Frekuencave); dhe
- v. Regjistri Elektronik i Rrjeteve Publike të Komunikimeve Elektronike (Atlas).

Operimi i këtyre infrastrukturave në nivelin e kërkuar të sigurisë kibernetike implikon mbështetje në pajisje hardware, në sisteme teknologjike, në licenca dhe software të avancuara, sikundër pasjen në dispozicion të një stafi ekspertësh të kualifikuar, me përvojë, dhe vazhdimisht të trajnuar.

Në lidhje me pikën e dytë, duhet nënvizuar se aktualisht rrjetet e komunikimeve elektronike nuk cilësohen si infrastruktura kritike. Por medoemos, me transpozimin aktualisht në proces të direktivës për NIS 2, këto rrjete do të përcaktohen në një të ardhme të afërt si infrastruktura kritike. Përkufizimi i rolit dhe i përgjegjësisë të

AKEP-it, sipas kornizës së re ligjore, është ende i pavendosur. Megjithatë, pavarësisht përcaktimit formal apo jo si CIRT (Njësi për reagimin ndaj incidenteve kibernetike) sektorial, në “normalitetin” e ri të kërcënimeve kibernetike të përhershme, pritshmëritë mbi AKEP do vijnë përherë në rritje.

Të dyja këto veprimtari nënkuptojnë një faturë financiare të konsiderueshme, në terma të investimeve kapitale dhe të shpenzimeve korrente. Për shkak të zhvillimeve në tregjet globale, çmimet e pajisjeve teknologjike dhe të licencave të software-it janë në rritje të vijueshme prej disa vitesh.

### **Rekrutimi, mbajtja, dhe zhvillimi i burimeve njerëzore cilësore**

Nevoja e menjëhershme për profesionistë të teknologjisë së informacionit u shtjellua shkurtimisht më sipër. Duhet theksuar se AKEP ka gjithashtu të domosdoshme të mbështetet mbi profesionistë cilësorë të rregullimit: juristë që njohim imtësisht tregjet dhe konkurrencën, si dhe ekonomistë që zotërojnë ekspertizë në analizën e të dhënave dhe në modelet ekonomike. Në të dy rastet, performanca e tyre optimale kërkon një familjarizim dhe trajnim të vazhdueshëm në fushën e komunikimeve elektronike, me karakteristika të veçanta dhe në shndërrim të vrullshëm ekonomik, teknologjik dhe normativ.

Vetëkuptohet që rekrutimi, mbajtja, dhe zhvillimi i këtyre burimeve njerëzore cilësore, mes të tjerash, përkthehet me një trajtim financiar konkurrues në raport me tregun vendas, por edhe më gjerë.

Rritja e pagave në sektorin publik vitin e kaluar ishte një hap në drejtimin e duhur. Sidoqoftë, për pozicione të veçanta, përmirësimi i trajtimit financiar do të vijojë të mbetet një domosdoshmëri.

### **Qiraja e mjediseve të AKEP**

Një tjetër zë i rëndësishëm në shpenzimet vjetore të AKEP-it është qiraja e zyrave qendrore të institucionit. Për aq kohë sa shteti nuk do të ketë mundësi të gjejë mjedise të përshtatshme, jo larg zonës së Shallvareve (ku ndodhen mjediset e tjera të AKEP-it, në pronësi të tij, të dedikuara funksioneve me natyrë teknike) që t’ia vërë në dispozicion institucionit, ky shpenzime do të vijojë të mbetet domethënës për financat e AKEP-it.

Ndërkaq, të ardhurat e AKEP-it kanë qenë në stanjacion, kryesisht sepse ato janë të varura nga xhiroja vjetore e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike.

---

Në çdo rast, rritja e të ardhurave të AKEP-it është e domosdoshme, përmes mbështetjes buxhetore imtësisht të lidhur me financimin e misionëve kibernetike, ose përmes tarifimit më të lartë ndaj aktorëve të këtij sektori.

### **3.1. Tarifa e mbikëqyrjes së tregut**

Në përputhje me parashikimet e nenit 24, të ligjit 9918/2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimit, janë të detyruar të paguajnë një pagesë vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike nga AKEP-i. Kjo pagesë bëhet për të mbuluar kostot administrative të AKEP-it. Në pikën 2 të nenit 24 është përcaktuar se pagesa vjetore, e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, nuk duhet të jetë më shumë se 0,5% e të ardhurës vjetore të vitit kalendarik të mëparshëm.

Bazuar në të dhënat e mbledhura dhe të buxhetuara nga AKEP përgjatë viteve të fundit rezulton se koeficienti i të ardhurave të mbledhura nga mbikëqyrja e tregjeve të komunikimeve elektronike dhe atyre postare është luhatur drejt kufijve maksimale rreth 0.44 – 0.5% të të ardhurave totale të vitit pararendës të mbledhura nga operatorët e këtyre tregjeve. Bazuar në të ardhurat e mbledhura nga shfrytëzimi i këtij koeficienti, vërehet se këto të ardhura përbëjnë rreth 47% të financimit të buxhetit të AKEP.

Përgjatë vitit 2023 tregu i ofrimit të shërbimeve mobile ka pësuar ndryshime të rëndësishme strukturore si rezultat i bashkimit me përthithje të dy operatorëve mobile Albtelecom dhe One Telecommunications, si rezultat duke filluar nga data 1 janar 2023 në treg operojnë vetëm dy sipërmarrës mobile.

Reduktimi i numrit të operatorëve celularë dhe rritja shumë modeste e të ardhurave vjetore të sektorit lënë të kuptojnë se, të paktën në afatmesëm, nuk pritët ndonjë përmirësim domethënës i të hyrave të AKEP-it nga tarifa e mbikëqyrjes së tregut.

### **3.2. Tarifat për përdorimin e frekuencave**

Sipërmarrësit e komunikimeve elektronike, në zbatim të nenit 78, të ligjit 9918/2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, janë të detyruar të kryejnë pagesat vjetore për përdorimin e frekuencave.

Buxheti i AKEP sigurohet në masën rreth 33% nga faturimi për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, sipas të dhënave të sipërmarrësve menaxhimi i spektri të frekuencave këto dy vitet e fundit karakterizohet nga dinamika e lartë e ndryshimeve dhe inovacionit të teknologjisë së komunikimeve elektronike.

Aktet që përcaktojnë pagesat për radio frekuencat, për buxhetin e shtetit dhe për AKEP, janë:

- a. Udhëzimi nr. 28, datë 12.1.2015, i ndryshuar, i Ministrisë së Financave dhe AKEP, i cili përcakton tarifën vjetore për shërbimin e radiokomunikacionit, tarifë e cila shkon në buxhetin e shtetit.
- b. VKM nr. 599, datë 23.7.2010, i ndryshuar, për pagesat vjetore që kryhen në AKEP, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, etj., pagesa të cilat arkëtohen në buxhetin e AKEP.

Të dy këto akte nënligjore që përcaktojnë pagesat për radiofrekuencat, janë miratuar shumë vite më parë dhe ka ardhur momenti i ndryshimit të tyre, me qëllim që të nxisin një mjedis më të favorshëm, me synimin e përafrimit të pagesave me koston administrative për administrimin e radiofrekuencave në mënyrë që AKEP t'i përgjigjet sfidave të menaxhimit dhe monitorimit të frekuencave në zhvillimet teknologjike dhe krijimin e një mjedisi të sigurt kibernetik.

Ndryshimet lidhen me:

*Së pari*, nga Qeveria Shqiptare në mars të vitit 2024, është dërguar në Kuvendin e Shqipërisë, Ligji i ri për Komunikimet Elektronike, i hartuar me konsulencën e Bashkimit Europian. Ky ligj ndër të tjera, parashikon një mënyrë të re administrimi të spektrit të frekuencave, ku, në ndryshim nga ligji aktual, radiofrekuencat mund të jepen edhe me qira nga poseduesi i tyre. Kjo sjell nevojën e ndryshimit të rregulloreve aktuale të AKEP-it dhe një qasje të re të pagesave për frekuencat, në dy dokumentet aktuale në fuqi të sipërcituara.

*Së dyti*, kostot e AKEP-it për administrimin dhe monitorimin e frekuencave, gjatë periudhës 2021-2023 janë rritur në masën 30% mbi kostot e vlerësuara deri në vitin 2020, kjo për shkak të rritjes së çmimeve të pajisjeve hardware (pajisjet e monitorimit), të çmimeve të software, licencat e administrimit si dhe çmimet e shërbimeve për mirëmbajtjen e tyre.

Ndërkohë që dokumentat ligjorë mbi të cilat përlllogariten të ardhurat nga pagesat për caktimin dhe përdorimin e frekuencave si dhe tarifa e radiokomunikacionit që derdhet në buxhet, kanë mbetur të pandryshuara për më shumë se 10 vite, duke mos reflektuar ndryshimet e kostove administrative që i përgjigjen këtij zëri.

*Se treti*, revokimi i frekuencave të lidhjeve fikse, është një proces që pritet të vazhdojë edhe gjatë vitit 2024 e në vijim, si pasojë e zhvillimeve dhe zgjerimeve të rrjeteve me fibra optike të operatorëve, të cilat zëvendësojnë një pjesë të frekuencave të operatorëve celularë, në lidhjet fikse pikë-pikë, si dhe përdorimi i pajisjeve të radiokomunikimit janë reduktuar në 40%.

---

### **3.3 Tarifat për shërbime të tjera**

Buxheti i AKEP sigurohet në masën rreth 20% nga faturime të tjera si numeracione, portabiliteti, domaine me .al, etj.

Për tërësinë e këtyre pagesave, AKEP-i, së bashku me aktorët e tjerë të përfshirë, shtetërorë dhe privatë, ka për synim të angazhohet në një proces reflektimi me synim hartimin e rekomandimeve, masave, dhe veprimeve, që synojnë një shpërndarje të drejtë të kostove të financimit të rregullatorit dhe, njëkohësisht, sigurojnë përmbushjen e detyrave rregullatore dhe përballimin e sfidave në administrimin dhe operimin e infrastrukturave kritike.



## VII. SHTOJCA

### 1. Struktura dhe organigrama e AKEP

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare organizohet dhe funksionon sipas strukturës organizative, miratuar me vendim të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr. 56/2018, “Për miratimin e strukturës, organikës, dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)”.

Punonjësit e rekrutuar në Institucion trajtohen sipas dispozitave të ligjit “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar dhe Kodit të Punës.

Struktura organizative dhe organika e AKEP përbëhet në total nga 85 punonjës.

Gjatë vitit 2023, bazuar në planin vjetor të pranimit si dhe vendeve vakante të krijuara rast pas rasti, janë realizuar gjithsej 12 procedura rekrutimi në shërbim civil, konkretisht 3 pozicione në kategorinë e ulët drejtuese dhe 9 procedura në kategorinë ekzekutive, duke ndjekur fazat e rekrutimit me lëvizje paralele, ngritje në detyrë apo pranim në shërbimin civil. Gjithashtu, është realizuar edhe 1 procedurë në zbatim të dispozitave të Kodit të Punës.

Në fund të vitit 2023 rezultonin për t’u plotësuar 10 pozicione të lira pune, respektivisht 7 pozicione në Shërbim Civil, konkretisht 4 pozicione në kategorinë e ulët drejtuese dhe 3 në kategorinë e ekzekutiv, si dhe 3 pozicione me Kod Pune.

Gjatë vitit 2023 përfaqësimi gjinor apo raporti i femrave ndaj meshkujve në totalin e punonjësve aktivë në AKEP u paraqit: 37 janë femra dhe 38 janë meshkuj. Ndërkohë që ky raport në nivelet drejtuese është 49% femra dhe 51% meshkuj.

## 2. Veprimtaria inspektuese në komunikimet elektronike

### 2.1 *Plani i inspektimit për vitin 2023*

Në Planin Vjetor të Inspektimit për vitin 2023 për subjektet e komunikimeve elektronike ishin planifikuar të inspektoheshin 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) sipërmarrës të komunikimeve elektronike si dhe 6 (gjashtë) regjistrarët e domaineve që operojnë në treg.

Në zbatim të këtij plani vjetor si dhe duke u mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi, struktura inspektuese e AKEP, gjatë vitit 2023 realizoi inspektimin e 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) sipërmarrësit të planifikuar, 6 (gjashtë) regjistrarë domainesh si dhe realizoi 4 (katër) inspektime rastësore dhe 1 (një) inspektim në distancë.

Në përfundim të këtyre inspektimeve rezultojnë se janë vendosur 18 (tetëmbëdhjetë) masa administrative “gjobë”.

Vlen të theksohet se gjatë vitit 2023 rëndësi e veçantë iu kushtua kontrollit të procesit të bashkimit të dy sipërmarrësve (One Albania dhe Albtelecom). Në këtë aspekt, duke garantuar të drejtën e çdo sipërmarrësi për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike në detyrim të kuadrit ligjor, institucioni i AKEP-it ndoqi me përparësi zhvillimin e procesit mbi kalimin e sistemeve të reja mbështetëse IT për shërbimet celulare dhe Cut-Off.

- *Në përfundim të inspektimeve të programuara u vendosën 6 masa administrative “gjobë”.*

Gjatë vitit 2023 u realizuan Inspektime rastësore të cilat u bazuan në indicie apo ankesa me shkrim të drejtuara nga autoritetet shtetërore, operatorët, personat fizikë apo juridikë. Kryesisht në këto inspektime vlen të theksohet bashkëpunimi i frytshëm me institucionin e AMA.

- *Në përfundim të inspektimeve rastësore u vendosën 3 (tre) masa “gjobë”.*

Inspektimi në distancë kaloi në sitë të gjithë sipërmarrësit që operojnë në treg, duke verifikuar në bashkëpunim edhe me drejtoritë e AKEP-it përmbushjen e detyrimeve rregullatorë.

- *Në përfundim të inspektimit në distancë u vendosën 9 (nëntë) masa me “gjobë”.*

## 2.2 Problematikat e hasura

- Gjatë procedurave inspektuese, problematikat e hasura lidhen kryesisht me plotësimin e detyrimeve rregullatorë të përcaktuara në legjislacionin në fuqi nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike.

Konkretisht, disa prej problematikave të hasura të kësaj natyre dhe masat e marra nga strukturat inspektuese janë si më poshtë:

- Plotësimi dërgimi sipas formateve të përcaktuar nga legjislacioni dhe në afat të të dhënave statistikore (për periudha 3 mujorësh apo vjetor).

*Në përfundim të procedurave inspektuese 24% e masave administrative dhe rekomandimeve janë vendosur për mosplotësim të këtij detyrimi rregullator.*

- Plotësimi i detyrimit mbi Publikimin në faqen web të të gjithë elementeve të përcaktuar nga kuadri ligjor (Termave dhe Kushteve”, tarifave, speed test, kontratat e pajtimit...)

*Në përfundim të procedurave inspektuese 65% e masave administrative dhe rekomandimeve janë vendosur për mosplotësim të këtij detyrimi rregullator.*

- Garancia dhe plotësimi i mekanizmave teknikë dhe pajisjeve me qëllim realizimin e përgjimeve të komunikimeve elektronike vetëm nga autoritetet e ngarkuara me ligj.
- Plotësimi i detyrimeve ligjore (nenit 101, të ligjit 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”) mbi ruajtjen dhe administrimin për një afat 2-vjeçar, të skedarëve dhe të të dhënave të pajtimtarëve në mënyrë të sekretuar.

*Në përfundim të procedurave inspektuese 2 % e masave administrative dhe rekomandimeve janë vendosur për mosplotësim të këtij detyrimi ligjor.*

- Plotësimi i detyrimeve mbi sigurinë e rrjeteve. Në këtë aspekt ofruesve të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike, ose të shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, i kërkohet të marrin masat e duhura teknike, organizative dhe proporcionale, për të menaxhuar në mënyrë të përshtatshme rreziqet që vijnë për sigurinë e rrjeteve dhe shërbimeve. Duke pasur parasysh gjendjen e teknologjisë, këto masa duhet të sigurojnë një nivel të përshtatshëm sigurie për rrezikun e paraqitur. Në veçanti, masat, duke përfshirë enkriptimin aty ku është i përshtatshëm, merren për të parandaluar dhe minimizuar ndikimin e incidenteve të sigurisë tek përdoruesit dhe në rrjetet dhe shërbimet e tjera.

---

*Në përfundim të procedurave inspektuese 13% e masave administrative dhe rekomandimeve janë vendosur për mosplotësim të këtij detyrimi ligjor.*

- Krahas sigurisë së rrjeteve problematike e konstatuar është edhe ndërtimi i rrjeteve sipas standardeve, në respektim të kuadrit ligjor dhe duke u përshtatur me gjeneratën e re. Prej ofruesve të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike, kërkohet të ndërtojnë apo krijojnë rrjete publike të komunikacioneve dhe facilitete shtesë që lidhen me to, duke mundësuar përdorimin e përbashkët të tyre.

*Në përfundim të procedurave inspektuese 2% e masave administrative dhe rekomandimeve janë vendosur për mosplotësim të këtij detyrimi ligjor.*

- AKEP pasi administron kërkesat nga organet ligj zbatuese me objekt bllokimi i faqeve web me përmbajtje të paligjshme, në zbatim të shkronjës “e”, të nenit 15, të ligjit nr.9918, i ndryshuar, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, dhe bazuar në shkronjën “e”, të pikës 1, të nenit 9, të Aneksit E), të Rregullores nr. 47, datë 26.10.2017, “Për zbatimin e regjimit të autorizimit të përgjithshëm”, njofton me shkresë zyrtare, por edhe përmes postës elektronike sipërmarrësit e komunikimeve elektronike për të kryer veprimet e mbylljes së aksesit të faqeve elektronike. Me gjithë njoftimet e kryera mbi bllokimin e faqeve me përmbajtje të paligjshme apo të dëmshme, ndaj sipërmarrësve të komunikimeve elektronike, që nuk plotësonin detyrimin mbi bllokimin e çdo faqe interneti me përmbajtje të paligjshme apo të dëmshme sipas udhëzimeve të institucioneve ligj zbatuese dhe vendimmarrëse, strukturat e AKEP kanë vendosur masa administrative.

*Në përfundim të procedurave inspektuese 12% e masave administrative dhe rekomandimeve janë vendosur për mosplotësim të këtij detyrimi ligjor.*

- Strukturat inspektuese në vijimësi kanë ndjekur edhe trajtuar problematikat e ardhura nga procesi i portabilitetit (kalimi i numrit mobile nga një operator tek tjetri). Në vitet e fundit rezultoi një rritje e numrit të kërkesave të refuzuara, duke bërë që AKEP të trajtojë me prioritet ankesat që adresoheshin nga përdoruesit, por edhe nga vetë operatorët. Gjatë procedurave inspektuese u konstatuan praktika abuzive në procesin e portimit të numrit nga shoqëritë konkurrense në treg për të cilat janë marrë edhe masa administrative me “gjobë”.

Edhe gjatë vitit 2023, në fokus të inspektimit ka qenë problematika e portabilitetit. Pas inspektimit të dy sipërmarrësve të mëdhenj ndaj njërit prej tyre (One Albania) u vendos dënimi kryesor “Paralajmërim” pasi u konstatuan problematika teknike në

arkitekturën e moduleve të sistemeve si dhe mungesë koordinimi midis skuadrave të portabilitetit, të cilat kanë çuar në shkelje të afateve maksimale të lejuara për portimin e numrit.

- Gjithashtu, kemi marr indicie mbi problemet e konkurrencës së pandershme në tregun e komunikimeve elektronike si dhe informaliteti. Në këtë aspekt, struktura inspektuese e AKEP (dhe jo vetëm, por në bashkëpunim edhe me struktura dhe institucione të tjera ligj zbatuese), kanë fokusuar energjitë e tyre në luftën ndaj abuzuesve me ligjin.

Gjatë vitit 2023, u trajtua një ankesë në zonën e Korçës, e cila lidhej me konkurrencën e pandershme. Në përfundim të trajtimit të kësaj ankesës, pas konstatimit të problematikave, strukturat inspektuese vendosën masë bllokimi dhe ndalimi të funksionimit të pajisjes të komunikimeve elektronike të evidentuara në këtë zonë.

Ndërsa lidhur me problematika në aspektin formal të ushtrimit të veprimtarisë (informaliteti) duhet të theksojmë se gjatë vitit 2023 ankesa me këtë objekt pothuajse ishin zero, çka tregon luftën dhe përpjekjet e AKEP në këtë drejtim gjatë viteve të fundit me qëllim formalizimin e tregut të komunikimeve publike dhe zhvillimin e konkurrencës së ndershme.

- Në qendër dhe fokus të inspektimeve mbetet zgjidhja e problematikave që lidhen me të drejtat e konsumatorit (familjar apo biznes) duke i garantuar atyre akses në internet me cilësi të lartë, të përballueshëm, dhe mbi të gjitha siguri në shërbimet dhe aplikacionet e komunikimit që tashmë mbështesin nevojat sociale dhe ekonomike të tyre.

Në këtë aspekt përfshihet edhe procesi për dhënien e të drejtave të përdorimit, i cili duhet të jetë sa më objektiv dhe sa më transparent për përfitimin e konsumatorëve dhe ekonomisë shqiptare, krijimin e një tregu konkurrues në Shqipëri, si dhe përdorimin efektiv të spektrit në përmbushje të objektivave rregullatorë.

### ***2.3 Inspektimi në funksion të rrjeteve të sigurta***

Inspektimi është një hallkë e rëndësishme e shtetit ligjor për përmirësimin e klimës së biznesit dhe ndërgjegjësimin e subjekteve në zbatimin e rregullave dhe standardeve ligjore të vendosura. Inspektimi në vetvete ka për qëllim mbrojtjen e interesit publik dhe të interesave të ligjshëm të personave fizikë e juridikë. Ky qëllim i veprimtarisë së inspektimit arrihet nëpërmjet vlerësimit të respektimit të kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit si dhe dokumentimit të praktikave të mira.

Me qëllim funksionimin e rrjeteve të sigurta, strukturat inspektuese gjatë procedurave



---

inspektuese verifikon tek sipërmarrësit që operojnë nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm masat e ndërmarra gjatë projektimit, instalimit dhe funksionimit të rrjetit ose pajisjeve të përdorura, në mënyrë që të garantojnë sigurinë, integritetin dhe mirëfunksionimin e tyre.

Gjithashtu, nëpërmjet inspektimit realizohet monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të detyrimeve që sipërmarrësit kanë për treguesit e cilësisë së shërbimit, për aksesin në rrjetin e qëndrueshëm (fiks) të komunikimeve publike dhe shërbimit telefonik të disponueshëm për publikun, aksesin në rrjetin e lëvizshëm të komunikimeve publike, dhe aksesin në Internet.

Inspektimi siguron që ofruesi i shërbimit të komunikimeve elektronike publike ndërmerr masa adekuate teknike dhe organizative për ta mbrojtur sigurinë e shërbimeve.

Siguria e të dhënave është gjithashtu një tërësi masash që ndërmerren nga ISP për të siguruar që sistemi do të jetë në gjendje t'i përmbush qëllimet e synuara, duke minimizuar pasojat negative të qëllimshme apo të paqëllimshme.

Strukturat inspektuese të AKEP (dhe jo vetëm), marrin masat e duhura për të zbutur rreziqet e sigurisë së rrjetit nga furnitorët dhe ofruesit e pajisjeve të rrjetit, të cilët konsiderohen si një rrezik për të gjithë furnizuesit dhe ofruesit e pajisjeve të rrjetit 5G, ose të gjeneratës së re.

Për të arritur këtë qëllim bëhet periodikisht një vlerësim i rrezikut për furnizuesit 5G, dhe ofruesve të tjerë të pajisjeve të rrjetit të gjeneratës së re.

Gjithashtu, në këtë aspekt rëndësi i kushtohet dhe do t'i kushtohet akoma me tepër edhe mbrojtjes dhe sigurisë kibernetike, nëse furnizuesit dhe ofruesit përfaqësojnë një rrezik për sigurinë kombëtare. Për arritjen e këtij qëllimi do të vlerësohet profili i rrezikut në nivel kombëtar për të gjithë furnizuesit duke garantuar një rrjet dhe ndërveprim të sigurtë dhe të besueshëm.


### 3. Tregues statistikore mbi autorizimet e pergjithshme, autorizimet individuale, dhe domain-in .al

#### 3.1 Tregues statistikore te sektorit te autorizimeve

Sipermarrës aktivë gjatë vitit 2023:


Gjatë vitit 2023 kanë ushtruar aktivitetet:

- 285 sipermarrës për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike;
- 114 sipermarrës për ofrimin e rrjeteve që mundësojnë transmetimin e programeve Audiovizive.




**Sipermarrës të rinj dhe sipermarrës të çregjistruar gjatë vitit 2023:**

Gjatë vitit 2023 janë regjistruar në AKEP 21 ofrues të rinj për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe janë çregjistruar 24 prej tyre.




Gjatë vitit 2023 janë regjistruar në AKEP 3 ofrues të rinj për ofrimin e rrjeteve që mundësojnë transmetimin e programeve Audiovizive dhe janë çregjistruar 3 prej tyre.



### Sipërmarrës që ofruan shërbime publike telefonike gjatë 2023:


- 2 sipërmarrës - telefoni të lëvizshme;
- 33 sipërmarrës - telefoni fikse;
- 4 sipërmarrës - kartë me parapagim.



### Sipërmarrës që ofruan shërbime interneti, transmetim të dhëna dhe linja me qira gjatë vitit 2023:

Gjatë vitit 2023 kanë ushtruar aktivitet sipërmarrës që ofrojnë shërbime të tjera:

- 245 Sipërmarrës që ofrojnë shërbim Interneti;
- 37 Sipërmarrës që ofrojnë transmetim të dhënash;
- 17 Sipërmarrës që ofrojnë linja me qira.



### 3.2 Tregues statistikore për dhënie të drejtash përdorimi të frekuencave


#### ➤ Tregues statistikor të autorizimeve individuale

*Autorizimet Individuale për përdorimin e frekuencave të sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të lëvizshme (celulare):*

Gjatë vitit 2023 kanë ofruar shërbime telefonike të lëvizshme dhe shërbime *broadband* në rrjetet mobile 2 operatorë: Vodafone Albania sh.a., dhe One Albania sh.a., të pajisur nga AKEP me Autorizime Individuale për përdorim frekuencash në brezat GSM/UMTS/IMT/LTE (800/900/1800/2100/2600 MHz), të njohura si rrjetet 2G/3G/4G.


*Autorizimet Individuale për përdorimin e frekuencave, për lidhje fikse (pikë-pikë), sisteme PMR radiokomunikimi/radioalarmi, etj.*

Gjatë vitit 2023, për operatorët e rrjeteve të komunikimeve elektronike janë lëshuar nga AKEP, Autorizime Individuale për përdorimin e frekuencave në 142 lidhje fikse të reja dhe 132 lidhje fikse të ndryshuara (në total 172 lidhje fikse). Janë revokuar Autorizimet Individuale për 245 lidhje fikse.



Gjatë vitit 2023, për operatorët që përdorin frekuenca për sisteme PMR (radiokomunikimi dhe radioalarmi), janë konfirmuar 106 aplikime, nga të cilat 79 aplikime për sisteme të reja, 3 aplikime për ndryshime në autorizimin ekzistues dhe 24 aplikime për revokimin e frekuencave.






### 3.3 Të dhëna mbi përdorimin e domain.al.

AKEP administron domainin “.al”, bazuar në germën “k”, të nenit 8, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Rregulloren nr. 2, datë 21.2.2008, “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën “.al””, e ndryshuar.

Numri i domaineve me “.al” të regjistruara gjatë vitit 2023, ishte 5960 domaine.



Numri total i domaineve me “.al” deri në fund të vitit 2023, arriti në 28278 domaine.

Në terma statistikore vihet re se gjatë vitit 2023 ka pasur një rritje të numrit total të domaineve të regjistruara, me 1003 domaine më shumë së në vitin 2022.



Në fund të vitit 2023, Regjistruesi Host.AL shpk (i autorizuar nga AKEP) vijon të kryesojë listën e Regjistruesve të domaineve “.al”, me numrin total më të madh të domaineve të regjistruara nëpërmjet tij.


AKEP mban vendin e pestë si Regjistrues, për nga numri i domaineve të regjistruar nëpërmjet tij.



### Domainet shtetërore “.gov.al”:

Gjatë vitit 2023, janë regjistruar 20 domaine “.gov.al”. Në fund të vitit 2023, numri total i domaineve “.gov.al” ishte 439. Gjatë vitit 2023, 12 domaine “.gov.al” janë kaluar në gjendje të lirë nga sistemi i administrimit të domaineve “.al”, pasi institucionet përkatëse i kanë ndryshuar me emra të tjerë domainesh.

AKEP ka bashkëpunuar me institucionet shtetërore që disponojnë domaine me “.gov.al”, mbi rinovimet e tyre, në mënyrë që të shmangej mbyllja e shërbimeve që ofrojnë me këta domaine, si faqe interneti, e-maile, etj.



## 4. Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP për vitin 2023

Vendimi	Data	Titulli i Vendimit
Nr. 1	16.02.2023	Miratimin e dokumentit “Mbi disa shtesa e ndryshime në Rregulloren nr.40, datë 17.12.2015, “Për të dhënat Statistike dhe Financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga ofruesit e Shërbimeve Postare”.
Nr. 2	18.04.2023	Mbi “Miratimin e Raportit të veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2022”.
Nr. 3	25.05.2023	Për “Pajisjen me Autorizime Individuale të sipërmarrësit One Albania sh.a., për përdorimin e frekuencave të brezave 900 MHz, 1800 MHz dhe 2100 MHz, për shkak të rishpërndarjes me qëllim sigurimin e përdorimit eficient të këtyre frekuencave”.
Nr. 4	25.05.2023	Për “Pajisjen me Autorizime Individuale të sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a., për përdorimin e frekuencave të brezave 900 MHz, 1800 MHz dhe 2100 MHz, për shkak të rishpërndarjes, me qëllim sigurimin e përdorimit eficient të këtyre frekuencave”.
Nr. 5	15.06.2023	Mbi përdorimin e komisionit të përfituar si agjent tatimor, nga AKEP, në formën e shpërblimit për vështirësi në punë, për vitin 2023.
Nr. 6	19.07.2023	Për “Miratimin për Këshillim Publik të dokumentit: “Plani i Përdorimit të Frekuencave””.
Nr. 7	06.09.2023	Për “Miratimin e dokumentit: “Plani i Përdorimit të Frekuencave””.
Nr. 8	06.09.2023	Për “Aplikimin e shtesës mbi pagë për pozicionet e punës që ndjekin dhe administrojnë sistemet informatike në AKEP, bazuar në VKM nr.325, datë 31.5.2023”.
Nr. 9	06.09.2023	Mbi “Korrigjimi i gabimeve materiale në dokumentin “Rregullore për mbrojtjen e konsumatorëve dhe pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”, miratuar me VKD nr. 2, datë 11.3.2021””.
Nr. 10	12.10.2023	Për “Një ndryshim në VKD nr. 3, datë 25.5.2023, “Për pajisjen me autorizime individuale të sipërmarrësit One Albania sh.a., për përdorimin e frekuencave të brezave 900 MHz, 1800 MHz dhe 2100 MHz, për shkak të rishpërndarjes, me qëllim sigurimin e përdorimit eficient të këtyre frekuencave””.

Vendimi	Data	Titulli i Vendimit
Nr. 11	12.10.2023	Për “Një ndryshim në VKD nr. 4 datë 25.05.2023 “Për pajisjen me autorizime individuale të sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a, për përdorimin e frekuencave të brezave 900 MHz, 1800 MHz dhe 2100 MHz, për shkak të rishpërndarjes, me qëllim sigurimin e përdorimit eficient të këtyre frekuencave””.
Nr. 12	18.10.2023	Propozimin tek Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë për “Një ndryshim të VKM nr. 750, datë 1.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2023””
Nr. 13	18.10.2023	Mbi “Mënyrën e përdorimit nga AKEP të komisionit që do të përfitohet si agjent tatimor për vitin 2024”
Nr. 14	18.10.2023	Mbi “Shqyrtimin e propozimit të grupit të inspektimit, ngritur me autorizimin e inspektimit nr. 2005, datë 29.8.2023, për penalizimin me masë administrative me gjobë të propozuar ndaj sipërmarrësit të inspektuar One Albania sh.a.”.
Nr. 15	24.10.2023	Për “Caktimin e fondit të shpenzimeve administrative dhe projektbuxhetin e vitit 2024 të AKEP”.
Nr. 16	16.11.2023	Për “Miratimin për Këshillim Publik të dokumentit – “Analizë e tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme (celulare)””.
Nr. 17	04.12.2023	Për “Shqyrtimin e ankimit administrativ të sipërmarrësit “One Albania” sh.a., mbi Vendimin Përfundimtar të Inspektimit nr. 8, datë 25.10.2023 dhe Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 14, datë 24.10.2023”.
Nr. 18	19.12.2023	Mbi “Projektvendimit për disa shtesa dhe ndryshime të aktit normativ administrativ “Rregullore për funksionimin e administratës së AKEP”, e ndryshuar.

## 5. **Acquis të transpozuar në Planin e Përdorimit të Frekuencave gjatë vitit 2023**

1. Commission Decision 2004/545/EC: Vendim i Komisionit më 8 korrik 2004: Për harmonizimin e brezit të spektrit radio 79 GHz për përdorimin nga pajisjet radar automobilistike me rreze të shkurtër në komunitet;
2. Commission Decision 2011/485/EU: Vendim zbatues i Komisionit më 29 korrik 2011: Për ndryshimin e vendimit 2005/50/EU për harmonizimin e brezit të spektrit radio 24 GHz për përdorimin e kufizuar kohor nga pajisjet radar automobilistike me rreze të shkurtër në komunitet (2011/485/EU);
3. Decision (EU) 2016/339: Vendim zbatues i Komisionit (EU) 2016/339 i datës 8 mars 2016: Për harmonizimin e brezit të frekuencave 2010-2025 mhz për lidhjet video pa tel portative ose të lëvizshme dhe kamerat pa kablo, të përdorura për krijimin e programeve dhe ngjarjet e veçanta;
4. Decision (EU) 2016/2317: Vendim zbatues i Komisionit (EU) 2016/2317 më 16 dhjetor 2016: Për ndryshimin e vendimit 2008/294/EC dhe vendimit zbatues 2013/654/EU, me qëllim thjeshtësimin e operimit të komunikimeve celulare në mjete fluturuese (shërbime MCA) në Union;
5. Decision (EU) 2017/1483: Vendim zbatues i Komisionit (EU) 2017/1483 i 8 gushtit 2017: Që ndryshon vendimin 2006/771/EC për harmonizimin e spektrit të radios për përdorim nga pajisjet me rreze të shkurtër dhe që shfuqizon vendimin 2006/804/EC;
6. Decision (EU) 2017/2077: Vendim zbatues i Komisionit (EU) 2017/2077 i datës 10 nëntor 2017: për ndryshimin e Vendimit 2005/50/CE për harmonizimin e brezit të spektrit të radios 24 GHz për përdorimin e kufizuar kohor nga pajisjet radar automobilistike me rreze të shkurtër në Komunitet;
7. (EU) 2019/1345: Vendim zbatues i Komisionit (EU) 2019/1345 i datës 2 gusht 2019: Për ndryshimin e vendimit 2006/771/CE për përditësimin e kushteve teknike të harmonizuara në fushën e përdorimit të spektrit të radios për pajisjet me rreze të shkurtër.

Këto acquis kanë të bëjnë me rekomandime/vendime (EC Decissions) për përdorimin e spektrit të frekuencave.

Të gjitha vendimet/rekomandimet e transpozuar në PPF janë pjesë e PKF, për këtë arsye ndryshimi reflektohet vetëm në PPF pa pasur nevojë për të bërë ndryshime në PKF.



## 6. Raport lidhur me zbatimin e Rezolutës dhe rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë për AKEP për vitin 2023

1. *Duke pasur parasysh situatën e re të krijuar me vetëm dy operatorë të telefonisë celulare, t'i kushtojë një vëmendje të shtuar këtij tregu dhe, në bashkëpunim të ngushtë dhe luqjal edhe me Autoritetin e Konkurrencës, të shmangin krijimin e një tregu oligopol në vend duke bërë të mundur zhvillimin e një konkurrence të ndershme mes operatorëve në treg.*

### REALIZUAR

Për AKEP, kjo pikë e Rezolutës, e renditur me të drejtë në vend të parë, përbën një nga prioritetet më të rëndësishme jo vetëm për këtë vit, por në një hark kohor afatmesëm. Për të adresuar sfidën që paraqet kufizimi i operatorëve celularë nga 3 në 2, AKEP ka ndërmarrë dhe ka vendosur në planin e vet të punës një sërë masash dhe veprimtarish.

Në radhë të parë, AKEP ka shtuar vëmendjen mbi evoluimin e tre prej parametrave kryesorë që institucioni ynë mban në mbikëqyrje: çmimet e pakicës, treguesit e cilësisë së shërbimit dhe nivelin e investimeve. Sa herë të jetë e nevojshme, AKEP është i gatshëm të ndërhyjë përmes instrumenteve ligjorë dhe rregullatorë, që janë në dispozicion të tij, dhe t'i referojë Autoritetit të Konkurrencës rastet që mund të ngrenë dyshime për marrëveshje të ndaluara apo abuzim me pozitën dominuese.

Në këtë kuadër, në vijim të bashkëpunimit midis dy institucioneve, AKEP përgjatë gjithë vitit ka përcjellë pranë Autoritetit të Konkurrencës informacion të detajuar mbi planet tarifore të shërbimeve mobile, si dhe ndryshimet e tyre me arsyetimet mbështetëse, të depozituara pranë AKEP-it nga sipërmarrësit e shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Gjithashtu, dëshirojmë t'ju informojmë se Këshilli Drejtues i AKEP, me Vendimin nr.16, datë 16.11.2023, ka miratuar dokumentin për Këshillimin Publik "Analizë e tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme (celulare)". Ky dokument është përgatitur në zbatim të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si edhe duke marrë në konsideratë udhëzimet dhe rekomandimet e Bashkimit Europian, me synim përmirësimin dhe nxitjen e konkurrencës efektive në tregun e komunikimeve elektronike mobile në Republikën e Shqipërisë, si dhe trajton zhvillimet në treg dhe pritshmëritë e AKEP-it për të ardhmen e afërt dhe të mesme, së bashku me masat rregulluese përkatëse të propozuara për sipërmarrësit e shpallur me Fuqi të Ndjeshme të këtij tregu.

Në dokumentin e miratuar për Këshillim Publik, ndër të tjera AKEP ka trajtuar rolin dhe rëndësinë që ka hyrja në treg e MVNO, ku prezenca e tyre në tregun e

---

shërbimeve celulare do të përbënte një faktor të rëndësishëm në nxitjen dhe rritjen e konkurrueshmërisë në këtë treg.

Së dyti, në përputhje të plotë me legjislacionin dhe aktet rregullatore, AKEP do të ndërmarrë një studim të detajuar mbi vlerësimin e mundësive dhe impaktit të hyrjes së MVNO-ve në tregun e shërbimeve të komunikimeve të lëvizshme. Sigurimi i një kuadri rregullator të favorshëm për hyrjen e MVNO-ve është një prej rekomandimeve të AK-së për AKEP-in në vendimin për lejimin e përqendrimit mes operatorëve ONE dhe Altelecom.

Së treti, AKEP do të sigurojë vijimësisht që një operator rrjetesh celulare (MNO), i interesuar për të hyrë në tregun shqiptar, të ketë akses adekuat dhe të mjaftueshëm në breza të ndryshëm të spektrit të frekuencave për të ofruar shërbime cilësore dhe konkurruese. Për hollësi të mëtejshme mbi masat e ndërmarra dhe planet e AKEP-it në lidhje me sigurimin e konkurrencës përmes administrimit spektral, referojuni shtjellimit të AKEP-it në pikën 8 të kësaj Rezolutive.

- 2. Duke pasur parasysh situatën e krijuar pas agresionit rus në Ukrainë, të tregojë vëmendje dhe kujdes të shtuar për sa i takon integritetit dhe pacenueshmërisë së rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike (telefoni, internet) për të parandaluar, menaxhuar dhe eliminuar çdo problematikë.***

**REALIZUAR**

Për sa i përket Rekomandimit nr. 2 të Kuvendit, në vijim edhe të Raportit Vjetor 2022 që ju është prezantuar përgjatë muajit maj 2023, AKEP ju bën me dije se institucioni ka pasur vëmendje të shtuar për sa i përket garantimit të integritetit dhe pacenueshmërisë së rrjeteve të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike.

Krahas raportimeve dhe masave që lidhen me sigurinë kibernetike, të cilat janë detyrime ligjore ose rregullatore për sipërmarrësit e komunikimeve elektronike, AKEP ka kërkuar vazhdimisht edhe informacione, raportime apo masa shtesë nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike, për të bërë të mundur garantimin e integritetit dhe pacenueshmërinë e rrjeteve.

Informacionet dhe raportimet e kërkuara, kryesisht kanë pasur të bëjnë me analiza të trafikut që vjen drejt IP shqiptare nga vendet e huaja dhe, kryesisht, sulme keqdashëse ndaj Shqipërisë. Gjithashtu, sipërmarrësve ju është kërkuar, në disa raste edhe me kërkesë të AKCESK, bllokimi për IP apo Domaine të caktuar.

AKEP, në bashkëpunim të ngushtë me sipërmarrësit e komunikimeve elektronike, në shumicën e rasteve ka qenë vendimtar në zgjidhjen e incidenteve të sigurisë kibernetike si për institucione publike, ashtu edhe për biznese të cilat janë klasifikuar

si infrastruktura kritike kombëtare.

AKEP-i ka kërkuar nga sipërmarrësit që të rrisin nivelet e sigurisë në infrastrukturën e tyre në nivelin maksimal, ku në shumë raste është dashur edhe ndërhyrje në investime të reja nga sipërmarrësit. Gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur asnjë incident në rrjetet e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike, edhe pse mund të ketë pasur tentativa (të cilat janë të përditshme), por kanë rezultuar të pasuksesshme. Kjo edhe për faktin e rritjes së investimeve dhe vigjilencës nga ana e sipërmarrësve, por edhe nga kërkesat e rritura nga AKEP kundrejt tyre.

Në këtë kontekst vlen të theksojmë incidentin e ndodhur në datën 25.12.2023 në infrastrukturën e sipërmarrësit One Albania sh.a. Ky incident u klasifikua si sulm kibernetik dashakeq, dhe përgjegjësia u mor nga grupi “Homeland Justice”, përmes deklaratave publike në rrjetet sociale.

Nga vlerësimi teknik gjithëpërfshirës i situatës u konstatua se ishte fshirë një pjesë e informacionit të stokuar në disa servera dhe ishte kompromentuar aksesimi në një sërë sistemesh të brendshme IT. Aksesimi i kompromentuar në sisteme ndikoi negativisht në aksesueshmërinë dhe funksionimin normal të disa pikave të kontaktit të klientëve si dyqanet, aplikacioni MyONE dhe pikat e tjera të shërbimeve *online*. Skuadrat teknike të sipërmarrësit po atë ditë kanë bërë të mundur ringritjen e sistemeve dhe rikuperimin e shumicës së të dhënave të cilat janë sot në funksion të plotë.

Masat që janë marrë ndërkohë, si forcimi i masave të sigurisë së brendshme, ashtu edhe aktivizimi i monitorimit 24/7 të qendrës së kontrollit të sigurisë, do të ndihmojnë në zbatimin e masave shtesë të sigurisë kibernetike. Vlen të përmendet fakti që, sipas investigimit të bërë nga ana e sipërmarrësit One Albania sh.a., nuk janë impaktuar apo marrë të dhënat personale të përdoruesve.

Për sa i përket masave të marra nga ana e AKEP-it në lidhje me infrastrukturën dhe sistemet e institucionit, vlen të përmendim 3 investime të cilat janë bërë në AKEP gjatë vitit 2023, që kanë rritur nivelin e sigurisë për infrastrukturën dhe sistemet që AKEP-i ka ndërtuar, mirëmban dhe administron.

- Investimi i parë i përfunduar është ai i ndërtimit të DRS në qytetin e Shkodrës, i cili është një replikim identik i infrastrukturës primare të AKEP;
- Investimi i dytë ka të bëjë me blerjen e platformës për menaxhimin e incidenteve të sigurisë kibernetike;
- Investimi i tretë ka të bëjë me zëvendësimin e të gjithë infrastrukturës së sistemit ccTLD .al, një ndër infrastrukturën më kritike në Shqipëri.

Duhet marrë parasysh fakti që AKEP administron 5 infrastruktura të cilat klasifikohen si infrastruktura kritike kombëtare.

Gjatë vitit 2023 nuk ka pasur asnjë incident të ndodhur në infrastrukturën dhe

sistemet e AKEP. Ka pasur tentativa të cilat kanë qenë të pakta dhe të pasuksesshme, kjo për shkak të investimeve në infrastrukturën mbrojtëse të sigurisë kibernetike.

- 3. Të marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së në lidhje me sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e të dhënave, duke krijuar një grup pune të përhershëm për mbikëqyrjen e situatës së sigurisë kibernetike për sipërmarrësit e komunikimeve elektronike që direkt ose indirekt janë të lidhur me infrastruktura kritike kombëtare, si dhe të përditësojë rregulloren përkatëse për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve të komunikimeve.***

**REALIZUAR**

Përsa i përket rekomandimit të KLSH për ngritjen e një grupi pune të përhershëm, duke qenë se situata kibernetike vazhdon të jetë vulnerabël, grupi i punës, ngritur me Urdhër të Kryetarit në muajin shkurt 2022, vazhdon të jetë i ngarkuar me detyra që kanë të bëjnë me ndjekjen në vijimësi të situatës së sigurisë kibernetike.

Sjellim në vëmendjen tuaj se, me datë 18 janar 2023, në AKEP u dorëzuar projektraporti i auditimit të KLSH-së<sup>13</sup>, i cili përmban gjetjet për periudhën e auditimit, konkluzionet dhe rekomandimet e lëna.

Në lidhje me sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e të dhënave, raporti i auditimit ka vënë në dukje intensifikimin e vazhdueshëm të përpjekjeve të AKEP-it për të përmirësuar dispozitivin e sigurisë kibernetike, sidomos përmes përpjekjes financiare të shtuar nga viti 2019 deri në 2022 për investimet përkatëse.

- 4. Të japë kontribut konkret në grupin ndërinstitucional të punës, të ngritur me urdhër të Kryeministrit, për lirimin e brezit digjital dividend dy (DD2). Lirimi i këtij brezi për shërbimet e lëvizshme 5G ka ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të vendit, si dhe në ofrimin e shërbimeve me shpejtësi të lartë interneti.***

**REALIZUAR**

Me Urdhrin e Kryeministrit nr. 113, datë 20.7.2022, është ngritur Grupi Ndërinstitucional i Punës (GNP) për lirimin e Digital Divident 2 (DD2) për brezin 700 MHz. Ky Grup kryesohet nga Zv. Kryeministri dhe ka në përbërje Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrin e Financave dhe Ekonomisë, Ministrin e Drejtësisë dhe Ministrin për Europën dhe Punët e Jashtme. Në mbledhjet e Grupit marrin pjesë edhe Kryetari i AMA, Kryetari i AKEP dhe Kryetari i AK.

Grupi Ndërinstitucional i Punës është i ngarkuar për koordinimin e veprimtarive

<sup>13</sup> Raporti përfundimtar ende nuk është dorëzuar nga KLSH.

lidhur me lirimin e Digital Divident dy (DD2) si dhe për propozimin e të gjitha vendimmarrjeve të nevojshme tek organet kompetente për realizimin e këtij procesi.

Gjatë mbledhjeve të zhvilluara në muajin shkurt është propozuar për miratim Plani i Veprimit për procesin e lirit të DD2, fazat e migrimit dhe plani i migrimit, koordinimit me vendet fqinje, aktet ligjore/rregullatore për lirimin, mënyra e kompensimit të kostove të operatorëve audiovizivë, me afatet përkatëse të cilat duhet të ndiqen nga strukturat përgjegjëse.

*AKEP ka qenë pjesë aktive e grupit të punës duke paraqitur pozicionimin e sipërmarrësve lidhur me brezin 700 MHz dhe informacionet e nevojshme lidhur me pritshmëritë e tregut celular për rrjetet 5G.*

- 5. T'u përgjigjet në kohë sfidave që dalin para AKEP-it në tregun e shërbimeve postare, të cilat kanë për qëllim zbatimin e një kuadri rregullator që nxit shërbimet inovative dhe, në të njëjtën kohë, stimulon konkurrencën e ndershme, me fokus kryesor përcaktimin dhe zbatimin e rregullave të konkurrueshmërisë për të parandaluar anomalitë që rrjedhin nga abuzimi i mundshëm i tregut, si nga ana e kërkesës, ashtu edhe nga ajo e ofertës.***

#### **REALIZUAR**

Në lidhje me këtë pikë të Rezolutës, sqarojmë se në fokus të veprimtarisë së AKEP-it është edhe lufta kundër informalitetit dhe, në këtë kuadër, strukturat inspektuese të AKEP-it realizuan gjatë vitit 2023 inspektimin e subjekteve, të cilat reklamoni në rrjetet sociale aktivitet në fushën e shërbimeve postare.

Në përfundim të procedurave inspektuese, për ato subjekte që ekzistonte dyshimi i arsyeshëm, bazuar në indicie për kryerjen e veprimtarisë së paligjshme në fushën e ofrimeve të shërbimeve postare, AKEP ka referuar përpara organit të prokurorisë.

AKEP ka kryer investigime kryesisht bazuar në reklamimet nëpër rrjete sociale, ku rastet e evidentuara të subjekteve/personave që kryenin ofrim të shërbimit postar pa pasur autorizim nga AKEP i janë referuar organeve kompetente.

Për vitin 2023, i jemi drejtuar organit të Prokurorisë, ku i kemi referuar 11 subjekte të evidentuara nga ana jonë për informalitet dhe, përmes shkresës së datës 15.7.2022, jemi njoftuar nga ky organ për mosfillimin e procedimit penal.

Në këtë aspekt, AKEP gjithmonë ka vlerësuar bashkëpunimin me organet ligjzbatuese (prokurori dhe polici e shtetit) për evidentimin dhe vënien përpara përgjegjësisë ligjore të shkelësve, me qëllim përmirësimin e klimës së biznesit dhe ndërgjegjësimin e subjekteve në përmbushjen e rregullave dhe standardeve ligjore të vendosura.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe AKEP i ka kushtuar vëmendje të veçantë edhe rritjes së transparencës së tarifave për ofrimin e shpërndarjes së pakove postare

---

ndërkufitare në vendet e rajonit, në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjetikës, nr.5, datë 25.6.2021, i cili ka mundësuar harmonizimin e legjislacionit vendas me atë të vendeve të BE-së për sa i përket shpërndarjes së pakove postare ndërkufitare. Në zbatim të akteve të miratuara për shërbimet e dërgesave të pakove ndërkufitare dhe transparencën e tarifave, AKEP, në janar të vitit 2023, me Vendimin nr.1, datë 16.2.2023, ka miratuar ndryshimet e formularëve të të dhënave statistikore të cilat mundësojnë mbledhjen e informacionit edhe për sipërmarrësit që ofrojnë shërbimin e shpërndarjes së pakove postare ndërkufitare.

Në janar 2023 AKEP-i ka publikuar dokumentin përmbledhës me tarifën e shërbimit të pakove postare ndërkufitare që sipërmarrësit e klasifikuar për këtë shërbim aplikojnë prej datës 1 janar 2023.

Në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjetikës, nr.5, datë 25.6.2021, AKEP ka përgatitur raportin e vlerësimit për tarifën e aplikuar nga sipërmarrësit që ofrojnë shërbim të pakove postare ndërkufitare. Në vijim, këtë raport e ka përcjellë në muajin qershor 2023 në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

**6. *Të bashkëpunojë me AMA-n në marrjen e masave lidhur me fenomenin e ri të piraterisë online, ku vihet re një shtim i numrit të operatorëve privat që transmetojnë nëpërmjet internetit dhe faqeve të ndryshme që ofrojnë produkte audiovizive pa autorizimin e AMA-s.***

**REALIZUAR**

Në përmbushje të këtij rekomandimi sqarojmë se, në zbatim të Memorandumit të Bashkëpunimit nënshkruar në datën 3.11.2021, nga TASK-FORCE e përbashkët AMA dhe AKEP, janë realizuar edhe gjatë vitit 2023 inspektime tek sipërmarrësit e komunikimeve elektronike, aktiviteti i të cilëve është objekt inspektimi i këtyre dy institucioneve.

- Pasi u inspektuan 12 (dymbëdhjetë) sipërmarrës të komunikimeve elektronike, në 3 (tre) prej tyre u konstatua se nuk plotësonin detyrimin mbi respektimin e rasteve të kufizimeve në lidhje me përmbajtjen e paligjshme ose të dëmshme apo detyrime të tjera rregullatorë.

**Me përfundimin e procedurës inspektuese, ndaj sipërmarrësve që u konstatuan problematika mbi detyrimet rregullatorë u vendosën edhe masa administrative sipas përcaktimeve të nenit 137, të ligjit të nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe dënime plotësuese**



## **në formë rekomandimi.**

Lidhur me fenomenin e piraterisë audiovizive nëpërmjet internetit, theksojmë se, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, AKEP-i pasi administron kërkesat nga organet ligjzbatuese me objekt bllokimi i faqeve web me përmbajtje të paligjshme, njofton me shpresë zyrtare, por edhe përmes postës elektronike sipërmarrësit e komunikimeve elektronike për të kryer veprimet e mbylljes së aksesit të faqeve elektronike.

Qëllimi i ligjit nr. 9918, i ndryshuar, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, është që nëpërmjet parimit të asnjësisë teknologjike të promovojë konkurrencë dhe infrastrukturë efeciente në komunikimet elektronike, si dhe të garantojë shërbimet e duhura dhe të përshtatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky ligj nuk zbatohet për përmbajtjen e shërbimeve të ofruara nëpërmjet rrjeteve të komunikimeve elektronike. Pra AKEP nuk ka kompetencë funksionale të ndërhyjë në përmbajtjen e ofruar nga rrjetet e komunikimeve elektronike.

Gjatë muajve tetor - dhjetor 2024, ka pasur një shtim të kërkesave nga AMA për mbylljen e 72 domaineve/faqeve të internetit me të cilat ushtrohej pirateri televizive. Në total kërkesat e AMA-s gjatë vitit 2023 ishin për një numër prej 137 domaineve/faqeve të internetit për kryerje pirateri televizive. AKEP i ka dërguar këto kërkesa menjëherë tek ofruesit e shërbimit të internetit për bllokimin e aksesit të këtyre domaineve/faqeve dhe verifikon rregullisht mbylljen e aksesit të tyre gjatë inspektimeve, sipas planifikimeve mujore/vjetore.

Si përfundim, theksojmë se AKEP do të vijojë bashkëpunimin si me AMA-n ashtu edhe me të gjithë sipërmarrësit, me qëllim përmbushjen e objektivave lidhur me mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike.

- 7. *Të rrisë përpjekjet për harmonizimin e legjislacionit në fushën e komunikimeve elektronike. Harmonizimi i legjislacionit sjell heqjen e barrierave për një treg shërbimesh të shoqërisë së informacionit, nxitjen e konkurrencës dhe mbrojtjen e konsumatorit në këtë sektor, si dhe nëpërmjet përdorimit të një teknologjie të shpejtësisë së lartë zgjerimin dhe maksimalizimin e mundësive për qasjen ndaj shërbimeve online.***

## **REALIZUAR**

Ndërhyrja legjislative, me qëllim hartimin e një kuadri të ri ligjor për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë, aktualisht në proces, që rregullon veprimtarinë e sektorit të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë, vjen në përmbushje të qëllimeve të parashikuara në Planin Kombëtar të Integritimit

---

2022-2024, për implementimin e plotë të Direktivës nr.2018/1972/EC të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 11.12.2018, “Për krijimin e Kodit Europian për Komunikimet Elektronike”.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka përfunduar fazën e Konsultimit Publik mbi draftin e projektligjit i cili transponon plotësisht kodin. Dhe, pasi ka marrë komente nga institucionet, palët e interesit dhe Komisioni Europian, ka hartuar një dokument final të cilin e ka përcjellë pranë Këshillit të Ministrave për miratim.

Drafti final i projektligjit të ri për komunikimet elektronike pritet që, brenda një periudhe relativisht të shkurtër kohore, të paraqitet për miratim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Pas miratimit të ligjit të ri për komunikimet elektronike, AKEP do të procedojë me miratimin e akteve të reja rregullatore të cilat do të mbështeten në këtë ligj.

- 8. *Të ketë në vëmendje të veprimtarisë që zotërimi i të drejtave të përdorimit të frekuencave të mos pengojë, por përkundrazi të nxisë mundësitë e barabarta për të konkurruar për operatorët ekzistues, sikurse mundësinë e hyrjes në treg të operatorëve të rinj celularë, virtualë apo jo.***

**REALIZUAR**

Nxitja e konkurrencës përmes zotërimit pro-kompetitiv të të drejtave të përdorimit të frekuencave ka qenë kryefjala e AKEP-it nga mesi i vitit 2022 deri në mesin e vitit 2023. Duke u mbështetur edhe në rekomandimin e Autoritetit të Konkurrencës, në vendimin e tij për lejimin e përqendrimit mes ONE dhe Albtelecom, AKEP-i nxiti dhe mbështeti një operacion delikat që ka transformuar peizazhin e zotërimeve spektrale në dobi të konkurrencës, eficiencës së përdorimit të spektrit, dhe stimulimit të investimeve në funksion të rritjes së cilësisë së rrjeteve dhe mbulimit të tyre.

Së pari, transaksioni mes dy operatorëve celularë ka passjellë një riekulibrim të zotërimit spektral, duke i mundësuar operatorët të konkurrojnë në kushte të barabarta në tregun e telefonisë celularë.

Së dyti, transaksioni mes dy operatorëve ka passjellë edhe një ripozicionim të zotërimeve spektrale, duke lejuar vijimësinë e blloqeve spektrale të zotëruara nga i njëjti operator, duke garantuar një eficiencë maksimale të përdorimit spektral që stimulon investimet në rrjetet përkatëse të operatorëve duke u përkthyer në cilësi dhe në mbulim më të lartë.

Së treti dhe më e rëndësishmja, sipas analizës së AKEP-it, blloqet e lira në breza të ndryshëm të spektrit të frekuencave janë adekuate dhe të mjaftueshme për të lejuar aksesin e një operatori të ri (MNO) që mund të jetë i interesuar të ofrojë në vendin tonë rrjete të telefonisë celulare. Përmbledhtazi, theksojmë se AKEP ka frekuenca të lira për caktim, në brezat e ulët, një bllok prej 10 MHz në brezin 800 MHz, dhe së shpejti 30 MHz në brezin 700 MHz, dhe breza krejtësisht të lirë në brezat e mesëm të sipërm (mes 3400 M MHz dhe 3800 M MHz, të cilësuar së fundmi si më të përshtatshmit për teknologjinë 5G) dhe në brezat e lartë (24 GHz e sipër, i ashtuquajtur spektri millimeter wave).

Në fund të vitit 2023, dy operatorët celularë One Albania sh.a., dhe Vodafone Albania sh.a., kanë shprehur në AKEP interesin e tyre zyrtar për marrjen në përdorim të frekuencave të brezit 3400-3800 MHz, për ndërtimin e rrjeteve të gjeneratës së pestë celulare (5G).

AKEP, në muajin dhjetor 2023, në zbatim të nenit 68, të ligjit 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka ngritur një Grup Pune për hartimin e Dokumentit për Këshillim Publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit të brezit të frekuencave 3400-3800 MHz (3.5 GHz)”, me qëllim marrjen e mendimit të palëve të interesuara.

Në përfundim të Këshillimit Publik, AKEP-i do të miratojë qëndrimin e tij dhe do të vijojë procedurat e tjera ligjore duke përfshirë koordinimin me Ministrinë e Energjisë dhe Infrastrukturës, për numrin e të drejtave të përdorimit (autorizimeve), sasinë e spektrit që do të tenderohet, çmimin për të drejtë përdorimi, etj.

Tenderimi i këtyre frekuencave dhe dhënia e të drejtave të përdorimit ofertuesve fitues, parashikohet të përfundojë në gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2024.

Në këtë aspekt, AKEP do të kujdeset për miradministrimin e spektrit 3400-3800 MHz, duke e organizuar në sasi të tilla, që të ketë frekuenca edhe për një operator të ri, nëse do të kërkojë të hyjë në treg.

- 9. Në kuadër të detyrimeve të Rregullores 49/2021 për operatorët me aksesin në shërbimet e emergjencës, të bashkëpunojë me operatorët dhe institucionet përkatëse për të bërë të mundur që marrja e SMS-ve dhe informacionit të vendndodhjes të mundësohet edhe nga platformat e trajtimit të thirrjeve/komunikimeve të emergjencës.***

**REALIZUAR**

---

Përsa i përket Rekomandimit 9 të Kuvendit, AKEP ju bën me dije se janë ndërmarrë një sërë hapash për përmbushjen e këtij Rekomandimi. Hapat më të rëndësishëm lidhen me koordinimin me Agjencinë Kombëtare të Emergjencave Civile (AKMC) dhe operatorët, në lidhje me shërbimet e emergjencës.

Në kuadër të unifikimit të numrit të emergjencës për të gjithë Shqipërinë, pra 112, AKMC që në fillim të trajtimit të kësaj çështje ka kërkuar bashkëpunimin e AKEP.

Në zbatim të Urdhrit të përbashkët nr. 125, datë 28.2.2023, të Ministrit të Mbrojtjes dhe të Ministrit të Brendshëm, është ngritur Grupi Ndërinstitucional i Punës për hartimin e projektvendimit “Për ngritjen dhe funksionimin e numrit të unifikuar të thirrjeve emergjente 112”.

Fillimisht Grupi i Punës ka diskutuar zgjidhjet e mundshme teknike për të bërë të mundur unifikimin e thirrjeve, dhe në këtë pjesë AKEP ka luajtur rol kryesor. Për të bërë të mundur një analizë sa më të mirë të situatës, AKEP ka kërkuar informacion nga operatorët celularë për thirrjet drejt numrave të emergjencës për vitet e fundit, dhe mbi bazë të këtyre informacioneve është bërë edhe propozimi Teknik për AKMC.

Në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës së numrave të emergjencës janë zhvilluar një sërë takimesh në nivel Teknik me AKMC.

Pas përfundimit të koordinimit, AKMC ka hartuar edhe Draft-VKM, për të cilën është marrë edhe mendimi i AKEP.

Në këtë VKM, nga ana e AKEP është kërkuar që të shtohet edhe pika mbi informacionin e vendndodhjes. Duhet pasur parasysh fakti që ky shërbim është i lidhur ngushtë me llojin e telefonit që përdoret nga pajtimtarët, pasi në rastin kur pajtimtarët përdorin telefona të vjetër, të cilët nuk i suportojnë shërbimet e vendndodhjes, informacioni mbi vendndodhjen mund të mos jetë 100% i saktë.

- 10. Me gjithë përmirësimet e bëra nga “Posta Shqiptare” sh.a., në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit, “Posta Shqiptare” sh.a. duhet të vijojë të kërkojë përmbushjen e detyrimit për shpërndarjen e objekteve postare në adresën e marrësit, si një problematikë e cila vijon të mbetet.***

**REALIZUAR**

Lidhur me këtë Rekomandim sqarojmë se edhe gjatë vitit 2023 AKEP ka vijuar të kërkojë nga Posta Shqiptare respektimin e detyrimeve ligjore e rregullatore.

Në raportimin e pasqyrës së dorëzimit në adresë të paketave dhe kolive për 3/mujorin e parë 2023, sipas filialeve të Posta Shqiptare sh.a., krahasuar me Raportimin Vjetor

2022, rezulton:

- ✓ Nivel i pandryshuar i paketave dhe kolive të dala për dorëzim në adresë;
- ✓ Rënie me 8 % e paketave dhe kolive të dorëzuara në adresë, për shkak të mungesës së disponibilitetit të klientëve në adresë në kohën e tentativave për dorëzim.

Në takimin e organizuar në muajin shtator me përfaqësues të Postës Shqiptare, nga ofruesi i shërbimit universal u deklarua se po merreshin masa për dorëzimin në adresë të pakove, por duke qenë se shfaqen edhe vështirësi në mosgjatjen e personave në banesë, nga Posta Shqiptare po mendohet realizimi i një projekti për vendosjen e kutive postare pranë degëve të Postës me kod unik, ku qytetarët mund të tërheqin pakot në çdo orë nëpërmjet një kodi specifik, pa qëndruar në sportelet e postës.

Për sa më lart, AKEP vijon të monitorojë në vijimësi procesin e përmbushjes së rekomandimeve të lëna, duke kryer edhe procesin e inspektimit në fundin e vitit dhe duke lënë rekomandimet përkatëse.

- 11. *Të vijojë punën për realizimin në kohë të projektit Zhvillimi i Atlasit të Broadband të Shqipërisë, si një projekt cilisyon të rrisë transparencën në shkëmbimin e informacionit për komunikimet me brez të gjerë (broadband), të përmirësojë politikëbërjen dhe planifikimin në sektorin digjital, si dhe të stimulojë investimet në zonat ku aktualisht broadband mungo ose ka mungesë konkurrence.***

**REALIZUAR**

Për sa i përket Rekomandimit 11 të Kuvendit, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, AKEP ka përfunduar punën me konsulentin e përzgjedhur nga MIE në lidhje me projektin “Zhvillimi i ATLAS të *Broadband* të Shqipërisë”, projekt në kuadër të investimeve të EU përmes programit të investimeve në Ballkanin Perëndimor.

Raporti përfundimtar është dorëzuar nga konsulenti pranë MIE dhe AKEP, në formë zyrtare, në fillim të muajit shkurt 2023. Krahas raportit përfundimtar, konsulenti i projektit ka ofruar edhe një raport të hollësishëm, ku analizon ATLAS-in aktual për sa i përket hartave kryesore, raportimit dhe arkitekturës së Teknologjisë së Informacionit (IT).

Pas dërgimit të raportit përfundimtar nga Konsulenti, AKEP në bashkëpunim me MIE kanë vendosur që, ndër 3 rekomandimet e propozuara nga Konsulenti, të vijojë me propozimin e ndërtimit të sistemit Atlas në një infrastrukturë fizike dhe logjike

---

të rikonceptuar dhe OpenSource.

Ndërtimi i teknologjisë OpenSource do të sjellë bashkëpunimin e Atlasit edhe me Atlas të tjerë, si dhe do të suportoje lloje të ndryshme të dhënash gjeohapësinore, ndërsa infrastruktura e ndarë do të rrisë sigurinë si për Atlas, ashtu edhe për infrastrukturën aktuale të AKEP.

Në lidhje me këtë Rekomandim janë zhvilluar edhe takime me përfaqësues të lartë të ITU (Internation Telecommunication Union).

Në takimin e datës 28.9.2023, (zhvilluar në Budva, Mali i Zi, përgjatë Forumit Rajonal Rregullator), AKEP kërkoi nga ITU mbështetje për të çuar përpara ndërtimin e Atlasit të ri. Mbështetja u kërkua konkretisht për hartimin e termave të referencës, por edhe mundësi për financimin e këtij projekti nga ITU si dhe dhënien e ndihmës për marrjen e eksperiencave më të mira për ndërtimin e Atlasit *broadband*.

Ky takim u vijua edhe me takimin teknik të datës 5.12.2023, për të parë të gjitha mundësitë që mund të ofrohen nga ITU, si edhe termat teknike konkrete.

- 12. *Të marrë masa për pjesëmarrjen dhe për të dhënë kontribut konkret në tryezën në nivel teknik të iniciuar nga AMA, lidhur me bashkërendimin e punës midis institucioneve për gjetjen e zgjidhjeve më të mira për problematikën e sistemit të kabllave ekzistuese në shtyllat e energjisë elektrike.***

**REALIZUAR**

Në përmbushje të plotësimit të detyrimeve të ngarkuara nga Rezoluta e Kuvendit të RSH, edhe gjatë vitit 2023 AKEP-i ka vijuar të ndjekë me tepër vëmendje situatën e rrjeteve dhe infrastrukturës së sipërmarrësve në zonat e identifikuara si problematike, si dhe të ndërhyjë në disa zona për eliminimin e infrastrukturës ajrore sipas planit vjetor të inspektimit, me qëllim plotësimin e kushteve teknike të përcaktuara në Rregulloren nr. 22, datë 24.6.2011, “Mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërurbane të komunikimeve elektronike”.

AKEP në vijimësi ka kërkuar prej sipërmarrësve të komunikimeve elektronike, ofruesve të rrjeteve kabllore audiovizive, si edhe prej njësive vendore, të marrin masa me qëllim eliminimin e lidhjeve që mbështeten në infrastrukturën e rrjetit elektrik dhe të ndriçimit.

Përveç problematikës së ndotjes vizive të mjedisit/territorit dhe sigurisë, përdorimi i lartë i kabllave ajrore dhe instalimet pa standarde të tyre bëhen shkak për degradimin e cilësisë së shërbimit të aksesit *broadband* dhe për mosrealizimin e



objektivave të strategjisë së Qeverisë për akses *broadband* me shpejtësi të lartë.

Në shumë raste përdorimi i kablove ajrore rezulton për shkak të mungesës së infrastrukturës nëntokësore.

Gjithsesi, për të shmangur apo minimizuar këtë dukuri, me qëllim përmbushjen dhe standardizimin e kërkuar në rrjetin inxhinierik të komunikimeve elektronike, një faktor nga më kryesorët vlerësojmë se është plotësimi i kërkesave të operatorëve për pajisjen me lejet e duhura për vënien në dispozicion dhe shtrirjen e infrastrukturës së nevojshme për linjat nëntokësore të komunikimeve elektronike, në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe vendosjen nga ana e pushtetit lokal të tubacioneve në të gjitha infrastrukturat urbane (rrugë, trotuare) që po ndërtohen apo do të ndërtohen në të ardhmen.

Bashkitë luajnë një rol të rëndësishëm për shtrirjen dhe mbarëvajtjen e rrjeteve të telekomunikacioneve, nëpërmjet:

- Kompetencave për shqyrtimin e kërkesave dhe marrjen e vendimeve për pranimin ose refuzimin e dhënies së të drejtës së kalimit për rrjetet e komunikimeve elektronike, si dhe mbikëqyrjen e ushtrimit të së drejtës së kalimit dhe çdo çështje që lidhet me ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të komunikimeve elektronike në zonat në kompetencë të tyre;
- Ofrimit të aksesit në tubacionet aktuale në pronësi të bashkisë si dhe ndërtimit të tubacioneve të reja;
- Menaxhimit të pikave të aksesit në godina në bashkëpronësi me shumë apartamente dhe në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrator, operator apo qytetar;
- Pasqyrimin e informacionit të tubacioneve të bashkive në sistemin ATLAS;
- Koordinimi me AKEP në rastet kur ndërtohen rrugë të reja ose kur bëhet rikonstrukcioni i atyre ekzistuese.

**Përveç raportimit të përvitshëm në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit, AKEP-i gjykon të nevojshëm të vendosë një komunikim të rregullt edhe me Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, i cili ka në përbërjen e tij Nënkomisionin për Qeverisjen Vendore, për të bashkërenduar një sërë hapash drejt ndërgjegjësimit të disa aktorëve sektorialë, kryesisht të pushtetit vendor, për domosdoshmërinë e marrjes së një ansambli të koordinuar masash që kanë të bëjnë, në nivel bashkish dhe njësisht administrative, me zhvillimin infrastrukturor të rrjeteve të telekomunikacionit.**

Në mungesë, deri më sot, të një interlokutori të përqendruar për problematikat e pushtetit vendor në nivel ekzekutiv, AKEP i është drejtuar shkresërisht këtij Komisioni për t'i propozuar fillimin, në suazën e Nënkomisionit për Qeverisjen Vendore, të një procesi angazhues auditimi dhe ndërgjegjësimi të pushtetit vendor, në lidhje me problematikat e zhvillimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike në terren dhe të

---

bashkëpunimit serioz institucional me AKEP-in.

Në këtë aspekt, AKEP-i vijon të ndjekë me përparësi këtë problematikë duke e koordinuar punën me të gjithë aktorët e tjerë të këtij procesi, dhe duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet tyre mbi rregullimin e përdorimit të infrastrukturës pasive.

Vlen të theksojmë se edhe Autoriteti i Konkurrencës me Vendimin nr.1025, datë 13.10.2023 ka hapur një hetim paraprak ndaj ndërmarrjeve të administrimit në rezidencat e banimit të qarkut të Tiranës, në tregun e aksesit të shërbimit të internetit. Procedura ka nisur mbështetur në disa ankesa të depozituara pranë Autoritetit të Konkurrencës, mbi problematikat në zgjedhjen e ofrimit të shërbimit të internetit pranë komplekseve të pallateve në kryeqytet.

Komisioni i Konkurrencës ka vlerësuar se ekzistojnë dyshime të arsyeshme se në tregun e aksesit të shërbimit të internetit në rezidencat e banimit të qarkut të Tiranës, ka problematika dhe mund të ketë elementë të abuzimit me pozitën dominuese nga ndërmarrjet e administrimit në rezidencat e banimit të qarkut të Tiranës. Një situatë e tillë mund të jetë shenjë e kufizimit, shtrembërimit apo pengimit të konkurrencës në kuptim të nenit 9, të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Hetimi paraprak do të përfshijë periudhën kohore nga data 1 janar 2020 deri në 13 tetor 2023.

- 13. Të kërkojë nga dy operatorët në treg që brenda një kohe sa më të shkurtër (brenda një viti) të marrin masa për mbulimin me shërbim celular të akseseve rrugore të vendit, në mënyrë të veçantë të ketë në fokus akset ku qarkullimi i automjeteve është dhe më i lartë.**

#### **REALIZUAR**

Një rëndësi të veçantë përgjatë këtij viti AKEP i ka kushtuar Monitorimeve QoS (kualiteti i cilësisë së shërbimit) të akseve të reja rrugore përkatësisht:

- Sinanaj – Gusmar – Kuç – Qeparo – Brataj – Vlorë;
- By – Pass Vlorë;
- Kardhiq – Sarandë;
- Rruga Arbërit.

Pas matjeve të kryera nga vetë AKEP, me anë të shkresave datë 19.6.2023, dy operatorëve celularë “One Albania” sh.a., dhe Vodafone Albania” sh.a., ju është kërkuar marrja e masave për zgjidhjen e problematikave të ofrimit të shërbimeve të telefonisë së lëvizshme.

Zgjidhjet e ofruara nga operatorët për mbulime maksimale janë si më poshtë:

- Ndërtimi i stacioneve të reja të dedikuara të buxhetura në investimet e reja për vitin 2023;
- Ndërtimi i stacioneve të reja të dedikuara të pa buxhetura në investimet e reja për vitin 2023;
- Shtimin e antenave të reja të dedikuara në stacionet ekzistuese;
- Optimizimin e stacioneve ekzistuese.

Në lidhje me optimizimin e stacioneve, si zgjidhja më e shpejtë e ofruar nga operatorët e telefonisë së lëvizshme, gjatë muajit gusht 2023 AKEP-i kreu monitorime në dy akset rrugore të reja të inauguruara nga Qeveria, konkretisht: akset Orikum-Dukat dhe Palas-Dhërmi, në të cilat operatorët ofronin shërbim optimal.

Nga konstatimet e monitorimeve vjetore, edhe pse rezultuan përmirësime në ofrimet e shërbimeve të telefonisë së lëvizshme, sërish kërkohet ndërtimi i stacioneve të reja të dedikuara.

AKEP, me anë të shkresave të dërguara datë 6.9.2023, ka kërkuar nga të dy operatorët përcaktime të sakta të afateve si për ndërtimin e stacioneve të reja të dedikuara të buxhetuara për vitin 2023, ashtu edhe për ato të pabuxhetuara për këtë vit.

Në Figurën nr.1 dhe Figurën nr.2, në grafike paraqitet në % mbulimi me shërbimet data për të gjitha akset e reja rrugore sipas monitorimeve QoS të kryera nga AKEP përgjatë muajve Qershor dhe Gusht të vitit 2023.




Figura nr.1 % e shërbimit data downloaded për muajin qershor 2023




Figura nr.2 % e shërbimit data downloaded për muajin gusht 2023

Nga analiza e monitorimeve QoS mbi shërbimin e operatorëve mobile për teknologjitë GSM, UMTS dhe LTE për akset e reja rrugore për vitin 2023 paraqitet kjo situatë:

- Rezultatet e monitorimeve QoS për rrjetet mobile të realizuara nga AKEP nuk janë kontestuar nga asnjë nga operatorët “One Albania” sh.a., dhe “Vodafone” Albania” sh.a.;
- Përmirësimin e shërbimit në nivele të pranueshme për By-Pass-in e Vlorës;
- Ofrimin e shërbimit brenda parametrave të KPI për akset e reja rrugore Orikum-Dukat, Palas-Dhërmi;
- Përmirësim të akseve të tjera rrugore, duke realizuar optimizimin e stacioneve ekzistuese. Kjo për faktin se për ndërtimin e stacioneve të reja kërkohet planifikim i buxhetit si dhe leje ndërtimin për ngritjen e tyre.

AKEP do realizojë verifikimin e përmirësimit të shërbimeve mobile të operatorëve për akset e reja, por edhe monitorimin e të gjithë akseve kombëtare rrugore përgjatë vitit 2024 edhe në vijim.









